

KISHA E JEZU KRISHTIT E SHENJTORËVE TË DITËVE TË MËVONSHME • TETOR 2019

Liahona



**Fëmijët Hasin
Pornografi – Si Mund
të Ndhimojë Dashuria,
faqe 36**

Qartësia e Thjerrës së
Ungjillit, faqe 12

5 Mënyra se si Jezusi i
Mbronte Fëmijët, faqe 18

Kremtimi i 100 Vjetëve të
Bekimeve të Tempullit në
Paqësor, faqe 28




KISHA
ËSHTË
KËTU

Antananarivo Madagask



kar

Këtu janë disa fakte rreth Madagaskarit dhe Kishës atje:



1986 Anëtari i parë nga Madagaskari i pagëzuar në Bordo të Francës

1990 Pesë njerëz pagëzohen dhe konfirmohen

1998 Krijohet misioni i parë

2000 Krijohet kunji i parë



FOTOGRAFIA NGA GETTY IMAGES

Jezusi i Do Fëmijët Tanë

Unë kaloj shumë kohë duke menduar për fëmijët. I dua fëmijët që janë në rrethin tim familjar dhe të miqve. Përveç kësaj, puna ime te revistat e Kishës përfshin krijimin dhe redaktimin e faqeve për fëmijët anembanë botës. Por nja dy vjet më parë, e kuptova se nuk e kisha studiuar kurrë atë që shkrimet e shenjta jepnin mësim mbi fëmijët. Kështu që vendosa të lexoja Dhiatën e Re dhe Librin e Mormonit dhe t'i kushtoja më shumë vëmendje asaj që mund të mësoja për këtë grup të veçantë.

Ishte një veprimtari që ta ndryshon jetën! Midis shumë të vërtetave që zbulova, më e çmuara ishte një kuptueshmëri më e madhe mbi faktin se sa shumë kujdeset Jezusi për fëmijët. Ai u dha shërbesë fëmijëve si një grup i veçantë, i shkëputur prej të tjerëve, vazhdimisht. Si mund ta ndjekim shembullin e Tij?

Artikulli im në faqen 18 tregon disa nga mësimet që mbledha nga ajo përvojë e studimit të shkrimeve të shenjta, ndërthurur me ide dhe të dhëna nga disa ekspertë në fushën e parandalimit të keqtrajtimit.

Fëmijët janë kaq të çmuar. Shpresoj që mund të punojmë së bashku për t'i mbrojtur dhe për t'u dhënë fuqi atyre, duke i trajtuar ashtu siç do t'i trajtonte Jezusi.

Me dashuri,
Marisa Uidisën



Bekimet e një Këndvështrimi sipas Ungjillit

Plaku Geri E. Stivenson

12



Tempulli i Lajes, Havai: Një Shekull Mbledhjeje

Klinton D. dhe Anxhela R. Kristenseni

28



Të Jesh a të Kesh Qenë: Kjo Është Çështja

Plaku Soni L. Koh

24



Sjellja me Pornografinë: Mbro, Reago dhe Shëro

Xhoi D. Xhonsi

36



Përmbajtja

5 Mbrojtja e Fëmijëve nga Pornografia

6 Portrete Besimi

Uilson Di Paula – San-Hoze, Uruguai

Kur Uilsoni pësoi një aksident me motor që e la të gjymtuar dhe bashkëshortja e tij ndërroi jetë pak kohë pas aksidentit, ai nuk dinte ç'të bënte. Por ungjilli ia siguroi përgjigjet.

8 Parimet e Dhënies së Shërbesës

A ju Mungon Kjo Pjesë Jetike e Dhënies së Shërbesës?

Ne jo vetëm që duhet të "vajtjmë me ata që vajtojnë", por gjithashtu të "gëzojmë me ata që gëzojnë". Këtu janë katër mënyra se si ju të mund ta bëni këtë.

12 Bekimet e një Këndvështrimi sipas Ungjillit

Nga Plaku Geri E. Stivenson

Ndërsa mbajmë një drejtpeshim shpirtëror, ne do të kemi një këndvështrim sipas ungjillit.

18 Mbrojtja e Fëmijëve

Nga Marisa Uidisëni

Jezu Krishti i donte dhe i mbronte fëmijët e vegjël. Si mund ta ndiqni shembullin e Tij?

24 Të Jesh a të Kesh Qenë: Kjo Është Çështja

Nga Plaku Soni L. Koh

Është e thjeshtë t'i gjykojmë të tjerët, por ne duhet të jemi të kujdesshëm që të gjykojmë drejt dhe t'i shohim të tjerët siç i sheh Perëndia.

28 Tempulli i Lajes, Havai: Një Shekull Mbledhjeje

Nga Klinton D. dhe Anxhela R. Kristenseni

Për 100 vjet, tempulli në Havai u ka mundësuar të gjithë shenjtoreve rreth Paqësorit të marrin bekimet e tempullit.

32 Zëra të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme

Dy motra drejtohen për të shërbyer; mesazhi i misionarëve solli një ndryshim; një peshkop vendos se çfarë të bëjë me shpërblimin e tij; një letër ndihmon për rregullimin e një marrëdhënieje të shkatërruar.

36 Qëndrimi ndaj Pornografisë: Mbro, Reago dhe Shëro

Nga Xhoi D. Xhonsi

Fëmijët preken nga pornografia dhe janë të ekspozuar ndaj saj, por dashuria juaj mund t'i ndihmojë ata ta shmangin dhe mposhtin ndikimin e saj të dëmshëm.

Lexime të Shpejta



Në Kapak
Fotografia nga Getty Images, përdorur për qëllime ilustruese, pozuar nga modelë

Pjesët

Të Rinjtë në Moshë Madhore 42

Në këtë muaj trajtohet se **çfarë të bëni** nëse jeni **duke dalë në takime më dikë që po lufton me pornografinë**, dhe tregohen **histori shprese** nga të tjerët, të cilët janë përballur me pornografinë në marrëdhëniet e krijuara nga daljet në takime.



Rinia

50

Çfarë do të thotë të jesh **një shok ose shoqe e vërtetë**, si **e shpërndan ungjillin** një i ri dhe të kujtosh gurin e qoshes së Kishës.



Fëmijët

Miku

Zbulo se si t'i duash të **tjerët** ashtu si i do Jezusi. Një lutje e ndihmon Prodin kur ai është i frikësuar. Florenca bëhet infermiere. Ti mund të **përgatitesh për tempullin**.



ARTIKUJT E PARAQITUR VETËM NË FORMATIN ELEKTRONIK



Unë Kisha Luftuar për ta Kapërcyer Pornografinë. Përse Nuk Donte ta Bënte Ai?

Emri nuk jepet

Një e re në moshë madhore nga Guatemala tregon përvojën e saj të mirëbesimit të Zotit për të marrë një vendim të vështirë.



Si Mësova të Reagoj kur Dikush e Pranon se po Lufton me Pornografinë

Emri nuk jepet

Kur mëson se dikush po përdor materiale pornografike, mund të të lindin gjithfarëloj emocione, por kjo e re në moshë madhore u mbështet te Shpëtimtari për ta ditur se si të reagon-te me dashuri.



Ecja Përpara pasi Mësova se i Fejuari Im po Përdorte Materiale Pornografike

Emri nuk jepet

Një e re në moshë madhore në Tahiti tregon idetë e veta mbi mënyrën se si pornografia ndikoi te marrëdhënia e saj.

TETOR 2019 VËLLIMI 21 NR. 5 LIAHONA 18610 101

Revista ndërkombëtare zyrtare e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme

Presidencia e Parë: Rasëll M. Nelson, Dallin H. Ouks, Henri B. Ajring

Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve: M. Rasëll Ballard, Xhefri R. Holland, Diter F. Uhtdorf, Dejvid A. Bednar, Kuentin L. Kuk, D. Tod Kristoferson, Nil L. Andersen, Ronald A. Rasband, Geri E. Stivenson, Dejll G. Renland, Gerit W. Gong, Ulises Soares

Kryeredaktor: Randy D. Funk

Këshilltarë: Becky Craven, Cristina B. Franco, Sharon Eubank, Walter F. González, Larry S. Kacher, Adrián Ochoa, Michael T. Ringwood, Vern P. Stanfill

Drejtor Përgjegjës: Richard I. Heaton

Drejtor i Revistave të Kishës: Allan R. Loyborg

Përgjegjës i Punëve: Garff Cannon

Redaktor Përgjegjës: Adam C. Olson

Ndihmësredaktor Përgjegjës: Ryan Carr

Ndihmëse e Botimit: Camila Castrillón

Grupi i Shkrimit dhe i Redaktimit:

David Dickson, David A. Edwards, Matthew D. Flitton, Garrett H. Garff, Jon Ryan Jensen, Aaron Johnston, Charlotte Larccabal, Michael R. Morris, Eric B. Murdock, Joshua J. Perkey, Jan Pinborough, Richard M. Romney, Mindy Selu, Lori Fuller Sosa, Chakell Wardleight, Marissa Widdison

Drejtor Përgjegjës i Artit: J. Scott Knudsen

Drejtor Arti: Tadd R. Peterson

Grupi i Faqesjes: Jeanette Andrews, Fay P. Andrus, Mandie Bentley, C. Kimball Bott, Thomas Child, Joshua Dennis, David Green, Colleen Hinckley, Eric P. Johnsen, Susan Lofgren, Scott M. Mooy, Emily Chieko Remington, Mark W. Robison, K. Nicole Walkenhorst

Bashkërenduese për Pronësinë Intelektuale: Collette Nebeker Aune

Përgjegjëse e Prodhimit: Jane Ann Peters

Grupi i Prodhimit: Ira Glen Adair, Julie Burdett, Thomas G. Cronin, Bryan W. Gygi, Ginny J. Nilson, Marrison M. Smith

Përgatitja për Shtyp: Joshua Dennis, Ammon Harris

Drejtor Shtypi: Steven T. Lewis

Drejtor i Shpërndarjes: Nelson Gonzalez

Mbikëqyrës i Përkthimit Shqip: Sparti Kashari

Për pajtimet dhe për çmimet jashtë Shteteve të Bashkuara dhe Kanadasë, shkoni në store.lds.org ose kontaktoni me qendrën tuaj vendore të Kishës për shpërndarjen ose me udhëheqësin e lagjes apo degës.

Paraqitni dorëshkrimet dhe pyetjet në internet në liahona.lds.org nëpërmjet postës elektronike liahona@ldschurch.org; ose nëpërmjet postës në *Liahona*, Rm. 2420, 50 E. North Temple St., Salt Lake City, UT 84150-0024, USA.

Liahona (një term nga Libri i Mormonit, që do të thotë "busull" apo "drejtues") botohet në anglisht, armenisht, bislamisht, bullgarisht, çekisht, danisht, estonisht, fihisht, finlandisht, frëngjisht, greqisht, gjermanisht, holandisht, hungarisht, indonezisht, islandisht, italisht, japonisht, kamboxhianisht, kinezisht, kiribatisht, koreanisht, kroatisht, letonisht, lituanisht, malagasisht, marshallisht, mongolisht, norvegjisht, polonisht, portugalisht, rumanisht,

rusisht, samoaisht, sebanisht, slovenisht, spanjisht, suahillisht, suedisht, shqip, tagalogisht, tahitisht, taisht, tongaisht, ukrainisht, urduisht dhe vietnamsht. (Periodiciteti ndryshon sipas gjuhës.)

© 2019 nga Intellectual Reserve, Inc. All rights reserved. Shtypur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Informacion për të drejtën e autorit: Përveç nëse sugjerohet ndryshe, individët mund të kopjojnë material nga *Liahona* për përdorimin e tyre vetjak, jo për tregti (përfshirë për thirrjet në Kishë). Kjo e drejtë mund të anulohet në çdo kohë. Lënda figurative nuk lejohet të kopjohet nëse ajo shoqërohet me kufizime të shënimi i meritave për punën artistike. Çështjet së drejtës së autorit duhet të drejtohen tek Intellectual Property Office, 50 E. North Temple St., Fl. 13, Salt Lake City, UT 84150, USA; adresa elektronike: cor-intellectualproperty@ldschurch.org.

For Readers in the United States and Canada: October 2019 Vol. 21 No. 5. LIAHONA (USPS 311-480) Albanian (ISSN 1521-4753), is published six times a year (January, April, May, July, October, and

November) by The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints, 50 E. North Temple St., Salt Lake City, UT 84150. USA subscription price is \$3.00 per year; Canada, \$3.60 plus applicable taxes. Periodicals Postage Paid at Salt Lake City, Utah. Sixty days' notice required for change of address. Include address label from a recent issue; old and new address must be included. Send USA and Canadian subscriptions to Salt Lake Distribution Center at address below. Subscription help line: 1-800-537-5971. Credit card orders (Visa, MasterCard, American Express) may be taken by phone or at store.lds.org. (Canada Poste Information: Publication Agreement #40017431) POSTMASTER: Send all UAA to CFS (see DMM 507.1.5.2). NONPOSTAL AND MILITARY FACILITIES: Send address changes to Distribution Services, Church Magazines, P.O. Box 26368, Salt Lake City, UT 84126-0368, USA.



MBROJTJA E FËMIJËVE NGA PORNOGRAFIA

Motra Xhoi D. Xhons, Presidente e Përgjithshme e Fillores, shpreh se dashuria është arma më e madhe kundër pornografisë: “Ashtu si thotë motoja e njohur: ‘Pornografia e vret dashurinë’, por le ta kujtojmë gjithashtu se dashuria e vret pornografinë”. Këtu janë tri mënyra se si shprehja e dashurisë i mban të sigurt fëmijët nga ndikimet e pornografisë.

MBROJTJA:

“Të Dua”

Krijoni një marrëdhënie ku fëmijët tuaj të ndihen të sigurt dhe se i duan.

REAGIMI:

“Prapëseprapë të Dua”

Flisni me fëmijët tuaj rreth pornografisë dhe i ftoni ata t’ju drejtohen juve për pyetjet e tyre.

SHËRIMI:

“Gjithmonë do të të Dua”


Sigurojini fëmijët tuaj se edhe nëse ata po luftojnë me pornografinë, dashuria juaj nuk ndryshon.

Motra Xhons shpjegon më shumë për secilën nga këto ide në artikullin e saj në faqen 36.



ÇFARË MUND TË BËNI JU

- Ndhuni rehat rreth bisedës me fëmijët tuaj për seksualitetin dhe mënyrës se si t’i mbrori ata nga pornografia.
- Ndhimojini fëmijët të kuptojnë arsyet *përse*.
- Çdo telefon inteligjent, kompjuter dore dhe kompjuter tavoline duhet të ketë masa mbrojtëse, edhe ata të adoleshentëve dhe të personave në moshë madhore.
- Asnjëherë mos e lini ndokënd vetëm në dhomë në një pajisje ku sheh media.
- Mos i dënoni fëmijët që shprehin një betejë me pornografinë.



“Ne i mbajmë të sigurt fëmijët tanë deri në kohën kur ata mund të ruhen vetë.”

Xhejson S. Keroll, profesor për jetën familjare në Universitetin “Brigam Jang”



Uilson Di Paula

San-Hoze, Uruguai



Një aksident me motoçikletë e la Uilsonin të paralizuar. Një vit më vonë gruaja i ndërroi jetë. Si një i ve me dy vajza të vogla, Uilsoni nuk dinte se çfarë të bënte. Ai nuk e dinte nëse jeta kishte një qëllim. Uilsoni mund të ishte hidhëruar. Përkundrazi, ai filloi të kërkonte për të vërtetën.

CODY BELL, FOTOGRAF

Kisha shumë pyetje. Përse ndodhin gjërat e këqija? Po e jetoja jetën duke u përpjekur të bëja gjërat e drejta dhe gruaja u largua nga kjo jetë dhe përfundova në një karrige me rrota, pastaj mjekët duhej ta operonin vajzën time në kokë për t'i hequr një tumor. Fillova të mendoja se jeta nuk kishte asnjë qëllim.

E kuptova se kisha nevojë të gjeja të vërtetën. Bëra kërkime në fe të ndryshme dhe zbulova Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. E ndjeva se ajo ishte e vërteta.

Tani e di se ka një qëllim që jemi në tokë. Ne jemi këtu si pjesë e planit të përjetshëm të Atit Qiellor. Ne kemi një Shpëtimtar që e mposhti vdekjen dhe u ringjall. Njohuria për këtë më jep forcë. Tani përpiqem fort të ngulmoj dhe të vazhdoj përpara. Kam një qëllim dhe e di se, kur përpiqem të jetoj një jetë të denjë, mund të kem një familje të përjetshme.

ZBULONI MË SHUMË

Shihni më shumë për udhëtimin e besimit të Uilsonit, përfshirë fotografi të tjera, në internet ose variantin e këtij artikulli në Gospel Library [Biblioteka e Ungjillit] te ChurchofJesusChrist.org/go/10196.

SI TË DORËZONI NJË PORTRET BESIMI

Te liahona.ChurchofJesusChrist.org, ju mund të dërgoni një përshkrim të shkurtër dhe fotografi me rezolucion të lartë të dikujt besimi i të cilit iu frymëzon.

Parimet e Dhënies së Shërbesës

A ju Mungon kjo *Pjesë Jetike* e Dhënies së Shërbesës?

Të japësh shërbesë do të thotë të “gëzoh[esh] me ata që gëzohen” po aq sa të “qa[sh] me ata që qajnë” (Romakëve 12:15).

Kur mendojmë për dhënien e shërbesës, është e lehtë të mendojmë për ndihmën ndaj njerëzve në nevojë. Ne flasim për të punuar në kopshtin e së vesë, për t’i çuar darkën një të sëmuri ose për t’u dhënë atyre që po hasin vështirësi. Ne e mbajmë mend këshillën e Palit që të “qa[jmë] me ata që qajnë”, por a përqendrohemi sa duhet te pjesa *e parë* e atij vargu – që të “gëzoh[emi] me ata që gëzohen”? (Romakëve 12:15.) Të gëzojmë me ata të cilëve u japim shërbesë – qoftë nëse ajo do të thotë të festosh suksesin e tyre ose t’i ndihmosh të gjejnë gëzim në kohë të vështira – është një pjesë e rëndësishme e dhënies së shërbesës siç do të bënte Shpëtimtari.

Ja tek janë tri ide që mund të ndihmojnë (dhe një për ta shmangur) kur përpiqemi të përqendrohemi tek e mira që Perëndia na jep në jetë.

1. Jini të Vetëdijshëm

Boni H. Kordën, Presidente e Përgjithshme e Të Rejave, na ndihmon të kuptojmë se ne duhet t’i





TREGOJINI PËRVOJAT TUAJA

Na i dërgoni përvojat tuaja teksa u keni dhënë shërbesë të tjerëve ose ju është dhënë shërbesë. Shkoni te liahona.ChurchofJesusChrist.org dhe klikoni te "Submit an Article or Feedback" ["Dërgoni një Artikull ose Lini një Përshtypje"].

marrim në konsideratë njerëzit të cilëve u japim shërbesë – t'i marrim në konsideratë jo vetëm barrët dhe vështirësitë e tyre por edhe pikat e forta, talentet dhe sukseset e tyre.

Ajo tha se ne kemi nevojë të jemi "një kampion dhe një njeri [i] besuar – si dikush që është në dijeni për rrethanat e tyre dhe i mbështet ata në shpresat e aspiratat e tyre"¹.

Në shëmbëlltyrën e deles dhe cjepve, Shpëtimtari tha se atyre që do të gjenden në krahun e Tij të djathtë, do t'u bëhet pyetja: "Zot, kur të pamë të uritur dhe të dhamë për të ngrënë; ose të etur dhe të dhamë për të pirë?

Dhe kur të pamë të huaj dhe të pritëm?" (Mateu 25:37–38.)

"Vëllezër e motra, fjala kyç është *pamë*", tha Motra Kordën. "Të drejtët i panë njerëzit në nevojë ngaqë po vëzhgonin dhe po vërenin. Edhe ne mund të jemi syçelë për të shkuar në ndihmë e për të ngushëlluar, për të festuar e madje ëndërruar."²

2. Gjenerimi i Arsye për të Festuar

Festojini sukseset e mëdha ose të vogla. Ai mund të jetë mposhtja e kancerit ose marrja e vetes pas një ndarjeje, gjetja e një vendi të ri pune ose gjetja e një këpuce të humbur, mbijetesa një muaj pas humbjes së një njeriu të dashur ose mbijetesa një javë pa sheqer.

Telefononi për të përgëzuar, jepini një kartolinë ose dilni për drekë. Duke ia rregulluar bekimet tona njëri-tjetrit, duke jetuar me mirënjohje dhe duke



SHEMBULLI I SHPËTIMTARIT

Jezu Krishti shpesh gëzoi për lumturinë e të tjerëve. Ai mori pjesë në dasmën në Kanë, ku jo vetëm festoi për rastin e lumtur por edhe e shndërroi ujin në verë (shih Gjoni 2:1–11). Ne gjithashtu mund të bëjmë një përpjekje për të marrë pjesë në ngjarjet e veçanta në jetën e njerëzve të cilëve u japim shërbesë.

Ne gjithashtu shohim Shpëtimtarin që gëzohet për drejtësinë e të tjerëve. Kur Ai vizitoi nefitët, u tha atyre: “Të bekuar jeni për shkak të besimit tuaj. Dhe tani vini re, gëzimi im është i plotë” (3 Nefi 17:20).

festuar për bekimet dhe sukseset e të tjerëve, ne “kemi gëzim në gëzimin e vëllezërve tanë” (Alma 30:34).

3. Shiheni Dorën e Zotit

Ndonjëherë të gëzojmë me të tjerët do të thotë t’i ndihmojmë ata t’i shohin arsyet për t’u gëzuar – pavarësisht nga vështirësitë ose kënaqësitë që na vijnë në jetë. E vërteta e thjeshtë se Ati Qjellor është i vetëdijshëm për ne dhe gati për të na ngritur moralisht, mund të jetë një burim i jashtëzakonshëm gëzimi.

Ju mund t’i ndihmoni të tjerët ta shohin dorën e Zotit në jetën e tyre duke treguar se si ju vetë e keni parë atë në jetën tuaj. Jini aq të hapur sa të tregoni se si Ati Qjellor ju ka ndihmuar përgjatë sfidave tuaja. Kjo dëshmi mund t’i ndihmojë të tjerët ta dallojnë dhe ta pranojnë se si Ai i ka ndihmuar ata (shih Mosia 24:14).

4. Mos e Kufizoni Aftësinë Tuaj për të Gëzuar

Fatkeqësisht, ne ndonjëherë mund ta kufizojmë vetë aftësinë tonë për të gëzuar me të tjerët, sidomos kur ndihemi të pasigurt rreth asaj që kemi për të dhënë ose situatës sonë aktuale në jetë. Në vend që të gjejmë gëzim në lumturinë e të tjerëve, ne biem në kurthin e krahasimit. Dhe sikurse dha mësim Plaku Kuentin L. Kuk, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve:



“Krahasimi i bekimeve është pothuaj e sigurt që do ta largojë gëzimin. Ne nuk mund të jemi në të njëjtën kohë mirënjohës dhe ziliqarë.”³

“Si mund ta mposhtim një prirje të tillë kaq të zakonshme thuajse te kushdo?” pyeti Plaku Xhefri R. Holland, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve. “. . . Ne mund të numërojmë bekimet tona të shumta dhe mund të duartrokasim për arritjet e të tjerëve. Mbi të gjitha, ne mund t’u shërbejmë të tjerëve, ushtrimi më i mirë që është këshilluar ndonjëherë për zemrën.”⁴ Në vend që të krahasohemi, ne mund t’i përgëzojmë njerëzit të cilëve iu japim shërbesë. Thuajeni pa drojë atë që vlerësoni tek ta ose pjesëtarët e familjes së tyre.

Siç na kujton Pali, ne të gjithë jemi pjesë e trupit të Krishtit dhe, kur “nderohet një gjymtyrë, të gjitha gjymtyrët gëzohen bashkë me të” (1 Korintasve 12:26). Me ndihmën e Atit Qiellor, ne mund të jemi të vetëdijshëm për përvojat e të tjerëve, mund të festojmë për sukseset e mëdha dhe të vogla, t’i ndihmojmë ata që ta njohin dorën e Zotit dhe ta mposhtim xhelozinë në mënyrë që me të vërtetë të mund të gëzojmë së bashku për bekimet, talentet dhe lumturinë e të tjerëve. ■


SHËNIME

1. Boni H. Kordën, “Të Bëhesh Bari”, *Liahona*, nëntor 2018, f. 75.
2. Boni H. Kordën, “Të Bëhesh Bari”, f. 75.
3. Quentin L. Cook, “Rejoice!” *Ensign*, nëntor 1996, f. 30.
4. Jeffrey R. Holland, “The Other Prodigal”, *Liahona*, maj 2002, f. 64.

FTESË PËR TË VEPRUAR

Merrini parasysh njerëzit të cilëve u jepni shërbesë. Çfarë talentesh dhe pikash të forta kanë ata? Çfarë mundësish ose suksesesh kanë pasur ata? Si mund të gëzoheni me ta, t’i përgëzoni ose t’i nxitni?





Bekimet e një Këndvështrimi sipas Ungjillit

Një këndvështrim sipas ungjillit do t'ju japë qartësi më të madhe mbi mënyrën se si mendoni mbi përparësitë e jetës suaj, si i zgjidhni problemet dhe si përballen me tundimet vetjake.

Cfarë bekimi i madh është të jemi anëtarë të Kishës së Jezu Krishtit në periudhën ungjillore kur një rivendosi e çelësave të mbretërisë dhe plotësimi i profecisë na lejojnë të dëshmojmë drejtpërdrejt “përhap[jen e] ungjilli[t] deri në fundet e dheut, ashtu si guri që shképutet pa duar nga mali, do të përhapet derisa të ketë mbushur tërë tokën” (Doktrina e Besëlidhje 65:2).

Kjo profeci, e dhënë nga Danieli i Dhiatës së Vjetër dhe e përsëritur më pas në këtë periudhë ungjillore, duket të jetë në mes të përmbushjes teksa vëzhgojmë mbi 3 300 kunje të organizuar në Kishë sot. Në 50 vjetët e fundit, anëtarësia në Kishë është rritur nga 2,1 milionë në më shumë se 16 milionë [veta].¹

Për mua, po aq mbresëlënës sa janë ky ndryshim dhe kjo rritje e madhe, është fakti se parimet dhe praktikat e ungjillit mbeten të njëjta, përfshirë modelin e qeverisjes hyjnore të zbuluar për Kishën e Jezu Krishtit. Ky model lejon organizimin e kunjeve, të projektuar të sigurojë “për mbrojtje e për strehim nga stuhia dhe nga zemërimi, kur të derdhen pa u zvogëluar mbi tërë dheun” (Doktrina e Besëlidhje 115:6).

Vëllezër dhe motra, Zoti është bujar me bekimet që na fal. Të kuptuarit se bekimet janë funksioni i bindjes sonë ndaj urdhërimeve dhe se mbajtja e urdhërimeve është një shfaqje e dashurisë sonë për Zotin, janë rregulla të vlefshme për t'i mësuar. Parime të ungjillit si këto japin një këndvështrim të rëndësishëm për ne.

Një nga mrekullitë më të mëdha të ekzistencës suaj në vdekshmëri do të jetë aftësia juaj për të gjetur drejtpeshim mes shpirtshmërisë suaj dhe roleve të tjera të rëndësishme në jetë.

Kjo çon në dy pika që dëshiroj t'i theksoj. Vërej se Presidenti Dallin H. Oaks, Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë, ua tregoi më parë këto dy pika të rinjve në moshë madhore beqarë në vitin 2015.

Mbani një këndvështrim sipas Ungjillit

Presidenti Oaks ka thënë se “këndvështrim do të thotë t’i shohësh të gjitha faktet në një marrëdhënie kuptimplote, të gjithë pamjen”². Këtu janë disa gjëra që ju i kuptoni kur i shihni nga një këndvështrim sipas ungjillit:

- Ju jeni fëmijë të një Ati të dashur Qiellor (shih Doktrina e Besëlidhje 76:24).
- Ju jeni këtu në tokë për një qëllim, me aftësinë që të bëni zgjedhje (shih 2 Nefi 2:27; 10:23).
- “Pasi, është e nevojshme që të ketë një kundërshtim në të gjitha gjërat” (2 Nefi 2:11).
- Jezu Krishti është Shpëtimtari dhe avokati ynë me Atin (shih 1 Gjon 2:1; Doktrina e Besëlidhje 110:4).

Merreni parasysh se çfarë ndodh nëse këndvështrimi juaj sipas ungjillit bëhet thjerra me anë të së cilës ju e shihni çdo anë të jetës suaj. Një këndvështrim sipas ungjillit do t’ju japë qartësi më të madhe mbi mënyrën se si mendoni mbi përparësitë e jetës suaj, si i zgjidhni problemet dhe si përballeni me tundimet vetjake. Kjo vërtet mund të ndikojë te qasja juaj e

përgjithshme ndaj gjithë jetës suaj dhe vendimet e ndryshme që do të merrni përgjatë udhës.

Me këtë botëkuptim, ne e dimë se Zoti dëshiron që ta marrim sakramentin çdo javë dhe t’i studiojmë shkrimet e shenjta e t’i lutemi Atij çdo ditë. Përveç kësaj, ne e dimë se Satani do të na tundojë që të mos ta ndjekim Shpëtimtarin tonë ose të mos t’i dëgjojmë nxitjet e qeta të Frymës së Shenjtë. Atëherë ne mund të bëhemi më të vetëdijshëm se kundërshtari përpiqet fort të na i heqë lirinë tonë të zgjedhjes dhe aftësinë për t’u bërë ballë përpjekjeve të tij nëpërmjet varësisë, përfshirë drogat dhe pornografinë.

Në kundërshti të plotë, thjerrat e ungjillit na japin një pamje të qartë të rëndësisë së krijimit të familjeve – të zgjedhjes që të martohemi dhe të rritim fëmijë në drejtësi. Kjo pikë-pamje gjithashtu na i hap sytë që të shohim se kundërshtari do të donte ta shkatërronte krejtësisht njësinë familjare dhe t’i ngatërronte rolet gjinore, duke çuar kështu te një pakësim i vlerës që shoqëria vë te formimi dhe ndërtimi i familjeve.

Mbajtja e një Drejtpeshimi Shpirtëror

Presidenti Oaks pohoi: “Kur të rinjtë në moshë madhore e kanë këndvështrimin – pamjen e përgjithshme – është jetike për ta që të mbajnë drejtpeshimin shpirtëror në jetën e tyre. Për ta bërë këtë, ju duhet të hiqni dorë nga disa prej tërheqjeve të botës dhe gjithashtu të bëni gjërat e domosdoshme për të shkuar më pranë Shpëtimtarit.”³

Nga njëra anë, ju keni shumë çështje të ngutshme dhe përparësi të jetës të të gjitha përmasave dhe llojeve, të cilat që të gjitha kanë nevojë për vëmendje, përqendrim dhe drejtim. Lista për secilin prej jush mund të jetë mjaft e ndryshme bazuar në rrethanat tuaja vetjake, por brenda saj ju me siguri do të gjeni arsimimin, punësimin, martesën si dhe edhe

mirëqenien emocionale edhe atë fizike. Sigurisht, sfida juaj është t'i drejtpeshoni këto role të rëndësishme të jetës kundrejt shpirtshmërisë suaj.

Presidenti Ouks këshilloi gjithashtu që ju duhet të jeni të kujdesshëm kur “e ndani kohën që ju nuk do të vuani shpirtërisht urie gjatë kohës kur veprimtaritë tuaja e programuara më së pari janë në gjëra të tjera. Ai parim e shpjegon se përse është veçanërisht e rëndësishme që të rinjtë në moshë madhore ... ta ndjekin këshillën për të marrë pjesë në mbledhjet e Kishës, për të shërbyer në Kishë, për të bërë studim të përditshëm të shkrimeve të shenjta, për të pasur lutje të përditshme familjare në gjunjë dhe për të shërbyer në thirrjet në Kishë.”⁴

Mes nevojave tuaja vetjake dhe të ndryshme, për t'i drejtpeshuar synimet dhe sfidat e jetës me shpirtshmërinë tuaj, do të arrini ta kuptoni se drejtpeshimi mund të arrihet. Zoti nuk ju kërkon të bëni diçka që nuk mund ta përmbushni. E kam dëgjuar Presidentin Tomas S. Monson (1927-2018) në shumë raste të këshillojë se “atë që Zoti e thërret, Zoti e kualifikon”⁵. Mendoj se kjo zbatohet veçanërisht për anëtarët e Kishës.

Sado tmerruese të mund të duket mbajtja e këtij drejtpeshimi, unë premtoj se një nga mrekullitë më të mëdha të ekzistencës suaj në vdekshmëri do të jetë aftësia juaj për të gjetur drejtpeshim mes shpirtshmërisë suaj dhe roleve të tjera të rëndësishme në jetë. Kjo mund të ndodhë në një mënyrë që do t'ju lejojë që jo thjesht t'i mbani shpirtshmërinë tuaj dhe rolet e rëndësishme në jetë në gjendjen e tanishme, por edhe të rriteni e të zhvilloheni në të dyja këto fusha të rëndësishme.

Arsyeja kryesore pse kjo është e mundur, është se Zoti është strumbullari. Ai është pika qendrore absolute e peshores. Dhe Ai ka interesim hyjnor për ju personalisht si një nga fëmijët e Tij. Por ky rezultat bazohet te përqendrimi dhe përpjekja juaj e përshtatshme që të gjeni drejtpeshim.

Nga vëzhgimi im dhe përvoja vetjake, duket se ne kemi një prirje gjatë gjithë jetës sonë për t'u anuar më shumë nga njëra anë ose tjetra. Që të mbetemi në drejtpeshim në jetën tonë kërkohet përpjekja dhe kujdesi ynë i vazhdueshëm. Zgjidhni në mënyrë aktive që të mbeteni të qëndrueshëm.

Është interesante se mund ta humbni drejtpeshimin në të dy drejtimet. Mund të ketë raste kur e shihni se ju nevojitet të kini kujdes që të mbeteni qartësisht të përqendruar te shkolla juaj ose puna profesionale, duke e kryer “shërbimin në Kishë gjatë kohës së shërbimit [të adhurimit] në Kishë”⁶. Megjithatë, kujtohuni ta mbani Zotin si strumbullarin tuaj që të mund të gjeni baraspeshën tuaj të duhur shpirtërore.

Zoti do t'ju Ndhimojë

Kur mbajmë një këndvështrim sipas ungjillit, është e lehtë ta kuptojmë të vërtetën themelore se Zoti do të na ndihmojë. Një parim bazë i ungjillit është se ne jemi fëmijë të Prindërve të dashur Qjellorë. Është tërësisht e natyrshme për Ta që të na ndihmojnë në çdo mënyrë që të kthehemi te shtëpia jonë qiellore.

Dëshiroj të tregoj një shembull të mënyrës se si Zoti mund t'ju ndihmojë. Një nga udhëheqësit e mi të rinisë, Thed Karlsoni, ma tregoi shumë vjet më parë. Thedi, që ndërroi jetë kohët e fundit, ka pasur një ndikim të pamasë tek unë kur po rritesha. Ai u rrit gjatë Depresionit të Madh, i nënti nga 14 fëmijë. Familja e tij e siguronte jetesën duke kullotur dhe rritur bagëti. Ishte një kohë e vështirë nga ana financiare dhe pasuria e tyre më e madhe ishte tufa e tyre e bagëtive.

Në rininë e Thedit, një nga përgjegjësitë e tij ishte që të kujdesej për bagëtitë dhe, kur ishte e nevojshme, t'i kulloste ato që të siguronte se kishin gjetur kullotën më të mirë – një punë e madhe për një djalë të vogël. Ai që në gjendje ta bënte këtë

Mbajeni mend të mbani një këndvështrim sipas ungjillit. Shiheni botën rreth jush nëpërmjet thjerrës së ungjillit të Jezu Krishtit.

me ndihmën e një kali poni të mençur për lopët, që, me pak drejtim, e dinte saktësisht se çfarë të bënte. Ponin e quanin Hirushi Plak. Por Hirushi Plak kishte një të metë: ai kurrë nuk donte që ta kapnin. Kurdoherë që dikush i afrohej, ai vraponte larg, duke e ditur se do ta futnin në punë.

Një ditë, pasi Hirushin Plak e kishin kapur, i kishin vënë frerin dhe shalën, djaloshi Thed kalëroi për te kullota ku po ushqeheshin bagëtitë. Toka ishte e thatë dhe po ashtu dhe kullota, por Thedi vuri re se bari jashtë kullotës, përgjatë anës së një traseje hekurudhore, ishte më i lartë dhe më i gjelbër. Kështu që mendoi t'i çonte lopët jashtë kullotës së rrethuar me gardh dhe t'i linte të shijonin një pjesë nga ushqimi i mirë përgjatë trasesë së hekurudhës.

Me ndihmën e Hirushit Plak, Thedi i çoi bagëtitë jashtë kullotës, ku ato filluan të lëvizin lart e poshtë përgjatë trasesë së hekurudhës, duke u ushqyer me barin më të mirë e më të gjelbër. Lopët e kënaqura dukej se po kujdeseshin për veten, kështu që Thedi zbriti nga kali i tij dhe u ul mbi kapistallin e frerit, duke shijuar mjedisin rreth tij, duke luajtur e duke u zbavitur. Megjithatë, duke kërkuar të kulloste edhe vetë në barin e gjelbër, Hirushi Plak përfundimisht u largua, me frerët që rrëshqitën që poshtë Thedit.

Ky çast i patrazuar dhe i paqetë shkoi drejt një fundi të potershëm dhe të papritur kur Thedi befas dëgjoi një zhurmë të madhe që nga larg. Ishte fishkëllima e një lokomotive që po vinte duke udhëtuar me shpejtësi mbi vetë trasenë e shinave ku tufa e tij e bagëtive ishte e shpërndarë plot përtesë pikërisht para tij. Ai e kuptoi se pasojat mund të ishin shkatërrimtare për tufën dhe gjithashtu për familjen e tij nëse nuk do të vepronte me të shpejtë për t'i çuar bagëtitë sërish në kullotë dhe t'i largonte nga treni që po vinte. Ai ndjeu se nuk do të ishte kurrë në gjendje ta falte veten që nuk e kishte përmbushur përgjegjësinë që ia kishin mirëbesuar atij.

Thedi kërceu në këmbë menjëherë dhe vrapoi të rrokte frerin e Hirushit Plak. Hirushi Plak e pa Thedin që po vinte, dhe me të shpejtë kërceu larg tij, duke mos dashur që ta kapnin.

Pa frymë dhe i dëshpëruar, me pamjet e lopëve të ngordhura dhe tragjedinë e familjes që i shkrepnin në mendje, Thedi e dinte se duhej të vepronte me të shpejtë.

Më vonë ai e shënoi se çfarë ndodhi: “Mësuesja ime e Fillores na kishte mësuar të luteshim dhe i kishte përforcuar mësimet e dhëna nga nëna ime. Pa rrugëdalje tjetër, rashë në gjunjë dhe fillova të lutem për ndihmë që t'i hiqja lopët nga traseja.”

Thedi nuk dëgjoi ndonjë zë, por një mendim i qartë i erdhi: “Vër re se si lopët mund të ecin pranë Hirushit Plak dhe ai nuk lëviz. Kështu që . . . tani që je në gjunjë, vendos edhe duart në tokë. Sillu sikur të jesh një lopë dhe zvarritu drejt Hirushit Plak.”

Thedi tha: “E bëra. Ai nuk lëvizi. E rrëmbeva frerin e tij, e drejtova për te gardhi, i kërceva në shpinë dhe vrapuam si era që t'i kthenim lopët sërish në kullotë. Hirushi Plak që jashtë-zakonisht i shkëlqyer në çdo kthesë e rrotullim.”

Më vonë, kur Thedi që në shkollë të mesme, e kuptoi plotësisht se kishte marrë një përgjigje të qartë për lutjen e tij në një kohë nevojë vendimtare. Ai vërejti: “Engjëjt i administruan Hirushit Plak përtej aftësisë sime dhe familjes sime iu kursye një tragjedi”. Më vonë ai tha: “Kjo që e para nga shumë nxitje që [do të] më vinin. ‘Dhe në çdo gjë që ju do t'i kërkonte Atit në emrin tim, që është e drejtë, duke besuar se do ta merrni, vini re, ajo do t'ju jepet’ (3 Nefi 18:20).”⁷

Të gjithë ne kemi bagëtitë tona që duhet t'i heqim nga traseja e hekurudhës përpara se të mbërrijë treni. Rreziqet tona vijnë në shumë forma dhe masa të ndryshme. Disa janë po aq të rënda sa situata e rrezikshme e Thedit, me pasoja kërcënuese për jetën ose kërcënuese për shpirtin për ne ose njerëzit tanë të dashur.

Situata të tjera që hasim, mund të mos kenë pasoja kaq të rënda, por megjithatë rëndojnë shumë mbi mendjen dhe zemrën tonë. Një gjë është e sigurt – secili prej nesh do të ketë kundërshti dhe pikëllim në jetë sepse ato janë pjesë e përvojës sonë në vdekshmëri. Por mbajeni mend, Zoti do të na ndihmojë!

Më pëlqejnë shumë këto fjalë që gjenden në Librin e Mormonit: “Ne shohim se Perëndia kujdeset për të gjithë njerëzit, në çdo vend që të ndodhen; po, ai numëron njerëzit e tij dhe zemra e tij e mëshirës është mbi gjithë tokën” (Alma 26:37).

Kjo do të thotë [se Ai kujdeset] për secilin prej nesh. Çfarë ngushëllimi i madh është ta dimë se Zoti do të na ndihmojë!

Besim, Shpresë dhe një Këndvështrim sipas Ungjillit

Si përmbledhje, unë ju nxit të kujtoheni që të mbani një këndvështrim sipas ungjillit. Shiheni botën rreth jush nëpërmjet thjerrës së ungjillit të Jezus Krishtit.

Mbani një drejtpeshim shpirtëror. Ne të gjithë hasim sfida dhe mundësi në rolet e ndryshme në jetën tonë dhe i përballojmë më së miri kur i drejtpeshojmë me besimin tonë te Jezus Krishti dhe te Shlyerja e Tij.

Së fundi, kini besim dhe shpresë se Zoti do t'ju ndihmojë. Kjo dijeni është ajo çfarë ju ndihmon t'i përballoni me vetëbesim sfidat që janë një pjesë e pashmangshme e misionit tuaj në vdekshmëri. ■


Nga një fjalim në takimim shpirtëror, "A Gospel Perspective" ["Një Këndvështrim sipas Ungjillit"], dhënë në Universitetin "Brigam Jang" – Havai, më 19 shtator 2017.

SHËNIME

1. Shih "Raporti Statistikor, 2018", *Liahona*, maj 2019, f. 112.
2. Dallin H. Oaks, mbledhje rreth vatrës për të rinjtë në moshë madhore beqarë, 8 shkurt 2015, Solt-Lejk-Siti, Jutë (e pabotuar).
3. Dallin H. Oaks, mbledhje rreth vatrës për të rinjtë në moshë madhore beqarë, 8 shkurt 2015.
4. Dallin H. Oaks, mbledhje rreth vatrës për të rinjtë në moshë madhore beqarë, 8 shkurt 2015.
5. Thomas S. Monson, "Duty Calls", *Ensign*, maj 1996, f. 44.
6. Dallin H. Oaks, mbledhje rreth vatrës për të rinjtë në moshë madhore beqarë, 8 shkurt 2015.
7. Thad Carlson, letërkëmbim vetjak.







Mbrojtja e Fëmijëve

Çfarë mund të bëjmë për t'i mbrojtur dhe për t'u dhënë fuqi më mirë fëmijëve në jetën tonë?

Nga Marisa Uidisën

Revistat e Kishës

Nga të gjithë grupet e njerëzve që Jezusi u dha mësim, e dimë se Ai i deshi veçanërisht fëmijët. Ai u kushtoi vëmendje fëmijëve edhe kur nuk ishte e volitshme. Ai i ftoi fëmijët të merrnin një bekim vetjak nga Ai. Ai i dënoi ata që i lëndonin fëmijët. Dhe Ai dha mësim se na nevojitet të bëhemi më shumë si fëmijët që të hyjmë në mbretërinë e qiellit.¹

“Vini re të vegjlit tuaj”, u tha Ai njerëzve në kontinentin amerikan pas Ringjalljes së Tij. Qiejt u hapën dhe engjëj të dashur e mbrojtës zbritën dhe formuan një rreth përçark fëmijëve, duke i rrethuar me zjarr. (Shih 3 Nefi 17:23–24.)

Me të gjithë rreziqet [që janë] në botë sot, ne mund të urojmë që fëmijët tanë të mund të jenë vazhdimisht të rrethuar nga zjarri qiellor. Është vlerësuar se një në katër njerëz në mbarë botën është keqtrajtuar kur ishte fëmijë dhe se ai numër mesatar rritet kur shihni grupe të veçanta të cenushme, të tilla si njerëzit me paftësi.² Lajmi i mirë është se ka shumë gjëra që ne mund të bëjmë për të marrë masa paraprake për mbrojtjen e fëmijëve.

“Përfytyrojeni në mendje një fëmijë që e doni”, tha Motra Xhoi D. Khons, Presidente e Përgjithshme e Fillores. “Kur i thoni këtij fëmije: ‘Unë të dua’, çfarë do të thotë kjo? . . . Ne sigurojmë mbrojtje në mënyrë që të mund t'i ndihmojmë ata që i duam, që të bëhen më të mirët që mundën dhe të përballen me sfidat e jetës.”³

Ndoshta duke e parë më nga afër shembullin e Shpëtimtarit, do të na lindin ide mbi mënyrën se si mund t'i mbrojmë më mirë fëmijët në jetën tonë.



Kur Jezusi i vizitoi nefitët, Ai e bekoji secilin fëmijë në mënyrë individuale. Po ashtu, ne duhet ta njohim çdo fëmijë.

Jezusi Gjeti Kohë për Ta

Jezusi la kohë mënjanë për t'u kushtuar vëmendje fëmijëve të vegjël dhe njerëzve të cenueshëm (shih Mateu 19:14). Ne gjithashtu mund të lëmë kohë mënjanë që t'i dëgjojmë fëmijët tanë dhe të përpiqemi t'i kuptojmë sfidat e tyre.

“Sa më shumë dashuri që të ndiejë fëmija, aq më e lehtë është për atë që të hapet”, tha Motra Xhons. “. . . Ne duhet ta fillojmë bashkëbisedimin dhe të mos presim që fëmijët të vijnë te ne.”⁴

Për një nënë që e dobishme t'i pyeste fëmijët e saj çdo mbrëmje: “A dëgjuat sot ndonjë fjalë që nuk e kuptuat?”

Instinkti i parë i fëmijëve tanë mund të jetë që t'i kërkojnë përgjigjet në rrjet sepse interneti jep ndihmë të menjëhershme dhe nuk gjykon, por na nevojitet t'i bindim ata që ne jemi një burim informacioni më i besueshëm. Dhe kjo përfshin mosreagimin me tepri kur fëmijët tanë na thonë diçka të paretshme. Për shembull, nëse kemi një shpërthim emocional kur fëmija jonë na rrëfen se ka kërkuar materiale pornografike, ai mund të mos vijë sërish te ne për ndihmë. Por nëse reagojmë me dashuri, kemi një mundësi për të dërguar një mesazh të qartë – se dëshirojmë që ata të na flasin ne për gjithçka.

Motra Xhons vërejt: “Telashe të vogla për të cilat diskutohet në një mënyrë plot dashuri, krijojnë një themel për një reagim të shëndetshëm, kështu që, kur vijnë telashe të mëdha, komunikimi është ende i hapur”⁵.

Disa nga bashkëbisedimet më të rëndësishme e mbrojtëse që prindërit mund të kenë me fëmijët, janë mbi trupat e tyre. Këto bashkëbisedime duhet të përfshijnë fjalë të sakta për pjesët e trupit, informacion mbi higjienën dhe se çfarë ndryshimesh të presin në vitet e ardhshme. Ne duhet të flasim për seksualitetin dhe mënyrën se si intimiteti fizik dhe emocional janë një pjesë e mrekullueshme e planit të Atit Qiellor për ne. Ne gjithashtu mund të flasim për tema të tilla si keqtrajtimi dhe pornografia. Këto bashkëbisedime ka nevojë të jenë të përshtatshme me moshën dhe të udhërrëfihen nga pyetjet që kanë fëmijët tanë. Në mënyrë ideale, ne do të kemi shumë bashkëbisedime gjatë kohës duke dhënë informacion të mëtejshëm teksa fëmijët tanë rriten dhe kuptueshmëria e tyre shtohet. (Shihni fundin e këtij artikulli për burime të dobishme.)

Jezusi Dha Shembull për Ta

Jezusi dha një shembull të përkryer për cilindo (shih Gjoni 8:12). Si të rritur, ne gjithashtu kemi mundësinë dhe përgjegjësinë që të jemi shembuj. Një nga mënyrat më të mira se si ne mund t'i ndihmojmë fëmijët tanë që të jenë të sigurt, është duke qenë vetë model për zgjedhje të sigurt. Fëmijët e vënë re mënyrën se si prindërit e tyre i trajtojnë të tjerët dhe se si i lejojnë të tjerët që t'i trajtojnë ata. Ju lutemi, nëse jeni në një marrëdhënie ose po luftoni me një varësi që ju vë në rrezik ju ose familjen tuaj, merrni ndihmë. Drejtojuni autoriteteve civile dhe profesionistëve të këshillimit, si edhe peshkopit tuaj

ose presidentes së Shoqatës së Ndihmës, të cilët mund t’ju ndihmojnë të lidheni me burimet e përshtatshme të Kishës dhe komunitetit. Ju meritoni siguri dhe respekt.

Ne gjithashtu duhet të japim shembull përkujdesjeje për forcën tonë shpirtërore. A na shohin fëmijët tanë të lutemi? A e dinë ata se ne i lexojmë shkrimet e shenjta? A i kanë dëgjuar ata dëshmitë tona? A e veshim ne “gjithë armatimin e Perëndisë” si familje në mëngjes përpara se të drejtohemi jashtë në botë? (Shih Efesianëve 6:11–18; Doktrina e Besëlidhje 27:15–18.)

Jezusi Foli Haptas për Ta

Shpëtimtari foli hapur kundër atyre që i lëndojnë fëmijët (shih Mateu 18:6). Edhe ne mund të jemi avokatë për fëmijët në jetën tonë.

“Fëmijët kanë nevojë që të tjerët të flasin për ta”, dha mësim Presidenti Dallin H. Oaks, Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë, “dhe ata kanë nevojë për vendimmarrës që ta vendosin mirëqenien e tyre përpara interesave egoiste të të rriturve.”⁶

Ndërkohë që nuk na nevojitet të kemi tepër frikë ose dyshim ndaj të tjerëve, duhet të jemi të vetëdijshëm për kërcënimet e mundshme dhe të marrim vendime të mençura për sigurinë. Udhëheqëset e Fillores duhet të ndjekin orientimet e Kishës për parandalimin e keqtrajtimit⁷ – pasja e dy mësuesve/eve në çdo klasë dhe e dikujt nga presidenca që i kontrollon klasat, siguron mbrojtje.

Prindërit dhe udhëheqësit duhet të këshillohen së bashku dhe të vendosin nëse ka masa paraprake shtesë që mund të marrin për t’i zvogëluar në minimum kërcënimet e veçanta. Për shembull, shumë ndërtesa të Kishës kanë dritare në dyert e klasave. Nëse ndërtesa juaj nuk ka, mund të merrni parasysh t’i lini dyert pak të hapura gjatë orëve mësimore dhe të flisni me përfaqësuesin tuaj vendor përgjegjës për godinat për të parë nëse është një mundësi vendosja e dritareve. Pavarësisht nga thirrjet e tyre, të gjithë personat në moshë madhore mund jenë të vëmendshëm në kishë dhe të ndihmojnë kur nevojitet, si për shembull duke i mirëpritur vizitorët që po bredhin nëpër salla, ose duke e nxitur një fëmijë që po endet, që të kthehet në klasë.

Trishtueshëm, nganjëherë, fëmijët lëndohen nga fëmijë të tjerë. Nëse vëmë re çfarëdo forme të mujshtisë ose kontaktit të papërshtatshëm fizik në kishë apo kudo qoftë, nevojitet të ndërhyjmë menjëherë. Nëse jemi udhëheqës, na nevojitet të jemi të gatshëm të bisedojmë me familjet e përfshira – edhe

nëse bashkëbisedimet janë të paretshme – për të siguruar që të gjithë fëmijët të jenë të sigurt. Flisni hapur me dhembshuri dhe qartësi që të ndihmoni të krijohet një kulturë mirësie.

Nëse besojmë se një fëmijë po keqtrajtohet, ne duhet t’ua raportojmë menjëherë këto shqetësime autoriteteve civile. Në shumë vende ekzistojnë linja të posaçme telefonike që bëjnë ndërhyrje në rast krize, japin informacion dhe shërbyeme përkrahjeje. Ne gjithashtu duhet t’i tregojmë peshkopit për keqtrajtimin e dyshuar, veçanërisht kur përfshin cilindo që mund të ketë qasje te fëmijët nëpërmjet Kishës. Përveç marrjes së masave për të parandaluar qasjen e një fajtori në të ardhmen të fëmijët, peshkopi mund t’u sigurojë ngushëllim dhe përkrahje viktimave dhe t’i ndihmojë ata të lidhen me burime shtesë nga Shërbimet për Familjen.

Jezusi i Bekoi Ata Një nga Një

Jezusi i njohu dhe i bekoji fëmijët një nga një (shih 3 Nefi 17:21). Po ashtu, ne duhet ta njohim secilin fëmijë dhe të përpiqemi ta ndihmojmë atë posaçërisht.

Si mund ta bëjmë kishën më të sigurt për fëmijët me probleme shëndetësore? A kemi një plan për t’i ndihmuar fëmijët e Fillores me paaftësi? A janë mësimet e Fillores që zhvillojmë, të ndjeshme ndaj gjendjeve të ndryshme familjare? Çfarë mund të bëjmë tjetër për të qenë më përfshirës?



Komentet raciste, vërejtjet nënvlerësuese për kultura të tjera dhe sjelljet dënuese ndaj anëtarëve të besimeve të tjera nuk duhet të kenë vend në mesazhet që japim. Në një klasë Fillloreje, një djalë nuk e fliste shumë mirë të njëjtën gjuhë si fëmijët e tjerë. Për ta ndihmuar atë të ndihej i mirëpritur, mësuesit siguroheshin që t’i shtypnin fletushkat në të dyja gjuhët. Veprime të thjeshta kujdesi u tregojnë fëmijëve se ne i njohim dhe kujdesemi për ta individualisht dhe se këto veprime mund të japin një shembull për t’u ndjekur nga ata.

Mund të zbulojmë se disa fëmijëve u nevojitet ndihmë në një mënyrë të ngutshme. Për shembull, edhe pse disa luhatje të humorit janë pjesë normale e rritjes, nëse një fëmijë është i inatosur, i mbyllur në vetvete, ose i trishtuar për disa javë, mund të ketë një problem më të rëndë që ka nevojë për ndihmë profesionale. Ndërkohë që zakonet e drejta si lutja dhe studimi i shkrimeve të shenjta janë të rëndësishme, shpesh nevojitet më shumë përkrahje për ata që po merren me një sëmundje mendore e cila po shfaqet, ose po përballen me një traumë të fshehtë. Shpërfillja e situatës nuk do t’i përmirësojë gjërat. Në shumë zona, peshkopët mund t’u sigurojnë ndihmë financiare për këshillim individëve dhe familjeve nëpërmjet Shërbimeve për Familjen ose siguruesve të tjerë [të shërbimit].



Jezusi u Dha Fuqi Atyre

Ndërsa po i mbronte fëmijët, Jezusi gjithashtu u dha fuqi atyre. Ai i tregoi fëmijët si shembuj (shih Mateu 18:3). Pas vizitës së Tij në kontinentet amerikane, fëmijët e vegjël qenë të aftë t’u mësonin të rriturve “gjëra të mrekullueshme” (3 Nefi 26:16).

Ne mund t’u japim fuqi fëmijëve që njohim, duke u mësuar atyre të dallojnë se si Shpirti u flet atyre dhe pastaj ta ndjekin Shpirtin kur marrin vendime – duke i ndihmuar të zhvillojnë një filtër të brendshëm që t’i udhërrëfejë në veprimet e tyre. Siç dha mësim Motra Xhons: “Ndihma ndaj fëmijëve që të krijojnë arsyetimin e tyre të brendshëm për dëshirën që të [marrin vendime të parrezikshme], është thelbësore”⁸. Këtu janë disa ide që u dhanë fuqi familjeve të tjera:

- Një nënë u mësoi fëmijëve të saj t’u kushtonin vëmendje “ndjenjave të tyre të dyshimit a frikës” dhe të ishin të kujdesshëm pranë njerëzve që dukeshin si “të dyshimtë”. Kjo pati rezultat pozitiv kur disa njerëz u përpoqën ta bindnin djalin e saj që t’i ndiqte në një tualet dhe ai ua vuri veshin ndjenjave të tij paralajmëruese dhe nuk pranoi.
- Disa familje krijuan paraprakisht një plan rrugëdaljeje për ta përdorur kur të ndesheshin me diçka të dëmshme. Për shembull, planin për rrugëdalje të një familjeje e quajtën “fike dhe trego” dhe ishte që ta fiknin ekranin e kompjuterit dhe t’i tregonin menjëherë një prindi nëse një figurë e keqe do të dilte papritmas. Fëmijëve të tyre nuk iu desh kurrë të vrisnin mendjen mbi mënyrën se si të merreshin me materialet e këqija argëtuese – ata e dinin se çfarë të bënin.
- Një familje tjetër krijoi një fjalë të koduar që fëmijët e tyre mund t’ua dërgonin me SMS prindërve ose ta thonin në telefon nëse do t’u duhej që prindërit t’i merrnin menjëherë [nga vendi ku ishin].
- Ju mund t’i ndihmoni fëmijët tuaj të ushtrohen që të thonë: “Jo!” kur dikush



përpiqet t'i bindë të bëjnë diçka që i bën të mos ndihen rehat. Çdo fëmijë duhet ta dijë se mund të kërkojë ndihmë dhe ata duhet të vazhdojnë ta kërkojnë derisa të jenë të sigurt.

Roli Ynë si të Rritur

Le ta kujtojmë sërish skenën te 3 Nefi 17 kur Jezusi “i mori fëmijët e tyre të vegjël, një nga një, dhe i bekoi dhe iu lut Atit për ta. . . . Dhe ata qenë të rrethuar nga zjarri; dhe engjëjt u shërbyen atyre” (vargjet 21, 24). Ndoshta një pikë kyç e kësaj historie është që jo vetëm të na mësojë ne se sa të rëndësishëm janë fëmijët, por edhe të tregojë se cili duhet të jetë roli ynë si të rritur. Ne jemi kujdestarët e brezit të ardhshëm. Ne duhet të jemi engjëjt që i rrethojnë dhe u japin shërbesë fëmijëve. Le të vazhdojmë të shohim te Jezusi si shembulli ynë i përkryer dhe pastaj të bëjmë më të mirën që mundemi për t'i rrethuar të vegjlit tanë me dashuri dhe mbrojtje. ■

SHËNIME

1. Shihini referencat nga shkrimet e shenjta poshtë kreut të çdo pjese në këtë artikull që t'i gjeni ato histori në shkrimet e shenjta.
2. Shih “Child Maltreatment (Child Abuse)”, World Health Organization, who.int/violence_injury_prevention/violence/child/en.
3. Xhoi D. Xhons, Qëndrimi ndaj Pornografisë: Mbro, Reago dhe Shëro”, *Liahona*, tetor 2019, f. 38.
4. Xhoi D. Xhons, “Qëndrimi ndaj Pornografisë”, f. 39, 40.
5. Xhoi D. Xhons, “Qëndrimi ndaj Pornografisë”, f. 39.
6. Dallin H. Ouks, “Mbrojini Fëmijët”, *Liahona*, nëntor 2012, f. 43.
7. Shih “Preventing and Responding to Abuse”, newsroom.ChurchofJesusChrist.org.
8. Xhoi D. Xhons, “Qëndrimi ndaj Pornografisë”, f. 40.

BURIME TË DOBISHME NË INTERNET

- OvercomingPornography.Lds.org
- “Abuse” [“Keqtrajtimi”], Gospel Topics, topics.Lds.org

KËSHILLA PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE


Në Shtëpi

- Krijoni një plan familjar për të qëndruar larg nga materialet e këqija argëtuese ose për t'u larguar me të shpejtë nga situatat e dëmshme.
- Flisni në mënyra të përshtatshme me moshën për trupin, seksualitetin dhe intimitetin.

Në Kishë

- Ndiqini orientimet e Kishës për mësimdhënien, përfshirë pasjen e dy persona-ve në moshë madhore në çdo klasë.
- Nxitni një kulturë mirësie dhe mos e lejoni mujsinë.





Nga Plaku
Soni L. Koh,
i Të
Shtatëdhjetëve

Të Jesh a të Kesh Qenë: Kjo Është Çështja

Pritet që ne të gjykojmë. Ne duhet [të gjykojmë]. Por ne *nuk* duhet të krijojmë stereotipa apo të etiketojmë ndokënd.

Disa vite më parë, bashkëshortja ime dhe unë po vizitonim kështjellën Kronborg në Elsinor të Danimarkës. Kjo kështjellë u bë e famshme nga vepra *Hamleti* e Uilliam Shekspirit. Teksa ecëm në sallat e kështjellës, mendja na u mbush me skena dhe dialog nga vepra, veçanërisht pyetja e famshme e Hamletit: “Të [jesh] a të mos [jesh], kjo është çështja”.

Por më pas mendova për një pyetje shumë më të përshtatshme për t’ia bërë vetes: “Të jesh a të *kesh qenë*: kjo është çështja”.

Lejojeni Përmirësimin

Për fat të keq, ne shpesh përdorim etiketa kur flasim për të tjerët. Për shembull, mund të themi gjëra të tilla si:

- “Plaku [Elderi] Braun është një misionar dembel”. Në vend të kësaj, duhet të themi: “Plaku [Elderi] Braun nuk ka punuar shumë fort kohët e fundit, por besoj se ai mund të përmirësohet”.
- “Meri nuk është një njeri i prirur ndaj fesë.” Ndryshe, mund të themi: “Meri nuk ka qenë e interesuar për fenë, por ajo mund ta ndiejë Shpirtin nëse ia tregoj dëshminë time asaj”.

Kur themi se dikush *është* diçka, mund të përfundojmë duke vënë etiketa ose stereotipa, duke gjykuar pa i lënë vend mundësisë për ndryshim dhe përmirësim. Por kur themi *ka qenë*, tregojmë se ne besojmë që rritja dhe përparimi janë të mundur.

A Është e Gabuar të Gjykohet?

Shumica e përkthimeve të Biblës japin variantin vijues për një mësim të Shpëtimtarit: “Mos gjykoni, që të mos gjykojeni” (Mateu 7:1). Por Përkthimi prej Joseph Smith-it jep një sqarim: “Mos gjykoni *padrejtësisht* . . . ; *por gjykoni me gjykim të drejtë*” (tek Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, PJS, Mateu 7:2; theksimi i shtuar).

Me të vërtetë është e pranueshme – dhe madje e pritshme – që ne të ushtrojmë gjykim tekta i çmojmë, i vlerësojmë e bëjmë dallimin e situatave dhe marrim vendime. Dhe është veçanërisht e rëndësishme që të ushtrojmë gjykim të drejtë tekta ndërveprojmë me njerëzit.

Për shembull, ne duhet ta vlerësojmë me kujdes personin me të cilin/ën do të martohemi, të përdorim dhuratën e të dalluarit për të kuptuar qëllimet e dikujt, ose të vlerësojmë aftësitë e dikujt për të përmbushur një detyrë profesionale.

Ne gjithmonë duhet t’i vlerësojmë veprimet ose karakteristikat e njerëzve sipas standardeve të Zotit, siç përmbahet në shkrimet e shenjta dhe fjalët e profetëve. Mbi të gjitha, duhet të jemi të sigurt që gjykimet tona nuk përpiqen të përkufizojnë me ashpërsi, të vendosin stereotipa me shpejtësi ose ta etiketojnë padrejtësisht ndokënd.

Të Aftë për të Ndryshuar

Ne ushtrojmë gjykim të padrejtë kur i portretizojmë të tjerët pasaktësisht, veçanërisht nëse, duke e bërë këtë, ne nënkuptojmë se ata nuk mund të ndryshojnë. Në të gjitha ndërveprimet tona

me të tjerët, duhet të kujtojmë që, për shkak të sakrificës shlyese të Zotit, secili prej nesh e ka aftësinë për t’u përmirësuar. Merrini parasysh këta shembuj nga Shpëtimtari:

- Ai i tha gruas që u kap në shkëlqej kurore: “Shko dhe mos mëkato më” (Gjoni 8:11).
- Ai i tha njërit prej burrave që po kryqëzohej përkrah Tij: “Sot do të jesh me mua në parajsë” (Lluka 23:43).
- Si një qenie e ringjallur, Ai vazhdoi ta shihte potencialin e Pjetrit dhe ta mësonte atë, edhe pse Pjetri e kishte mohuar tri herë (shih Mateu 26:34 dhe Gjoni 21:15–17).
- Ai i tha Saulit, që i kishte përndjekur shenjtorët, që të pendohej. Sauli, që u bë Pali, u bind dhe u bë i drejtë. (Shih Veprat e Apostujve 9:3–6.)

Zoti Jezu Krisht është përkrahës i flaktë i mundësive të dyta – dhe gjithashtu i mundësive të treta e të katërta. Ai na dha mësim të falim “deri shtatëdhjetë herë shtatë” (Mateu 18:22). Ai është i vetmi individ që jetoi një jetë të përkryer në këtë tokë, por për shkak të jetës së Tij, mësimet e Tij, sakrificës së Tij shlyese dhe Ringjalljes së Tij, si dhe nëpërmjet ordinarëve të ungjillit të Tij, ne gjithashtu mund të bëhemi të përkryer një ditë. Kur u drejtohemi vëllezërve e motrave tona në një mënyrë që përçon mosbesim në aftësinë e tyre për të ndryshuar, kjo do të përçonte gjithashtu mosbesim në fuqinë e Shpëtimtarit dhe të Shlyerjes së Tij.

Së Jashtëmi dhe së Brendshmi

Është një fakt i jetës se ne shpesh gjykojmë (dhe na gjykojnë) nga pamja e parë. Megjithatë, rrezikojmë të gjykojmë padrejtësisht kur gjykojmë bazuar vetëm te pamja e parë dhe nuk ia dalim ta vlerësojmë karakterin e vërtetë të një personi.

“Zoti nuk shikon si shikon njeriu, njeriu shikon pamjen [e jashtëmi], kurse Zoti shikon zemrën” (1 Samuelit 16:7). Jezusi iu drejtua hipokritëve në kohën e Tij si “varre . . . të zbardhuara, që nga jashtë duken të bukur, por brenda janë plot . . . gjithfarë papastërtish” (Mateu 23:27).

Shpëtimtari nuk po jepte mësim se një pamje e jashtme pozitive dhe modeste nuk është një gjë e mirë, por se karakteri i brendshëm i një burri apo gruaje (gjendja morale dhe shpirtërore) është shumë më i rëndësishëm. Mendoni për tempujt tanë madhështorë – territoret janë të bukura, por shumë më të rëndësishme janë ordinarcat që kryhen brenda tyre.

Misionarëve gjithashtu u kërkohet të mbajnë standarde të veshjes dhe paraqitjes së jashtme. Duke qenë të pastër, duke u veshur me thjeshtësi dhe duke përdorur fjalor të duhur, ata japin një shembull të mirë për ata njerëz tek të cilët paraqitja e ungjillit të Jezu Krishtit do të vijë nëpërmjet asaj që shohin dhe dëgjojnë nga misionarët.

Ushtrimi i Aftësisë së të Dalluarit

Teksa përpiqemi të bëjmë gjykimet të drejta, është e rëndësishme të përdorim aftësinë e të dalluarit. Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta thotë se të dalluarit

është “të kuptosh ose të dish diçka me anë të fuqisë së Shpirtit. . . . A[i] përmban dallimin e karakterit të vërtetë të njerëzve dhe burimin dhe kuptimin e shfaqjeve shpirtërore” (“Dalluar(it), Dhuratë e të”).

Ndonjëherë, njerëzit që janë të ligj së brendshmi, përdorin pamjen si të botës në përpjekje për të na mashtruar që të mendojmë se ata janë të denjë për t’i marrë si shembull. Ata janë “të urtë në sytë e tyre dhe të zgjuar para vetvetes” (Isaia 5:21; 2 Nefi 15:21). Shpëtimtari që në gjendje të shihte përtej kësaj fasade dhe që në gjendje të dallonte forcën e karakterit dhe qëllimin e ndershëm të zemrës madje dhe mes më të përlururve dhe të shtypurve.

Alma e ushtroi një aftësi të tillë të të dalluarit kur u foli atyre që ishin të “përbuz[ur] nga të gjithë njerëzit për shkak të varfërisë së tyre” por sërisht të bekuar sepse ishin bërë të përlurur dhe “të pezmatuar në zemër” (shih Alma 32:5–8).

Ne duhet të mbajmë mend se “gjërat që janë të Frymës së Shenjtë . . . [dallohen] frymërisht” (1 Korintasve 2:14). Kur i shohim të tjerët ashtu siç i sheh ata Ati ynë në Qjell, aftësia e të dalluarit na lejon të ushtrojmë gjykim të drejtë.

Gjykimi i Drejtë


Çdo ditë të jetës sonë, ne gjykojmë duke çmuar, vlerësuar dhe dalluar. Megjithatë, Zoti pret që ne ta bëjmë atë drejtësisht. Si dishepuj të Zotit Jezu Krisht, fjalët dhe veprimet tona duhet të tregojnë se ne jemi të mëshirshëm, të dashur dhe të gatshëm të ndihmojmë.

Si gjykatës të drejtë, na nevojitet të sigurojmë se i kushtojmë më shumë vëmendje karakterit të një njeriu sesa pamjes së tij të jashtme. Në të njëjtën kohë, ne duhet të mbajmë mend se çdo ditë krijojmë mbresa të para nëpërmjet mënyrës se si dukemi dhe fjalëve që përdorim. Shumë njerëz do të tërhiqen për të zbuluar më shumë për karakterin tonë dhe

mesazhin e ungjillit nëse pamja jonë e pasqyron vlerën e lartë të mesazhit tonë.

Zoti dhe Mjeshtri ynë, Jezu Krishti, na ka treguar modelin e përkryer për ta ndjekur teksa përpiqemi fort të gjykojmë drejtësisht. Ne duhet – ashtu si Ai – ta drejtpeshojmë atë që shohim në sipërfaqe, me atë që ka brenda çdo person. ■





Skicë arkitekturale nga arkitektët Hajrëm Pop dhe Harold W. Barton. Djathtas: Një nga katër gdhendjet dekorative përreth tempullit që përfaqësojnë katër periudha të kujdestarisë ungjillore.



Një pjatë zbulurimi që paraqet tetë tempujt e parë të Kishës. Laje është në qendër, poshtë.




Në mes: Presidenti Hiber J. Grant në Laje për përkushtimin e tempullit. Sipër: Presidenti Jozef F. Smith (majtas larg) në Laje. Ai përkushtoi vendin për tempullin në qershor 1915.



Gdhendje dekorative kush-tuar mëmësisë gdhendur nga Avarid Fairbanks. Majtas: Anëtarë të mbledhur në tempull (1920).





Tempulli i Lajes, Havai

NJË SHEKULL MBLEDHJEJE

I përkushtuar 100 vjet më parë, Tempulli i Lajes në Havai u ka lejuar shenjtorëve të mblidhen për të marrë bekimet e tempullit teksa ungjilli filloi të përhapej në mbarë botën.

Nga Klinton D. dhe Anxhela R. Kristensen

Autorët jetojnë në Jutë, SHBA. Vëllai Kristensen punon për Sektorin e Historisë së Kishës.

Një nga misionet e mëdha të Kishës së Jezu Krishtit në ditët e mëvonshme është që t'u sigurojë bekimet e tempullit njerëzve të botës, si të gjallëve, ashtu edhe të vdekurve. Profeti Jozef Smith dha mësim se “qëllimi i mbledhjes së . . . popullit të Perëndisë në çfarëdo epoke të botës . . . ishte ndërtimi i një shtëpie për Zotin, në të cilën Ai të mund t'i zbulonte popullit të Tij ordinancat e shtëpisë së Tij”¹.

Në agimin e shekullit të 20-të, vetëm katër tempuj në funksionim gjendeshin në tokë, që të gjithë me vendndodhje në Jutë. Kështu që, mbledhja fizike në Jutë ishte mjeti kryesor për të marrë qasje në bekimet e tempullit. Në vitin 1919, kjo gjë ndryshoi. Më 27 nëntor 1919, Presidenti Hiber J. Grant (1856-1945) përkushtoi Tempullin e Lajes në Havai. Kjo shënoi një pikë kthese historike në Rivendosje pasi bekimet e tempullit u vunë në dispozicion të shumë kombeve.

Në shumë drejtime, Tempulli i Lajes në Havai ishte tempulli i parë ndërkombëtar. Ai menjëherë u shërbeu anëtarëve

nga Havai, Zelanda e Re, Samoa, Tonga, Tahiti, Japonia dhe Australia. Teksa Kisha vazhdoi të rritet nëpër Paqësor dhe Azi, numri i vendeve të bekuara nga ky tempull vazhdoi të rritej.

Ky vit shënon 100-vjetorin e këtij çasti kulmor të mbledhjes së Izraelit në të dyja anët e velit.

Mbledhja nga Samoa

Ishujt e Samoas shtrihen rreth 2 500 milje (4 023 km) larg nga Havai. Në vitin 1919, Xhon Q. Adams, presidenti i misionit në Samoa, tha: “Me përfundimin e tempullit në Laje, populli ynë duket se u pushtua nga një dëshirë e fortë për të mbledhur mjaftueshëm nga të mirat e kësaj bote sa për të shkuar në tempull”. Aulelio Anae, për shembull, kishte shërbyer si misionar pa pagesë për 20 vjet. Për shkak të viteve të tij të sakrificës, ai nuk kishte mjaftueshëm para sa të udhëtonte për në Havai. Kështu që Vëllai Anae shiti gjithçka zotëronte dhe ia doli që mezi të grumbullonte tok 600 a 700 USD.² Vëllai Anae dhe samoas të tjerë sakrifkuan gjithçka mundën që të shpërnguleshin në Laje gjatë viteve 1920.

Një familje, familja Leota, mbërriti në Havai në ditën e Vitit të Ri 1923. Vailina Leota shtatëvjeçare kujtoi: “Hera e

parë kur e [pamë] tempullin . . . ishte pamja më e bukur”³. Vetëm dy javë më vonë, prindërit e Vailinës, Aivao dhe Matala, morën dhurimet e tyre e u vulosën si çift dhe fëmijët e tyre iu vulosën atyre. Familja Leota shërbeu besnikërisht në shtëpinë e Zotit për 50 vjet dhe [pjesëtarët e saj] u varrosën “pranë tempullit që ata e donin kaq shumë”⁴. Sot, qindra prej pasardhësve të tyre besnikë jetojnë në mbarë Havain.

Një Detyrë e Pamundur

Ndërkohë që shumë anëtarë në Paqësor e lanë atdheun e tyre dhe emigruan për në Havai, shumë lagje dhe degë nga kombe të ndryshme organizuan udhëtime në grup, të quajtura ekskursione, për në tempull. Kjo formë shpirtërore e mbledhjes siguroi një mënyrë se si anëtarët e Kishës të udhëtonin për të marrë ordinancat e tempullit dhe pastaj të ktheheshin në shtëpi për ta ndërtuar Kishën në vetë kombet e tyre.

Gjatë përkushtimit, Presidenti Grant u lut që Zoti të hapte rrugën për shenjtorët në Zelandën e Re dhe në të gjithë ishujt e Paqësorit dhe për të siguruar gjenealogjitë e tyre kështu që ata të mund të vinin në tempull dhe të bëheshin shpëtimtarë për paraardhësit e tyre.

Ekskursionet për në tempull filluan me një grup shenjtorësh maori në Zelandën e Re vetëm gjashtë muaj pas përkushtimit. Edhe pse 5 000 milje (8 045 km) larg nga Havai, këta shenjtorë u ngazëllyen nga lajmi i përkushtimit.

Vaimate dhe Heeni Anaru ishin të etur të ishin pjesë e grupit të parë që udhëtonte për në tempull. Por detyra dukej e pamundur për shkak të varfërisë së familjes dhe shumës së kërkuar prej 1 200 paundësh të Zelandës së Re për udhëtimin – një shumë e majme. Atyre u nevojitej një mrekulli.

Për vite familja Anaru e ndoqi këshillën e profetit dhe mblodhi dokumentet e saj gjenealogjike. Këto dokumente pastaj mbetën në pargje ndërkohë që familja Anaru priste të ndodhte një mrekulli. Biri i tyre, Vivini, e njihhte besimin e prindërve të tij: “Nëna kurrë nuk u dëshpërua se një ditë

[nuk] do të gjunjëzohej me Babanë në një altar tempulli”.

Një mrekulli ndodhi vërtet. Vaimate fitoi një kontratë nga qeveria e Zelandës së Re për një projekt të madh të zhvillimit të territorit. Të ardhurat e tij nga ky projekt siguruan të holla të mjaftueshme, të paguara paraprakisht, sa të mbulonin koston e udhëtimit për në Havai. Vaimate dhe Heeni e mposhtën frikën e tyre për udhëtimin nëpër oqean dhe shkuan në Havai me një grup prej 14 shenjtorësh në maj 1920. Ata i morën dhurimet e tyre dhe u vulosën. E pamundura kishte ndodhur.

Historia e familjes Anaru është vetëm një nga mijëra historitë e shenjtorëve të ditëve të mëvonshme që udhëtuan për në Tempullin e Lajes në Havai për të marrë ordinancat dhe për të pretenduar premtimet e dhëna nga Zoti në shtëpinë e Tij. Kjo kërkoi sakrificë të madhe por bëri shenjtorë më të fortë që u kthyen në atdheun e tyre të përgatitur për ta udhëhequr Kishën.⁵

Mbledhja Shpirtërore nga Azia

Pas Luftës II Botërore dhe rivendosjes së Kishës në Japoni, shenjtorët e atjeshëm organizuan ekskursionin e parë të Azisë për në tempull. Në vitin 1965, një aeroplan plot me 165 shenjtorë të përkushtuar udhëtoi nga Tokioja për në Havai që të merrnin ordinancat e tempullit. Ky udhëtim solli si rezultat forcë të pabesueshme për Kishën

1850

1850: Misionarët mbërrijnë në Mbretërinë e Havait për të predikuar ungjillin e rivendosur.

1855: Josef F. Smithi shërben në misionin e tij të parë në Havai.

1875



1865: Kisha blen tokë në Laje ku ndërtohet një shtëpi mbledhjesh. Kjo ndërtesë zhvendoset në vitin 1916 për të hapur vend për tempullin.

1900

1915: Tempulli i Lajes, Havai njoftohet nga Presidenti Jozef F. Smith.



27 nëntor 1919: Tempulli përkushtohet nga Presidenti Hibër J. Grant (shihet sipër, në qendër).

1920: Vaimate Anaru udhëton për në tempull nga Zelanda e Re.

1925

1923: Familja Leota (poshtë) shpërngulet për në Laje nga Samoa.



në Japoni. Nëntëdhjetë e pesë për qind e këtyre anëtarëve mbetën aktivë në Kishë. Më vonë, pesë u bënë presidentë tempulli në atdheun e tyre, përfshirë Plakun Joshihiko Kikuçi, Autoritetin e parë të Përgjithshëm nga Japonia.⁶

Në vitin 1970, një grup anëtarësh koreanë udhëtuan për në Laje. Çoi Uok Uani, një president dege, tha: “Ne shkuam në tempull dhe ai na hapi mendjen e na bëri të vetëdijshëm mbi mënyrën se si mund të marrim shpëtim. Plani i përjetshëm u bë realitet, dëshmitë tona janë forcuar aq shumë sa është e vështirë të shpjegohet. Çfarë bekimi i madh është për njerëzit e Koresë që të kenë mundësinë të marrin pjesë në tempull!”⁷

Mbledhja e Farefisit Tonë të Vdekur

Kur ordinancat e tempullit vihen në dispozicion të një kombi, ato ua sjellin bekimet e Zotit jo vetëm atyre që jetojnë në atë vend, por edhe atyre njerëzve nga ai komb që janë tani në anën tjetër të velit. Ky bekim është ndier nga anëtarët në vendet aziatike, ku kultura e tyre ka regjistruar me përpikëri të dhëna gjenealogjike prej shekujsh.

Prindërit e Kuai Shun Lungut migruan nga Kina për në Havai. Ai u lind në Kauai në vitin 1894 dhe u pagëzua në vitin 1944 në ditëlindjen e tij të 50-të. Vëllai Lung dha mësim për historinë familjare në kishë dhe i tregoi klasës së tij:

“Pata një vegim një natë në të cilin pashë shumë nga njerëzit e vdekur të fisit tim që ma bënin me shenjë të punoja për ta”. Tri ditë më vonë, ai mori dokumentin e gjenealogjisë së tij nga tetoja e tij në Kinë, 22 faqe me shkrime kineze që zbulonin paraardhësit e tij deri në vitin 1221 ps. K. Bashkë me birin e tij, Glenin, dhe gruan e të birit, Xhulinën, ata kanë përfunduar mijëra ordinanca në tempull për familjen e tyre. Glen dhe Xhulina Lungu shërbyen më vonë besnikërisht si presidenti dhe kryekujdestarja e Tempullit të Lajes nga viti 2001 deri më 2004.⁸

Mbledhja Vazhdon

I vendosur në udhëkryqet e Paqësorit mes Amerikës dhe Azisë, Tempulli i Lajes në Havai ua ka hapur derën shumë kombeve për bekime të tempullit. Kështu që, mbledhja e Izraelit u bë kryesisht një mbledhje shpirtërore teksa anëtarët janë në gjendje të marrin bekimet e tempullit dhe pastaj të kthehen dhe ta ndërtojnë Kishën në vendet e tyre amtare. Kjo mundësi i ka dhënë ndihmesë zgjerimit të ungjillit të rivendosur te shumë kultura dhe popuj në të dyja anët e velit.

Teksa kremtojmë 100-vjetorin e Tempullit të Lajes në Havai, kemi privilegjin të dëshmojmë një çast kulmor në Rivendosje dhe përmbyshjen e profecisë së profetit Jakob në Librin e Mormonit: “Të mëdha janë premtimet e Zotit për ata që janë në ishujt e detit” (2 Nefi 10:21). ■

SHËNIME

1. *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 444–445.
2. Shih James Adams Argyle, përmb., “The Writings of John Q. Adams”, f. 14, FamilySearch.org.
3. Vailine Leota Niko, në Clinton D. Christensen, përmb. *Stories of the Temple in Lā‘ie, Hawai‘i* (2019), f. 70–71.
4. Aivao Frank Leota (1878–1966), FamilySearch.org.
5. Shih Christensen, *Stories of the Temple in Lā‘ie, Hawai‘i*, f. 64–65.
6. Shih Christensen, *Stories of the Temple in Lā‘ie, Hawai‘i*, f. 114–117.
7. Choi Wook Whan, në “Going to the Temple Is Greatest Blessing”, *Church News*, 17 prill 1971, f. 10.
8. Shih Christensen, *Stories of the Temple in Lā‘ie, Hawai‘i*, f. 166.

1950



1965: Për ekskursionin e parë të Azisë për në tempull, 165 shenjtorë japonezë mbërrijnë në Havai.

1970: Shenjtorët nga Koreja bashkohen me shenjtoret japonezë në një ekskursion për në tempull.

1975



13 qershor 1978: Presidenti Spenser W. Kimball ripërkushton tempullin pas një zgjerimi të madh. Ai dhe Presidenti N. Eldon Taner (sipër) vizitojnë gjithashtu Qendrën Kulturore Polineziane.

2000

21 nëntor 2010: Në vijim të përditësimit me masa kundër lëkundjeve sizmike dhe rimodelimit, Presidenti Tomas S. Monson e ripërkushton tempullin.



2015



Të Udhërrëfyera për te Monika

Kur jetoja në San-Paolo, Brazil, njoha një grua të veçantë që quhej Grasa. Ajo ishte një grua e dashur, e sjellshme dhe miqësore me të gjithë.

Grasa ishte shoqja ime e vizitave mësimore. Ajo ishte nënë e tre fëmijëve, punonte me kohë të pjesshme dhe nuk kishte makinë ose telefon, por asnjëra nga këto nuk e pengoi atë që të shërbente.

Nga ballkoni im, mund të shihja vetëm një dritare të shtëpisë së saj. Kur ishte në dispozicion, Grasa vendoste një pëlhurë të kuqe në atë dritare për të sinjalizuar se ishte gati për të shkuar për vizita. Ajo asnjëherë nuk gjeti një justifikim që të mos shërbente. Shpesh



Grasa vendoste një pëlhurë të kuqe në dritaren e saj për të sinjalizuar se ishte gati për të shkuar për vizitë.

kam menduar për sinjalin e Grases dhe shembullin e saj të mrekullueshëm të besimit dhe shërbimit të thjeshtë.

Një përvojë më ka ngelur në mendje. U përgatitëm dhe u lutëm përpara se të shkonim për të vizituar njërin nga motrat tona. Ndërsa iu afruam shtëpisë së saj, e kuptuam se në fakt ishim drejtuar në shtëpinë e një motre tjetër! Ne ishim caktuar ta vizitonim këtë motër, një nënë pak aktive me dy fëmijë të vegjël, por nuk kishim planifikuar ta vizitonim atë ditë. Për shkak se ishim atje,

trokitëm, por askush nuk u përgjigj.

Ne vendosëm të ishim këmbëngulëse dhe pritëm. Motra, Monika, më në fund erdhi dhe na tha se ishte e zënë. E vumë re që ishte e lodhur dhe gati sa s'po qante. Kur i thamë se ishim atje për ta ndihmuar, ajo na lejoi të hynim. Foshnja e saj po qante, ndaj i thamë të kujdesej për foshnjën dhe do ta prisnim. Kur Monika u ngjit lart me foshnjën, ne filluam punën, duke pastruar disa dhoma dhe duke i palosur të gjitha rrobat që mund të shihnim.

Kur Monika pa se sa mirë dukej shtëpia, filloi të qante, na hapi zemrën dhe na tregoi disa nga sfidat e veta. Ne i premtuam se do ta ndihmonim dhe folëm me presidenten e Shoqatës së Ndhmës për sfidat e saj. Të dielën e ardhshme, Monika ishte në Kishë.

Monika u bë një motër aktive dhe e lumtur dhe ne vazhduam t'i japim asaj shërbesë me dashuri dhe me kujdes. Ajo i kishte ende po ato sfida, por ishte në gjendje t'u bënte ballë atyre me më shumë besim e guxim për shkak të aktivitetit të saj në Kishë.

Jam shumë mirënjohëse për shembullin e Grases ndërsa shërbyem së bashku. Ishim lutur për udhërrëfim dhe Perëndia na kishte drejtuar te Monika. ■

Rozana Soares, Jutë, SHBA





Ato Mbollën një Farë në Zemrën Time

Nga erdha unë? Çfarë po bëj këtu? Ku do të shkoj pas kësaj jete?

Kur isha 29 vjeçe, këto pyetje më vinin shpesh në mendje. Prindërit e mi kishin ndërruar jetë. Vajtova për humbjen e foshnjës sime të parë djalë. Kisha tre fëmijë të tjerë për të rritur dhe një jetë plot me sfida.

Zoti filloi t'u jepte përgjigje pyetjeve të mia kur udhërrëfeu dy misionare të reja për në shtëpinë time. Kur i mirëpritja brenda, ato më pyetën a kishte diçka që ndieja se po më mungonte në jetë. U tregova atyre për prindërit e mi dhe birin tim. U thashë atyre se mendoja se nuk ishte e drejtë të kesh fëmijë dhe të krijosh familje nëse gjithçka përfundon thjesht me vdekjen. I pyeta nëse do t'i shihja edhe një herë prindërit dhe birin tim.

"Marta", thanë ato, "ti mund ta kesh përgjithmonë familjen tënde."

Zemra m'u mbush me gëzim. Doja të dija më shumë. Në vizitën e tyre të

ardhshme, ato më mësuan më shumë për ungjillin e Jezu Krishtit. Më dhanë një Libër Mormoni dhe më sfiduan që ta lexoja dhe të pyesja Perëndinë nëse ai është fjala e Tij. E pranova sfidën e tyre. Kur u luta, përgjigjja e Perëndisë erdhi e qartë si drita e diellit. E dija në zemër se ishte i vërtetë.

Fatkeqësisht, kur fillova një punë të re, i humba lidhjet me misionaret. Në muajt që pasuan, martesë ime mori fund dhe u përpoqa të nisja një jetë të re me fëmijët e mi.

Përfundimisht, u martova sërish. Një ditë, bashkëshorti im tha se i mungonte Perëndia në jetën e tij. Vendosëm të merrnin pjesë në kishën ku ai kishte marrë pjesë dikur. Kur hymë në ndërtesë, pashë një Libër Mormoni mbi një tavolinë në sallon. Kjo ishte e njëjta kishë që ma kishin paraqitur më parë! Më pëlqeu shumë Shpirti që ndjeva atje. Kur u larguam, e pyeta bashkëshortin se si mund të pagëzohesha.

Ndieja se duhet t'u tregoja motrave që më kishin dhënë mësimet në fillim, se isha bashkuar me Kishën dhe se ato kishin mbjellë në zemrën time farën e ungjillit të rivendosur.

"Ke nevojë të marrësh mësimet nga misionaret", tha ai.

"I kam marrë ato pesë vjet më parë!" iu përgjigjja.

Unë dhe fëmijët e mi i kishim marrë mësimet. Dita e pagëzimit ishte dita më e lumtur e jetës sonë.

Disa vite më vonë, ndjeva se duhet t'u tregoja motrave që më kishin dhënë mësimet në fillim, se isha bashkuar me Kishën. Në Facebook, gjeta një grup misionarësh dhe misionarësh të kthyer nga Misioni i Brazilit, Santa-Maria. Ai përfshinte njërin nga motrat që më kishin dhënë mësim. I dërgova kërkesë për t'u bërë shoqe dhe i thashë se kush isha, se si u bëra anëtare e Kishës, se familja jonë ishte vulosur në tempull dhe se djali im po shërbente një mision kohëplotë. I thashë asaj që e gjitha kjo u bë e mundur për shkak se ajo dhe shoqja e saj e misionit kishin mbjellë në zemrën time farën e ungjillit të rivendosur. ■

Marta Algarve, Santa-Katarinë, Brazil



Mbusha dy çanta me ushqime dhe mora rrugën për në shtëpinë e një motre në lagjen time.

Një Bekim nga Shpërblimi

Gruaja ime, Karmeni, dhe unë sapo u bëmë me fëmijën tonë të parë kur u thirra për të qenë peshkopi i lagjes sonë. Në atë kohë, kishim probleme financiare. Për mua u bë stresuese të siguroja të ardhura për familjen dhe në të njëjtën kohë t'i mbikëqyrja dhe të kujdesesha për anëtarët e lagjes sonë.

Një të diel, vura re një nënë të pamartuar me katër fëmijët e saj të vegjël në mbledhjen e sakramentit. Ajo u ul në stolin e fundit të sallës kishtare dhe u përpoq me sa mundi që t'i mbante fëmijët të qetë. E dija që dhe ajo kishte probleme financiare, por asnjëherë nuk kërkoi ndihmë. Kaluan javë dhe çdo të diel ajo erdhi në kishë me fëmijët e saj.

Një ditë, mora rrogën. I bekuar që mora një shpërblim, vendosa t'i përdorja paratë shtesë për të blerë furnizime për meremetimet aq të nevojshme në

shtëpinë time. Por ndërsa po shkoja drejt tregut, më erdhën në mendje kjo motër dhe fëmijët e saj. Ndjeva se duhet t'i përdorja paratë shtesë për të blerë ushqime për ta. I telefonova Karmenit dhe i tregova se çfarë ndjeva se duhej të bëja. Ajo ra dakord.

Ndërsa bëja pazar, sytë më shkuan te disa ëmbëlsira. Mendova se ndoshta fëmijëve do t'u pëlqenin disa gjëra të ëmbla. Mbusha dy çanta me ushqime dhe mora rrugën për në shtëpinë e kësaj motre.

Trokita disa herë në derën e konsumuar prej druri. Kur isha gati të largohesha, dera më në fund u hap. "Peshkop", tha motra, "habitem që të shoh këtu." Në çast fëmijët e saj dolën me vrap nga prapa saj.

"Ju solla disa ushqime", i thashë.

Njëra nga vajzat gjeti biskotat dhe bërtiti: "Biskota!" Vëllezërit dhe motrat

e saj u mblodhën përreth të emocionuar. Vajza shtatëvjeçare më përqafoi. "Faleminderit, Peshkop!" tha ajo.

Hodha sytë brenda shtëpisë dhe pashë që kjo motër i kishte larë rrobat në një legen në dysheme. Familja nuk kishte tavolinë dhe flinte në një dyshek në dysheme. E kuptova se sa nevojtarë ishin. Bëra përgatitjet që të sigurohesha që të kishin një tavolinë dhe që secili pjesëtar i familjes të kishte një shtrat.

Kjo përvojë më ndihmoi të kuptoja se Zoti i udhërrëfen dhe i bekon shërbëtorët e Tij. Nuk kemi nevojë për një thirrje të veçantë me qëllim që t'i ndihmojmë vëllezërit dhe motrat tona. Thjesht duhet të jemi në harmoni me Shpirtin, ta dallojmë se kush ka nevojë për ndihmën tonë dhe të jemi të gatshëm të jemi mjete në duart e Zotit. ■

Roberto Atunkar Nieto, Limë, Peru

Dy Faqe Plot me Mirënjohje

Babai im vuajti gjithë jetën nga vetë-vlerësimi i ulët dhe ndjesia se ishte një njeri pa vlerë. Ai u rrit nga një baba i alkoolizuar, i cili shpesh i thoshte se sa i pavlerë mendonte se ishte ai. Fatmirësisht, babai im vetë kurrë nuk u bë i alkoolizuar, por ai asnjëherë nuk më tha mua dhe motrave e vëllezërve të mi se ishte krenar për ne ose të na lavdëronte për gjërat që kishim bërë mirë. Ndërsa rritesha, u përpoqa ta kënaqja, por gjithnjë ndieja se nuk mund të isha e mirë mjaftueshëm. Kjo na bëri të kishim një marrëdhënie të tensionuar.

Një vit, ia përmenda këtë peshkopit tim të urtë. Ai më këshilloi t'i shkruaja babai një letër duke i treguar atij të gjitha arsyet për të cilat isha mirënjohëse për të. Kjo nuk do të ishte aspak e lehtë për mua. Plagët e mia ishin të thella dhe nuk doja që letra ime e mirënjohjes të bëhej një letër pakënaqësie. Ndaj u luta. Me Shpirtin që më udhërrëfeu, arsyet për të cilat isha mirënjohëse për babanë tim, filluan të vërshonin. U desh kohë, por kur mbarova, kisha mbushur dy faqe plot.

E dërgova letrën time, duke mos e ditur se si do të reagoje babai. Por e dija se nuk mund ta zgjidhja reagimin e tij. Kisha nevojë thjesht të shihja brenda vetë zemrës sime dhe të kujtoja përse e kisha shkruar letrën.

Mëngjesin tjetër, mora një telefonatë

nga njerka. Ajo po qante. Ajo më tha se babai e kishte lexuar letrën shumë herë. Ajo më tha se ai nuk mund të fliste me mua sepse po qante me dënësë.

“Faleminderit!” tha ajo. “Babai yt kishte nevojë për këtë.”

Më vonë atë ditë, babai më telefoni për të më falënderuar. Ai më telefoni çdo ditë, për ditë me radhë, për të shprehur se sa shumë domethënie kishte letra për të.


Do të doja të thosha që marrëdhënia jonë u rregullua për mrekulli, por ende kishim shumë punë për të bërë. Me kalimin e kohës, zemra ime filloi të shërohej dhe marrëdhënia jonë u

përmirësua. Përfundimisht, isha në gjendje ta falja atë.

Disa vite më vonë, pas një beteje të jashtëzakonshme me kancerin, babai im vdiq. Jam e sigurt se tani ai po përjeton gëzim të madh ndërsa Shpëtimtari e ndihmon të shërohet nga vitet e keq-trajtimet. Unë e di se kam përjetuar shërim nëpërmjet fuqisë së Shlyerjes së Jezu Krishtit. Shpëtimtari i kupton nevojat tona dhe mund të na ndihmojë ta heqim helmin e lëndimeve dhe pakënaqësive nga shpirtrat tanë. Unë e di se mirënjohja, falja dhe dashuria janë melheme të fuqishme. ■

Elis Dalen, Jutë, SHBA

Babai im e lexoi letrën time shumë herë. Ai nuk mund të fliste me mua sepse po qante me dënësë.





QËNDRIMI NDAJ PORNOGRAFISË:

Mbro, Reago dhe Shëro



Nga Xhoi D. Xhons,
Presidente e
Përgjithshme e
Fillores

Këto tri zbatime të dashurisë mund t'i ndihmojnë fëmijët tanë në takimet e befta me pornografinë me të cilat mund të përballen.

Jam dhembshëm e vetëdijshme për ndikimin e pornografisë madje dhe mbi më të vegjlit në shoqërinë tonë – te fëmijët tanë. Një plagë me përmasa epike, pornografia mund të shkaktojë turpërim, mashtrim, ndjenja të shtrembëruara, humbje të vetëkontrollit, varësi dërrmuese dhe shpenzim të përgjithshëm të kohës, mendimit dhe energjisë. Ka një nevojë të madhe që të gjithë ne – prindër, familjarë, mësues, udhëheqës – vërtet t'i shohim, vlerësojmë dhe mbrojmë fëmijët dhe të rinjtë tanë.

Dashuria është një nga dhuratat më të mëdha të Perëndisë. Ta duam Perëndinë dhe ta duam të afërmin tonë janë dy urdhërimet më të mëdha që na janë dhënë nga Vetë Jezu Krishti. Dashuria, besoj unë, është gjithashtu arma jonë më e madhe në luftën kundër pornografisë.

Vërtet, ashtu si thotë motoja e njohur: “Pornografia e vret dashurinë”, por le ta kujtojmë gjithashtu se dashuria e vret pornografinë. Kjo nuk do të thotë se dashuria jonë për dikë tjetër mund ta ndryshojë varësinë ose madje sjelljen e tij apo të saj. Por dashuria mund të na japë shtysë – në mënyrën se si përgatitemi, si reagojmë, si dëgjojmë – veçanërisht me fëmijët tanë. Nëse do të kemi ndonjë shpresë për ta çrrënjësuar këtë plagë nga bota, dashuria duhet të jetë edhe në ballë edhe në themel të të gjitha përpjekjeve tona.

Dëshiroj të sugjeroj tri zbatime të dashurisë ku shpresoj se do të përqendrohemi, të cilat do t'i përqafojmë dhe do t'i vëmë në veprim. Këto tri zbatime lidhen me tri faza të takimeve të befta me pornografinë me të cilat mund të përballen fëmijët tanë.

Së pari, ne themi: “Të dua”, duke i mbrojtur vërtet ata. Së dyti, themi: “Prapëseprapë të dua”, me anë të mënyrës se si reagojmë për ekspozimin e tyre ndaj pornografisë, qoftë i qëllimshëm ose jo. Dhe së treti, ne themi: “Gjithmonë do të të dua”, duke dhënë përkrahje plot dashuri për ata teksa punojnë për shërimin nëse kanë përjetuar përdorim me fiksion ose varësi. Në secilën fazë, dashuria është kyçi.

Ky problem po ndikon te djemtë tanë dhe te vajzat tona dhe ne nuk po flasim mjaftueshëm për të.



1 MBROJTJA: “TË DUA”

Përfytyrojeni në mendje një fëmijë që e doni. Kur i thoni këtij fëmijë: “Të dua”, çfarë do të thotë kjo? Në thelb, kjo do të thotë se ne sigurojmë mbrojtje kështu që të mund t’i ndihmojmë ata që i duam, që të bëhen më të mirët që mundën dhe të përballen me sfidat e jetës. Pjesë e mbrojtjes është të krijohen marrëdhënie mirëbesimi, të fuqishme dhe të qëndrueshme. Këto lloje marrëdhëniesh ndihmojnë për t’u afruar me fëmijët tanë. Teksa ndërtojmë marrëdhënie të forta mirëbesimi dhe i mbrojmë fëmijët dhe nipërit e mbesat tona – ose cilindo fëmijë – ne u japim atyre një vend të sigurt tek i cili të drejtohen. Kjo mbrojtje i ndihmon ta kuptojnë se cilët janë dhe i ndihmon ta marrin vesh marrëdhënien e tyre me Perëndinë. Kur e ndiejnë se i vlerësojnë dhe i duan, kjo i ndihmon fëmijët ta përfytyrojnë një Atë përkujdesës Qjellor, që jep udhëzime për lumturinë e tyre, dhe të mbështeten tek Ai.

Jam e shqetësuar që shumë prindër mund të mos ta kuptojnë ende se sa e rrezikshme është me të vërtetë pornografia, ose mund të mendojnë se

është problem vetëm për njerëzit e tjerë. Realiteti është se ky problem po ndikon te djemtë tanë dhe te vajzat tona dhe ne nuk po flasim mjaftueshëm për të.

Shumë vjet më parë, bashkëshorti im dhe unë dëgjuam një rrëfenjë kuptimplote që ua kemi përsëritur shpesh fëmijëve tanë. Rrëfenja është për një gjarpër të moshuar me zile, i cili i kërkoi një djali të vogël që po kalonte pranë, që ta mbartte deri te maja e malit që të shihte një perëndim të fundit të diellit përpara se gjarpri të vdiste. Djaloshi ngurroi por gjarpri me zile premtoi se nuk do ta kafshonte si këmbim për udhëtimin. Pas këtij lëshimi, djaloshi me dashamirësi e mbarti gjarprin deri në majë të malit ku ata e vështruan së bashku perëndimin e diellit.

Pasi e mbarti gjarprin sërish poshtë në luginë, djaloshi përgatiti një vakt ushqimi për veten dhe një shtrat për të kaluar natën. Në mëngjes, gjarpri pyeti: “Të lutem, djalë i vogël, a do të më çosh sërish te shtëpia ime? Është koha që tani unë të largohem nga kjo botë dhe dëshiroj të

kthehem te shtëpia ime.” Djali i vogël e ndjeu se kishte qenë i sigurt dhe se gjarpri e kishte mbajtur fjalën, kështu që vendosi ta çonte gjarprin në shtëpi siç kërkoi.

Ai e mori gjarprin me kujdes, e mbajti pranë kraharorit dhe e mbarti sërish në shkretëtirë te shtëpia e tij që të vdiste [atje]. Pikërisht përpara se ta ulte poshtë, gjarpri me zile u kthye dhe e pickoi në kraharor. Djali i vogël bërtiti dhe e flaku gjarprin përtokë. “Zoti Gjarpër, përse e bërë këtë? Tani unë do të vdes me siguri!” Gjarpri me zile i ngriti sytë dhe u ngërdhesh: “Ti e dije se çfarë isha kur më more”.

Në botën e sotme, shoh shumë prindër që i dorëzojnë një gjarpër fëmijës së tyre. Po flas për telefonat inteligjentë. Ne nuk mund t’ua vëmë në duar telefonat celularë me qasje në internet fëmijëve të vegjël që nuk janë mjaft të rritur sa të kenë marrë mësim mjaftueshëm, që nuk i kanë ende aftësitë e domosdoshme për arsyetim dhe marrje vendimesh, si dhe nuk kanë kontrollin prindëror dhe mjete të tjera që t’i ndihmojnë për t’i mbrojtur. Xhejson S. Keroll, profesor për jetën familjare në Universitetin “Brigam Jang”, pohoi: “Ne i mbajmë të sigurt fëmijët tanë deri në kohën kur ata mund të ruhen vetë”. Baza e trurit që mban qendrat e kënaqësisë në tru, zhvillohet e para. Vetëm më vonë zhvillohen plotësisht aftësitë e arsytimit dhe marrjes së vendimeve në koren ballore. “Kështu që fëmijët e kanë pedalin e gazit pa pedalin e plotë të frenave.”¹

Çdo telefon duhet të ketë masa mbrojtëse, edhe ata të adoleshentëve. Kjo është gjithashtu një këshillë e mirë për të rriturit. Asnjë nuk është i paprekshëm nga pickimi i një gjarpri helmues. Disa prindër zgjedhin telefonat me palosje për fëmijët e tyre që ta kufizojnë përdorimin vetëm për thirrje telefonike dhe për shkëmbim mesazhesh.

Përveç telefonave inteligjentë ka pajisje të tjera të panumërta me të cilat mund të qasesh në media të padëshiruara nëpërmjet internetit. Një studim i kohëve të fundit tregoi se 79 për qind e [rasteve të] ekspozimit të padëshiruar ndaj pornografisë ndodhin në shtëpi.² Fëmijët mund të ekspozohen ndaj saj në kompjutera dore, telefona inteligjentë, panele komandimi për

lojëra, aparate DVD-je portativë dhe televizorë inteligjentë, thjesht sa për të përmendur disa pajisje. Njoh familje që kanë caktuar një zonë të vetme, ku ndodhen shumicën e kohës, në shtëpinë e tyre, ku përdoren pajisjet elektronike. Këto familje e quajnë atë një “dhomë e medias” dhe të gjitha pajisjet e tyre i mbajnë të dukshme, në dritë. Asnjëherë nuk qëndron ndonjë person vetëm në dhomë me një pajisje ku sheh media.

Familje të tjera kanë zgjedhur rregulla të tilla si: “Nuk lejohen telefonat në dhomat e gjumit ose në tualete”. Disa thonë thjesht: “Asnjëherë të mos jesh vetëm me një telefon”. Të tjerë akoma e shtojnë shkallë-shkallë qasjen në aplikacionet që mund t’i përdorin fëmijët e tyre, me programe të cilat lejojnë që telefoni i fëmijës të konfigurohet nga prindi. Në këtë mënyrë, ata japin mësim se mirëbesimi fitohet dhe se siguria e telefonit është e rëndësishme.

Cilatdo qofshin nevojat për familjet tona të veçanta, le ta mësojmë secilin pjesëtar të familjes që ta përdorë teknologjinë me urtësi dhe pozitivisht që nga fillimi – të zhvillojë një model të moralshëm mendimi. Le t’i edukojmë fëmijët me mënyra dobiprurëse që ta përdorin teknologjinë për mirë. Mund t’u mësojmë atyre të vlerësojnë duke e pyetur veten: “Përdorimi i kësaj a do t’i shërbejë një qëllimi të mirë?” Zgjedhjet tona për mënyrën se si u japim mësim familjeve tona tani, do të ndikojnë te brezat e ardhshëm.

Si prindër, unë shpresoj se do ta marrim parasysht rëndësinë e marrëdhënieve me fëmijët tanë dhe përpjekjeve të veçanta që po bëjmë për t’i mbrojtur ata. Teksa i forcojmë këto marrëdhënie të dashura, fëmijët do ta kuptojnë më mirë se përse Perëndia paralajmëron ndaj të ligave të pornografisë, ata do ta dallojnë se si ta shmangin atë dhe do të jenë të përgatitur nëse vërtet e hasin atë.

2

REAGIMI: “PRAPËSEPRAPË TË DUA”

Krijimi i bashkëbisedimeve mirëpritëse, të hapura e ftuese që i nxitin fëmijët t’ua tregojnë prindërve të tyre mendimet, përvojat dhe pyetjet e tyre, nuk është i lehtë. Ne mund t’i ftojme fëmijët e të gjitha moshave që të vijnë e të flasin me ne nëse zhvillojnë në çfarëdo niveli një problem me pornografinë ose kur të ndodhë kjo – që nga ekspozimet e hershme, të shkujdesura në përdorim rastësor, deri te përdorimi i ngjeshur dhe më tej në përdorimin me fiksion. Diskutimet qysh herët janë më të mira dhe fëmijët do të shprehin me më shumë gatishmëri kur e dinë se i duan dhe se asgjë që thonë ose bëjnë, nuk mund ta ndryshojë atë dashuri.

Megjithatë, shumë rrallë një fëmijë shprehet vullnetarisht. Ajo ndodh zakonisht kur një prind vëzhgues e nxit fëmijën me [frazë të tilla si]: “A ka ndonjë gjë që nuk shkon?” ose “Nuk dukesh se po sillesh si zakonisht”. Sa më shumë dashuri që të ndiejë fëmija, aq më e lehtë është për atë që të hapet.

Kjo siguri për dashurinë është e ngulitur në mendjen e tyre nga përvoja të vogla që ndodhin vazhdimisht. Telashe të vogla për të cilat diskutohet në një mënyrë plot dashuri, krijojnë një themel për një reagim të shëndetshëm, kështu që, kur vijnë telashe të mëdha, komunikimi është ende i

hapur. Më e rëndësishmja, fëmijët e dinë se reagi juaj do të jetë: “Unë prapëseprapë të dua. Nuk do të resht së dashuri ngaqë ndodhi diçka. Unë gjithmonë të dua.”

Për njëfarë arsyeje, ne nuk flasim shumë me të rinjtë dhe fëmijët për një nga dëshirat më të forta dhe tundimet më të mëdha që ata do të hasin. Ngurrimi ynë bën që ata të marrin mësim kryesisht nga interneti, fëmijë ose adoleshentë të tjerë, ose madje mediat e njohura. Disa nga ne mund të jenë ngurrues që madje ta përdorin fjalën *pornografia* pranë fëmijëve në një përpjekje për ta mbrojtur dëlirësinë e tyre. Duket kaq e pavolitshme. Ndosh-ta prindërit tanë nuk na folën kurrë kaq hapur. Po sikur bashkëbisedimi ynë të nxitë kureshtjen? Po nëse ata duan të dinë më shumë? Si mund të presim që fëmijët tanë të flasin rreth pornografisë me ne, nëse ne kurrë nuk flasim rreth saj me ta?

Prindër, ne duhet ta fillojmë bashkëbisedimin dhe të mos presim që fëmijët të vijnë te ne. Më pëlqen shumë sugjerimi që të bëjmë bashkëbisedime të rregullta, të shpeshta, të rehatshme në vend që të jetë një ngjarje që ndodh një herë të vetme. Përfitimet nga bashkëbisedimet plot kujdes janë që prindërit dhe udhëheqësit e besuar janë ekspertët, jo Google-i; biseda mund të ndodhë në një mjedis të sigurt dhe biseda e rrit mirëbesimin e fëmijës. Ne dëshirojmë që fëmijët të ndihen të përgatitur dhe me fuqi, jo të trembur. Ne dëshirojmë të flasim me ta dhe jo t’u flasim atyre.

Si prindër dhe mësues, ne nuk mund t’i ndihmojmë fëmijët nëse nuk jemi të edukuar vetë. Dhënia mësim se *çfarë* [është pornografia] dhe *përse* [duhet ta shmangim] është thelbësore. Ne mund të mësojmë vetë dhe t’i ndihmojmë fëmijët ta kuptojnë se përse pornografia është e gabuar, përse është kaq e rrezikshme, përse ne nuk duam që ajo t’i lëndojë ata, dhe çfarë të bëjnë nëse e hasin atë.

A po u japim fëmijëve arsye të mjaftueshme për pyetjen *përse*, në mënyra të përshtatshme me moshën? Nëse e vetmja arsye që u japim atyre për ta shmangur pornografinë, është: “Është e keqe”, kjo mund të rezultojë një arsye e pamjaftueshme. Përkundrazi, duhet të paraqitim sa më shumë arsye përse që të mundemi, që të krijojmë një prirje morale që është shtysëdhënëse për rininë tonë.

Ka arsye të bollshme për ta shmangur pornografinë, por këtu janë vetëm disa shtysa nga organizata Fight the New Drug [Luftojë Drogën e Re], që mund të ngjallin interes për të rinjtë e të rejtat tona:

- Pornografia mund ta ndryshojë mënyrën se si funksionon truri juaj dhe studimet tregojnë se ajo madje mund ta zvogëlojë trurin tuaj dhe ta bëjë atë më pak aktiv.
- Pornografia mund të jetë varësuese.
- Pornografia do ta shkatërrojë mirëbesimin tuaj te vetja.
- Pornografia mund t’ju lërë të vetmuar.
- Pornografia mund t’i lëndojë njerëzit që i doni.
- Pornografia mund ta shkatërrojë seksualitetin e shëndetshëm.
- Pornografia është e lidhur me dhunën.
- Pornografia mund të shkaktojë që njerëzit përfundimisht të bëhen të pandershëm.
- Pornografia do t’ju grabitë kohën dhe energjinë tuaj.
- Pornografia shkakton depresion, ankth dhe ndjenja turpërimi.

Do të shtoja se pornografia është kundër urdhërimeve të Perëndisë. Me këto dhe një mori arsyesh të tjera, ne po ngremë çështjen kundër pornografisë, por dijenia pa vënie në zbatim çon drejt zhgënjimit. Ne duhet të vendosim kufizime, kufij dhe pritshmëri të arsyeshme dhe të dobishme. Ndiham ndaj fëmijëve që të krijojnë arsyetimin e tyre të brendshëm për dëshirën që të qëndrojnë larg pornografisë, është thelbësore. Nëse një fëmijë nuk vendos për veten se ku të qëndrojë në këtë çështje, ai ose ajo me gjasë do të bëhet pjesë e statistikave tronditëse të tanishme.

3 SHËRIMI: “GJITHMONË DO TË TË DUA”

Kur fëmijët ekspozohen ndaj pornografisë dhe zihen në grackë nga ajo, ata përpiqen të reagojnë, ta marrin veten dhe të shërohen. Nevojitet përkrahje e sigurtë, e zellshme, e vazhdueshme, e qëndrueshme dhe me durim teksa fëmijët marrin përgjegjësinë për ta marrë veten dhe për të vazhduar të ecin përpara. Asnjë nuk mund ta sigurojë këtë lloj përkrahjeje ashtu si mund ta bëjë një prind. Pasi ne ta kemi dhënë mësim me kujdes dhe personalisht të vërtetën, pasi me butësi të kemi ndërtuar mirëbesim dhe të kemi nxitur bashkëbisedime, atëherë fëmijët kanë nevojë ta dinë se, pavarësisht nga gabimet dhe zgjedhjet e tyre, sigurimi ynë do të jetë: “Unë gjithmonë do të të dua pavarësisht gjithçkaje”.

Më kujtohet një rast i thjeshtë që ndodhi në familjen tonë vite më parë. Bashkëshorti im dhe unë kishim dalë nga shtëpia dhe biri ynë më i madh po kujdesej për fëmijët e tjerë. Morëm një telefonatë nga një fqinj i shqetësuar që na dha alarmin se një makinë zjarrfikëse ishte te shtëpia jonë. Ne nxituam për në shtëpi dhe pamë se biri ynë 10-vjeçar kishte qenë duke luajtur në oborrin e pasmë pranë një fushe prej dy hektarësh e gjysmë me bar të gjatë e të thatë. Ai po përpiquej të shihte nëse mund të ndizte një zjarr me shkëndija.

Sigurisht që e bëri! Në kohën kur mbërritëm ne, zjarri i vogël ishte



Gjeni më shumë burime në internet te overcomingpornography.ChurchofJesusChrist.org.

fikur nga zjarrfikësit, ata i kishin dhënë mësim birit tonë dhe fqinjët kishin filluar të shpërndaheshin. Biri ynë ishte në siklet, i frikësuar, plot lot dhe e dinte se sigurisht ishte në telashe.

Të gjithë ne shkuam në shtëpi. Biri ynë ishte kaq i frikësuar saqë, edhe pse gjendja ishte e rëndë, gjithçka mund të bënim ishte ta rrokim në krahët tona këtë djalë të ëmbël dhe ta siguronim për dashurinë tonë dhe lehtësimin tonë që ai nuk ishte lënduar.

Kur fëmijët ekspozohen ndaj pornografisë dhe veçanërisht kur kapen në rrjetën e saj, edhe ata do të jenë në siklet, të frikësuar dhe plot lot. Është e vështirë ta marrësh diçka që ka qenë në errësirë dhe ta ekspozosh atë ndaj dritës. Ajo të shkakton turp dhe të bën të ndihesh i cenushtëm. Ata mund të kenë dështime dhe sfida përgjatë rrugës teksa marrin veten dhe shërohen. Nevoja e tyre për dashuri të vazhdueshme është vendimtare. Megjithatë, prindërit kanë nevojë të jenë të vetëdijshëm se dashuria e tyre do të ndihmojë gjithmonë por nuk do të jetë gjithçka që nevojitet.

Gjatë shërimit, juve do t'ju duhet ta kanalizoni një pjesë të asaj dashurie që keni për fëmijën tuaj, drejt gjetjes së burimeve të drejta

për ndihmë. Dashuria juaj është një themel për atë që ka nevojë të ndodhë, por nëse dikush që e doni është zënë në grackë, ka gjasa që të keni nevojë të kërkoni profesionistë të cilët mund t'i ndihmojnë njerëzit tuaj të dashur dhe gjithashtu t'ju ndihmojnë ju.

Teksa ju dhe njerëzit tuaj të dashur kërkojnë shërim, shpresoj se ju do të gjeni forcë tek i Vetmi që ka fuqinë t'i shërojë të gjitha plagët, t'i lidhë njerëzit së bashku dhe të krijojë marrëdhënie krejt përtej aftësisë sonë të tanishme për ta përfytyruar. Shpëtimtari ynë, Shëruesi i dashur, ka fuqinë të shpëtojë. Ne mund të jemi prindër për fëmijët tanë dhe t'i drejtojmë ata tek Ai, por vetëm Ai mund të jetë Shpëtimtari i tyre. Dhe gjëja e mrekullueshme është se Ai i do fëmijët tanë edhe më shumë përsosurisht nga sa i duam ne – pavarësisht të gjithave. ■

Nga një fjalim kryesor i mbajtur në konferencën e vitit 2018, Koalicioni i Jutës Kundër Pornografisë, në Solt-Lejk-Siti në Jutë.

SHËNIME

1. Jason S. Carroll, në Lisa Ann Thomson, "Eight Strategies to Help Children Reject Pornography", *Liahona*, gusht 2017, f. 19.
2. "The Facts about Online Threats", *Parents Television Council Watchdog* (ditar në internet), 21 qershor 2017, w2.parentstv.org/blog.

Të Rinjtë në Moshë Madhore

Në Këtë Pjesë

44 Dalja në Takime dhe Pornografia

Nga revista *Liahona* dhe personeli i Shërbimeve për Familjen

Vetëm në Format Elektronik

Si Mësova të Reagoj kur Dikush e Pranon se po Lufton me Pornografinë

Emri nuk jepet, Jutë, SHBA

Ecja Përpara pasi Mësova se i Fejuari Im po Përdorte Materiale Pornografike

Emri nuk jepet, Polinezia Franceze

Unë Kisha Luftuar për ta Kapërcyer Pornografinë. Përse Nuk do ta Bënte Ai?

Emri nuk jepet, Guatemalë

Gjejini këta artikuj dhe më shumë:

- Te Liahona.ChurchofJesusChrist.org
- Tek **E Përjavshmja për TRMM-të** (në pjesën "Të Rinjtë në Moshë Madhore" te programi kompjuterik Gospel Library [Biblioteka e Ungjillit])
- Te [facebook.com/liahona](https://www.facebook.com/liahona)

Tregojeni Historinë Tuaj

A keni ndonjë histori për të treguar? Apo, a dëshironi të shihni artikuj mbi tema të caktuara? Mund t'i dorëzoni artikujt tuaj ose përshtypjet tuaja te Liahona.ChurchofJesusChrist.org.

Të Kërkosh Krishtin në Vend të Errësirës së Pornografisë

Kur planifikojmë artikujt për të rinjtë në moshë madhore, ne shpenzojmë shumë kohë duke menduar për çështjet me të cilat ata po përballen tani. Ka kaq shumë. Por teksa po shkëmbejmë mendime për këtë muaj, u drejtua te një temë që na ka prekur ne personalisht, shokët tanë dhe njerëz të tjerë të panumërt: dalja në takime dhe pornografia. E dinim se planifikimi për këtë pjesë do të ishte i vështirë. Në fund të fundit, pornografia ndikon te kaq shumë njerëz në mënyra që e copëtojnë zemrën, nganjëherë jetëshkatërruese. Dhe për të rinjtë në moshë madhore beqarë, ajo mund ta bëjë të ardhmen të duket edhe më të pasigurt nga sa e bën tashmë, veçanërisht gjatë përgatitjes për martesë.

Ne vërtet e pamë dorën e Atit Qiellor të na e udhërrëfente punën tonë teksa filluam të marrim ngjarje nga të rinj në moshë madhore marrëdhëniet e të cilëve ishin ndikuar nga pornografia. Dhe e shohim se ka më shumë sesa vetëm një grimë shpresë për martesë të përjetshme të lumtura dhe pa varësi. Përse? Sepse secila ngjarje më vetë dëshmon për fuqinë jetëndryshuese, shpresëdhënëse, shëruese të Jezu Krishtit dhe Shlyerjes së Tij.

Pra, nëse e shihni veten në një marrëdhënie që është prekur nga pornografia, ju ftojme ta lexoni pjesën e këtij muaji me artikujt të treguar nga njerëz të tjerë të lënduar, të cilët e dinë fare mirë se beteja kundër pornografisë është e vërtetë. Këta artikuj trajtojnë tema të tilla se si ta ngrini çështjen e pornografisë kur po dilni në takime dhe se si ta trajtoni atë (faqe 44), si të reagoni kur dikush e pranon se po lufton me pornografinë (vetëm në format elektronik), se si falja dhe shërimi janë të mundur për të dy njerëzit (vetëm në format elektronik) dhe se si Shpirti mund t'ju drejtojë ta dini se si të vijoni në marrëdhënien tuaj (vetëm në format elektronik).

E dimë që, nëse ju mbështeteni te Shpëtimtari dhe e ftoni Shpirtin në jetën tuaj teksa kërkon përgjigje, Ati Qiellor do t'ju udhëheqë në drejtimin e duhur për gjendjen tuaj të pashoqe. Errësira e pornografisë mund të jetë e spikatur në botë, por drita shëruese e Shpëtimtarit shkëlqen më shumë se cilado errësirë. Gjithçka na duhet të bëjmë, është ta kërkojmë Atë.

Sinqerisht,

Çejkëll Uordlei dhe Mindi Selu

redaktorët e pjesës kushtuar të rinjve në moshë madhore të Revistave të Kishës

Lexojeni këshillën e Presidentit M. Rasëll Ballard mbi atë se çfarë të bëni kur marrëdhënia juaj që krijohet nga daljet në takime, ndikohet nga pornografia në artikullin e tij në formatin elektronik të revistës *Liahona* të këtij muaji.



FOTOGRAFIA NGA GETTY IMAGES. PËRDORUR PËR QËLLIME ILLUSTRUJES. POZUAR NGA MODELE

TË RINJTË NË MOSHË MADHORE



Dalja në Takime dhe Pornografia

Nga revista *Liahona* dhe personeli i Shërbimeve për Familjen

Si të rinj e të reja në moshë madhore, të gjithë ne e dimë se dalja në takime mund të jetë emocionuese, frikësuese, përmbushëse dhe stresuese, të gjitha në të njëjtën kohë. Kur fillojmë të flasim hapur me njëri-tjetrin, natyrisht dëshirojmë të dimë më shumë për njëri-tjetrin dhe rritja e cenusshmërisë është e rëndësishme në ndërtimin dhe thellimin e marrëdhënieve. Cilat janë ëndrrat, gjërat që na frikësojnë dhe bindjet tona? Si ndihemi për martesën dhe familjen? Me çfarë sfidash jemi përballur në të shkuarën apo tani të cilat duhet t'ia tregojmë njëri-tjetrit?

Sado frikësuese të mund të jetë të flasësh (ose të pyetësh) për problemet me pornografinë, të mos flasësh për të mund të çojë në probleme shkatërruese

më vonë. Secili problem vetjak me pornografinë është i pasqyruar dhe sfidues dhe ju mundet që as mos ta dini a është problem apo si ta hapni diskutimin me personin me të cilin/ën po dilni në takime, kështu që është e rëndësishme që ju të kërkonti udhërrëfim nga Shpirti. Nuk ka një zgjidhje të vetme për çdo situatë, por në këtë artikull, ne japim disa sugjerime për ata prej jush që mund të jenë duke pyetur veten:

- Si mund t'i qasem temës së pornografisë me personin me të cilin/ën po dal në takime? Dhe kur është e përshtatshme të pyes/tregoj?
- Si mund ta di nëse duhet ta vazhdoj një marrëdhënie me dikë që ka një histori me përdorimin e pornografisë?
- Si mund të punojmë së bashku për ta kapërcyer pornografinë?

Ndihmë dhe shpresë për përballjen me pornografinë në marrëdhëniet që krijohen nga daljet në takime.

Shënim i redaktorëve: Për shkak se fjalët "dalje në takime" nënkuptojnë gjëra të ndryshme në kultura të ndryshme, për qëllimet e këtij artikulli, ne nënkuptojmë daljen në takime, brenda standardeve të ungjillit, me qëllim që ta njohim dikë dhe të krijojmë një marrëdhënie me të që ka mundësinë të çojë drejt martesës.



Për Ata që Kanë Luftuar ose po Luftojnë Tani

Nëse keni luftuar me pornografinë në të shkuarën ose nëse po luftoni tani, mendimi që të dilni në takime mund t'ju sjellë një ndjesi të mungesës së shpresës ose një ndjesi ankthi. Por nëse keni një dëshirë të sigurtë që ta largoni pornografinë nga jeta juaj (ose e keni larguar tashmë atë), dijeni se me vetë përpjekjet tuaja dhe me ndihmë nga Ati Qellor dhe Jezu Krishti, një marrëdhënie e shëndetshme që zgjat është e mundur për ju. Merrini parasysh pyetjet që vijojnë kur kërkonin një marrëdhënie.

1. A Kemi Vërtet Nevojë të Flasim për Të?

Një pyetje e zakonshme është: "A më duhet vërtet t'ia tregoj historinë time me përdorimin e pornografisë personit me të cilin/ën po dal në takime, edhe nëse jam penduar për të?" Ose: "A më duhet të flas për problemet e tanishme me pornografinë me personin me të cilin/ën po dal në takime?"

Në përgjithësi është e nevojshme të diskutohet – në kohën e duhur dhe me ndjeshmëri. Teksa keni këtë bashkëbisedim, mbani në mendje disa parime të rëndësishme:

- Koha – Bashkëbisedimi duhet të ndodhë kur marrëdhënia përparon te një fazë serioze që do ta kërkonte atë natyrshëm.
- Ndershmëria – Marrëdhëniet duhet të bazohen te mirëbesimi dhe ndershmëria. Edhe pse personi me të cilin/ën po dilni në takime mund të zgjedhë t'i japë fund marrëdhënies, ai/ajo ka nevojë ta kuptojë natyrën e problemit, përparimin tuaj të tanishëm në trajtimin e tij dhe planin tuaj për t'u përballur me të nëse ju shfaqet sërish në të ardhmen.
- Falja – Të qenit të ndershëm me personin me të cilin/ën po dilni në takime mbi faktin që përdorni pornografi, nuk do të thotë se nevojitet të jepni hollësi të gjalla kur diskutoni për të. Nëse jeni penduar dhe e ndieni se keni marrë falje, nuk duhet të ndiheni më fajtor/e për të. Zoti nuk i kujton mëkatet tona pasi ne të jemi penduar për to (shih Doktrina e Besëlidhje 58:42), kështu që diskutimi juaj me personin me të cilin/ën po dilni në takime, ka të bëjë më pak me "rrëfimin" dhe më shumë me ndërtimin e mirëbesimit, të treguarit e planeve tuaja për një proces përtëritjeje në vazhdim dhe sigurimit të përkrahjes së tij/saj.
- Shërimi – Edhe pse jeni penduar, përdorimi i zgjatur ose i ngjeshur i pornografisë mund të ketë pasoja afatgjata biologjike, psikologjike, shoqërore dhe shpirtërore. Procesi i shërimit mund të kërkojë shumë punë dhe kohë të gjatë, por përtëritja e plotë dhe shërimi i vërtetë janë të mundur. Gjatë atij procesi, juve do t'ju nevojitet ndihmë dhe përkrahje e përshtatshme, të cilat duhet ta përfshijnë bashkëshortin/en tuaj të mundshëm/me.

2. A Jam Gati për një Marrëdhënie Serioze?



Një nga ndryshimet më të mëdha mes dikujt që është gati për një marrëdhënie serioze dhe dikujt që nuk është, është gatishmëria e tij/saj për të qenë transparent me personin me të cilin/ën po del në takime. Nëse po luftoni me pornografinë, ju mundeni që ose ta lejoni frikën ta çojë marrëdhënien tuaj në një pikë mosbesimi ose ta përdorni besimin për t'i përballuar sfidat së bashku.

Edhe pse mund të jetë e parehatshme dhe e frikshme ta tregoni historinë tuaj me pornografinë, shmangia e kësaj mundet që vetëm t'i thellojë ndjenjat tuaja të frikës dhe turpit. Frika juaj se mos e humbni atë person madje mund të bëjë që ju ta mohoni ose ta shmangni tregimin e të gjithë historisë, gjë që



Për Ata që po Dalin në Takime me Dikë që Ka Pasur Probleme

Për shkak se moshë mesatare e ekspozimit të parë ndaj pornografisë është rreth moshës 11 vjeç dhe është kaq e lehtë qasja, shumica e të rinjve dhe të rejave kanë qenë të ekspozuar ndaj pornografisë në ndonjë mënyrë deri në moshën 18 vjeç. Kjo mund të jetë shqetësuese për sa i përket daljes në takime. Por ekspozimi nuk është një lloj si varësia dhe ka nivele të ndryshme të përfshirjes me pornografinë (shih Dallin H. Ouks, "Shpëtimi nga Kurthi i Pornografisë", *Liahona*, tetor 2015, f. 50–55). Lajmi i mirë është se Shlyerja e Jezu Krishtit mund të sigurojë forcë dhe shërim për të gjithë ata që e kërkojnë atë. Këtu janë disa pyetje për t'u marrë parasyshteksa marrëdhënia juaj përparon.

mund ta thyejë mirëbesimin dhe ta dëmtojë marrëdhënien tuaj më vonë.

Nga ana tjetër, kur e respektoni lirinë e zgjedhjes së personit me të cilin/ën po dilni në takime, ju do ta respektoni zgjedhjen e tij/saj për ta vazhduar marrëdhënien duke i ditur që të dyja, *të mirën dhe të keqen*. Ju ende mund t'i frikësoheni asaj që mund të ndodhë, por është e rëndësishme ta dalloni se, pasi është dhënë gjithë informacioni, personi tjetër gjithashtu mund t'ju ndihmojë në përpjekjet dhe dëshirën tuaj për ta larguar pornografinë nga jeta juaj. Por qoftë nëse marrëdhënia funksionon ose jo, me ndihmën e Perëndisë, ju mund të vazhdoni në shtegun e përtëritjes.

1. Kur dhe Si Duhet të Pyes Unë për Pornografinë?

Marrja e vendimit mbi çastin dhe mënyrën se si ta hapni këtë diskutim me personin me të cilin/ën po dilni në takime, mund të jetë diçka që ta diskutoni me prindërit tuaj, motrat e vëllezërit më të mëdhenj, udhëheqësit e Kishës, ose cilindo tjetër ku keni mirëbesim që të japë këshillë të mirë. Gjeni një mënyrë që duket e drejtë për ju dhe pastaj bëjeni atë bashkëbisedim në një kohë të përshtatshme, teksa i kushtoheni vetëm kësaj marrëdhënieje ose bëheni më seriozë në marrëdhënien tuaj.

Kjo nuk do të thotë se keni nevojë ta filloni një dalje të parë në takime me një marrje në pyetje për të shkuarën e tij/saj, por teksa marrëdhënia juaj përparon, ju mund të kërkonit frymëzimin e Shpirtit për t'ju ndihmuar ta dini se në ç'mënyrë dhe kur të kërkonit për historinë e tij/saj me pornografinë.

2. Si Duhet të Reagoj?

Kur ju dhe personi me të cilin/ën po dilni në takime, filloni të tregoni ndjenjat tuaja të ndershme, kjo mund të sjellë shërim. Është e rëndësishme të jeni të vetëdijshëm për vetë mendimet dhe ndjenjat tuaja teksa nxirret në shesh përdorimi i pornografisë – kjo mund të shkaktojë që ju të bëheni kritikues/e, i/e inatosur, i/e mpirë, apo të ndiheni i/e mashtruar. Por në të njëjtën kohë, nxjerrja në shesh prej tyre gjithashtu mund ta rritë mirëbesimin, dhembshurinë, dashurinë dhe ndjeshmërinë mes jush. Merrini parasyshteksa ndjenjat e tij/saj dhe tuajat teksa reagoni.



3. Si të Bëj Përpara?

Të zbuloni se personi me të cilin/ën po dilni në takime, ka një problem me pornografinë duhet të jetë një arsye për t'u shqetësuar, por mos e tradhtoni mirëbesimin e tij/saj duke ia treguar luftën vetjake të tij/saj njerëzve të tjerë. Komunikimi në mirëbesim me një peshkop apo terapist, ose, me lejen e personit me të cilin/ën po dilni në takime, me një mik ose udhëheqës të mirëbësuar, mund të jetë gjithashtu i dobishëm.

Kur të vendosni a ta vazhdoni marrëdhënien ose jo, ju vazhdimisht duhet të kërkonit udhërrëfim nga Shpirti. Por sugjerimet vijuese gjithashtu mund të jenë të dobishme:

- Pyetini ata se sa shumë ka ndikuar pornografia te jeta e tyre dhe se ku janë në procesin e shërimit. Ka nevojë që ata ta kenë treguar dëshirën e tyre për ta hequr pornografinë nga jeta e tyre duke ndërmarrë çfarëdo vepërimesh të duhura e të domosdoshme.
- Dallojeni se disa forma të përdorimit të pornografisë (për shembull pornografia me fëmijë) janë një tregues madhor se personi ka nevojë për ndihmë profesionale dhe mund të jetë i/e rrezikshëm/me.
- Kuptojeni se fuqia e Shlyerjes së Shpëtimtarit është e vërtetë. Ju mund të falni dhe ata mund të shërohen.
- Merrni vendim se ju nuk do të zgjidhni asgjë tjetër përveç ndershmërisë së plotë në marrëdhënien tuaj dhe denjësisë për t'u martuar në tempull.
- Kuptojeni se shërimi dhe përtëritja do të kërkojnë kohë. Përsëritjet e sjelljes mund të



ndodhin dhe ata që po përpiqen në procesin e përtëritjes, do të kenë nevojë për përkrahje. Kjo përfshin të kuptoni faktorët e tyre shkrepës (gjërat që mund të shkaktojnë që ata t'i kthehen pornografisë) dhe t'i përkrahni ose ndihmoni që të marrin masat mbrojtëse të përshtatshme.

- Nëse marrëdhënia juaj po përparon drejt martesës, sigurohuni që, që të dy, të bini dakord se pornografia është e papranueshme dhe nuk pasqyron një marrëdhënie seksuale martesore të shëndetshme.

Pjesa më e rëndësishme e bërjes përpara është mbështetja në atë që Fryma e Shenjtë ju nxit të bëni, e cila mund të jetë çfarëdo lloj gjëje, që nga vazhdimi i marrëdhënies me një kuptueshmëri se përdorimi i materialeve pornografike duhet të ndalojë, deri te përfundimi i marrëdhënies por vazhdimi i përkrahjes së përpjekjeve të tjetrit/ës për të ndryshuar. Çfarëdo që të vendosni, personi me të cilin/ën po dilni në takime, duhet ta kuptojë se gjërat mund të ndryshojnë në varësi nga përparimi i tij/saj ose mungesa e përparimit për kapërcimin e pornografisë.

Puna së bashku për ta Kapërcyer Pornografinë

Kapërcimi i pornografisë mund të kërkojë kohë dhe shumë punë, por është i mundur. Dhe së fundi, puna së bashku për ta kapërcyer atë, mund ta forcojë marrëdhënien tuaj teksa ju të dy fitoni një kuptueshmëri më të thellë për Shlyerjen e Jezu Krishtit dhe mësoni ta përkrahni njëri-tjetrin përmes kundërshtive. Merrini parasysh sa vijnë teksa punoni për ta kapërcyer atë së bashku:

- Faqja e internetit e Kishës **overcomingpornography.ChurchofJesusChrist.org** jep shumë burime (përfshirë informacion mbi programin e Kishës për shërimin nga varësitë) që mund t'ju ndihmojnë që të dy ju të lundroni në këtë proces shërimi.
- Merreni parasysh të keni një vend dhe kohë të veçantë që të diskutoni mbi pornografinë, kështu që kjo gjë të mos bëhet qendra e marrëdhënies suaj. Kur të flisni për të, mos e poshtëroni tjetrin/tjetren as mos e trajtoni me përçmim. Marrëdhënia juaj duhet të jetë një vend i sigurt ku ju që të dy të mund ta ndieni se ju duan dhe ju përkrahin, jo ku ju marrin në pyetje ose jua ulin vlerat.
- Praktikrat shpirtërore mund të ndihmojnë për të siguruar një mbrojtje kundër tundimit. Nxiteni njëri-tjetrin që të mbani e forconi zakone të rregullta shpirtërore – përfshirë studimin kuptimplotë të shkrimeve të shenjta dhe adhurimin në tempull (kur është e mundur), respektimin e ditës së Shabatit, shërbimin ndaj të tjerëve, agjërimin e qëndrueshëm dhe lutjen e singertë – me një dëshirë në rritje për ta forcuar marrëdhënien tuaj me Shpëtimtarin dhe Atin Qiellor. Ajo marrëdhënie mund të ndihmojë për ta pakësuar ndikimin e pornografisë

në jetën tuaj. Dishepullimi është një kërkim që zgjat gjithë jetën dhe forca që marrim si ndjekës të Krishtit do të na ndihmojë t'i kapërcejmë të gjitha sfidat tona në jetë, jo vetëm pornografinë.

- Nëse vetë përpjekjet tuaja nuk dalin me sukses, mos kini frikë apo turp të kërkonin ndihmën e një profesionisti të shëndetit mendor të trajnuar në fushën e varësisë seksuale. Ai mund të jetë në gjendje t'ju ndihmojë për të marrë më shumë këndvështrim për trajtimin e përdorimit të pornografisë dhe zgjidhjen e shkaqeve nga ka ardhur kjo.
- Kujtoni se jemi të rrethuar nga materiale të papërshtatshme argëtuese që na tundojnë të mëkatojmë. Nëse personi me të cilin/ën po dilni në takime, i rikthehet përdorimit, koha se sa shpejt kthehet në rrugën e drejtë është një tregues i mirë i zotimit të tij/saj për ta shpërrur pornografinë nga jeta e tij/saj. Por nëse filloni ta ndieni se keni më shumë shtysë për të parë ndryshim nga sa ka ai/ajo, ju duhet ta rishqyrtoni vazhdimin e marrëdhënies suaj që krijohet nga dalja në takime.
- Ndikimi juaj te personi me të cilin/ën po dilni në takime, mund të jetë shumë i fortë, por ai nuk duhet të jetë arsyeja kryesore për ndryshimin e sjelljes prej tij/saj. Dëshira e tij/saj për ndryshim duhet të vijë nga brenda, jo nga ju.

Mbi të gjitha, kërkonin udhërrëfim nga Ati Qiellor dhe kujtoni se ka gjithmonë shpresë nëpërmjet Shpëtimtarit. Hiri i Tij mjafton për të na shëruar e ndryshuar. Shlyerja e Tij është në dispozicion për të dy ju që t'ju japë forcë dhe t'ju ndihmojë të falni. Megjithatë, personi që po kalon probleme me pornografinë, ka nevojë ta kërkojë në mënyrë aktive ndihmën e Shpëtimtarit që ta kapërcejë atë. Askush tjetër nuk mund ta bëjë atë për të. Kini besim dhe mirëbesojini Atin Qiellor. Ai do t'ju udhërrëfejë në situatën tuaj të pashoqe. ■



Telefonat celularë janë të kushtueshëm në Kili

por në vitin 2016 vura një synim që të fitoja para të mjaftueshme për të blerë një të tillë. Për një vit të tërë bleva ëmbëlsira dhe *alfajores** me shumicë dhe ua shita shokëve dhe shoqeve të mia në shkollë. E kurseja çdo para që fitoja. Nuk dilja për drekë dhe nuk shkoja në kinema.

Nuk doja t'u kërkoja prindërve një telefon. Doja të isha në gjendje të thosha se e fitova vetë. Babi më dha zemër. "Karol, vazhdo kështu", do të thoshte ai.

Mësova shumë. Asgjë nuk është falas. Synimet kërkojnë përpjekje por ne kurrë nuk duhet të heqim dorë. Kur i fitojmë vetë gjërat dhe e kuptojmë se sa shumë punë duhet për t'i arritur ato, ne i vlerësojmë më shumë.

Mësova se duhet të vendosja se çfarë doja të arrija dhe ku doja të shkoja. Nëse dua të martohem në tempull, duhet të shkoj në kishë dhe seminar dhe më vonë në institut dhe veprimtaritë për të rinjtë në moshë madhore beqarë. Dhe duhet të dal në takime me të rinj të denjë. Arritja e synimeve kërkon sakrificë tani për diçka më të mirë më vonë.

Karol, 15 vjeçe, Kili

*Një biskotë tradicionale e Amerikës së Jugut.





RINIA

NË KËTË PJSË



52 **Nga Mujsharë tek të Pagëzuar**

Nga Plaku Hugo Montoia

54 **Fati Hyjnor**

Nga Ema C.

56 **Miq që më Dhanë nga Drita e Tyre**

Nga Mariana M. Lara

58 **Pa Drojë për ta Thënë të Vërtetën**

Nga Majkëll R. Morrisi

62 **Pyetje e Përgjigje**

64 **Përgjigje nga Udhëheqësit e Kishës: Guri Kryesor i Qoshes i Besimit Tonë**

Nga Presidenti Gordon B. Hinkli

Kur isha 17 vjeç, u përballa me trysni të lartë nga bashkëmoshatarët në shkollën e mesme. Shokët që kisha, nuk kishin të njëjta vlera si të miat. Unë dhe shokët e mi morëm pjesë në shumë veprimtari të përshtatshme së bashku si duke luajtur basketboll ose futboll. Por ata gjithashtu pinin alkool dhe duhan – dy gjëra që nuk i bëja me ta.

Një ditë, grupi ynë ishte jashtë [ndërtesës së] shkollës duke studiuar për një provim që do të bënim më vonë atë ditë. Me mua ishin dy prej shokëve të mi më të ngushtë, Huani dhe Françiskoja (emrat janë ndryshuar). Në një çast, dikush nxori çakmak dhe cigare. Mendova se shokët e mi ishin mërzitur me studimin dhe kishin harruar që isha edhe unë atje. Mësova se e kisha gabim kur u kthyen nga unë dhe thanë: “Tani është koha që Hugoja të mësojë se si të pijë duhan”.

Përpara se madje të kisha mundësinë të reagoja, Huani dhe Françiskoja kërcyen drejt meje dhe më kapën



NGA MUJSHARË TEK TË PAGËZUAR



Nga Plaku Hugo Montoia,
i Të Shtatëdhjetëve

krahët, secili nga njëra anë. M'i mbajtën krahët poshtë ndërsa njëri futi me forcë një cigare midis buzëve të mia. Trupi im menjëherë e refuzoi atë dhe e pështyva cigaren në tokë, larg nga vetja. Shpejt pas kësaj, ndjeva goditjen e një grushti drejt e në mollëz. Më kërcënuan, duke më thënë: "Do ta ndezim sërish cigaren dhe ti do të mësosh ta thithësh. Mos e flak në tokë.

Po e bëre, nuk do të shkojë mirë kjo punë."

Në atë çast, e dija që isha në telashe. Mbylla sytë dhe bëra një lutje të shpejtë duke kërkuar njëfarë ndihme. Sapo mbarova lutjen, makina e mësueses sonë frenoi dhe parkoi afër nesh. Mësuesja doli nga makina dhe na pyeti se çfarë po bënim. Shokët më lëshuan. "Po bëhemi gati për provimin", e siguruan ata mësuesen. Shkuam në shkollë dhe e bëmë provimin dhe situata mori fund me aq.

Pavarësisht se sa e vështirë ishte ajo përvojë, i fala shokët e mi për atë që bënë. E dija se ata nuk i kuptonin standardet e mia dhe vendimin tim për ta jetuar Fjalën e Urtësisë, ndaj i fala dhe zgjedha që të mos kisha asnjë ndjenjë të keqe ndaj tyre. Kur mbaruam shkollën, u largova për në misionin tim por vazhdova të komunikoj me Huanin dhe Françiskon. U shkrova atyre letra të shpeshta duke iu treguar për ungjillin dhe dëshminë time për Jezu Krishtin. I ftova të pendohen dhe të marrin pjesë në Kishë. Për habinë time të madhe, njëri prej tyre faktikisht shkoi.

Shpesh i kisha ftuar shokët e mi në mbledhjet e së dielës më parë, por

asnjëri nuk kishte pranuar deri atëherë. Ndonëse nuk mund të merrja pjesë me Huanin, vëllezërit e mi dhe babai im ishin atje për ta ndihmuar dhe për t'i bërë shoqëri. Familja ime e pranoi atë dhe Huani u ndje shumë rehat në kishë. Ai filloi të ndryshonte pak e nga pak derisa

të kësaj, unë kam dy shokët më të mirë që kam njohur ndonjëherë dhe tani po punojmë së bashku për të përkrahur mbretërinë e Perëndisë si anëtarë të Kishës.

Gjithnjë mbajini standardet e Kishës edhe nëse jeni në një situatë shumë të

Miqësia dhe shembulli juaj i drejtë do t'i bekojë shokët dhe shoqet tuaja dhe brezat që do të vijnë.

mori vendimin për t'u pagëzuar. Isha i ngazëlyer për të dhe madje edhe më i ngazëlyer kur më tha se kishte mësuar ta donte Jezu Krishtin për shkak të letrave të mia. Kur u ktheva në shtëpi nga misi- oni, i qëndrova pranë edhe Françiskos dhe pas njëfarë kohe, ai dhe gruaja e tij u pagëzuan gjithashtu. Sot, Huani dhe Françiskoja janë ende dy nga shokët e mi më të ngushtë.

Këto ngjarje ndikuan në jetën time. Mësova se mënyra më e mirë për të ndikuar në jetën [e të tjerëve] është të jetosh me drejtësi, t'i duash të tjerët dhe të ndihmosh. Broshura "*Për Forcën e Rinisë*" thotë: "Që të keni miq të mirë, jini një mik i mirë. Tregoni interesim të sinqertë për të tjerët; buzëqeshni dhe bëjuani të ditur se interesoheni për ta."¹ Kjo është ajo që më ndihmoi Zoti të bëja me Huanin dhe Françiskon. Për shkak

vështirë sikurse isha unë. Broshura "*Për Forcën e Rinisë*" udhëzon: "Ndërsa kërkoni që të jeni mik me të tjerët, mos bëni kompromis me standardet tuaja. Nëse miqtë tuaj ju nxisin të bëni gjëra që janë të gabuara, jini ai që me besim bën atë që është e drejtë."² Edhe nëse duket se çdo njeri tjetër po bën atë që është në kundërshtim me urdhërimet, qëndroni të fortë sepse shembulli juaj është i fuqishëm. Jini ai lloj shembulli për të cilin shokët dhe shoqet tuaja mund të menjoheshin gjatë kohëve të tyre të nevojës. Në disa raste si rasti im, miqësia juaj mund të jetë pikërisht ajo që i ndihmon ata të mësojnë, të pendohen dhe të kthehen në besim. ■

SHËNIME

1. *Për Forcën e Rinisë* (2011), f. 16.
2. *Për Forcën e Rinisë*, f. 16.

Fati Hyjnor

*Shoqja ime zakonisht ishte e lumtur gjatë gjithë kohës.
Vallë çfarë mund ta shqetësojë atë?*

Nga Ema C.

Unë jam nga Franca, por unë dhe motra ime kaluam një vit në pjesën lindore të Shteteve të Bashkuara si studente në programe shkëmbimesh. Gjatë asaj kohe, takuam shumë njerëz, por personi që më la më shumë përshtypje, ishte një vajzë që quhej Destini [nga anglishtja përkthehet Fati]. Ajo u bë një nga shoqet e mia më të ngushta. Ne bëmë gjithfarë gjërash së bashku, gjatë shkollës dhe pas shkolle dhe me motrën time. Destinia ishte përherë e lumtur. Kjo ishte gjëja që më pëlqente më shumë tek ajo.

Pastaj një ditë e pashë atë në një gjendje të shqetësuar që nuk e kisha parë kurrë më parë. E pyeta se çfarë nuk shkonte. Ajo tha se nuk donte të fliste për këtë. Pastaj vura re një letër në dorën e saj. E mora dhe e lexova.

Dikush i kishte shkruar gjëra të këqija sa nuk besohet. Shënimi anonim thoshte se ajo ishte e shëmtuar, se askush nuk e pëlqente atë, se nuk kishte arsye pse të jetonte dhe se duhej me doemos ta vriste veten. Kurrë nuk do ta kisha besuar se dikë si atë do ta sulmonin në atë mënyrë. U preka thellë kur mora vesh dhembjen që po kalonte ajo.

Nga ajo kohë e tutje, bëra një përpjekje edhe më të madhe për të qenë shoqja e Destinisë – jo

thjesht që të kaloja kohë me të, por që përherë të isha atje për të dhe veçanërisht të isha e sinqertë. I shpjegova asaj se është një bijë e Perëndisë, e bekuar me natyrë hyjnore, e denjë për t'u admiruar dhe e aftë për gjëra të mëdha.

Është e vështirë ta duash veten kur të tjerët të trajtojnë keq dhe të kritikojnë. Kur shoqërohesha me Destininë, mësova se ndonjëherë mënyra më e mirë për t'i ndihmuar të tjerët është thjesht t'i duam ata dhe t'i ndihmojmë ta dinë se kush janë me të vërtetë.

Në fund të vitit, kur duhej të kthehesha në Francë, Destini më tha diçka që do e ruaj përherë si thesar. "Ema", tha ajo, "ti më shpëtove. Përpara se të vije ti, doja të vrisja veten. Por pastaj ti dhe motra jote më ndihmuat shumë, thjesht duke u kujdesur. Sot e dua veten dhe të kam për zemër."

Ka shumë fëmijë në shkollë të cilët durojnë mujsime, të cilët i keqtrajtojnë ose i veçojnë. Gjeni një mënyrë për t'i ndihmuar ata. Flisni me ta, mendoni për ta, jini të sjellshëm me ta. Kjo është ajo që Shpëtimtari do të bënte dhe ndonjëherë thjesht një përsëritje e thjeshtë ose një buzëqeshje mund të ndryshojë gjithçka. ■

Autorja jeton në Francë.



Nga Mariana M. Lara

Po jetoja me mamin në një qytet të vogël në Meksikë ku të gjithë e njihnin njëri-tjetrin. Dija ta dalloja të drejtën nga e gabuara, por isha e pështjelluar dhe e vetmja e re aktive në të gjithë qytetin.

Doja që të përshtatesha, ndaj bëra një gjë që atëherë kishte kuptim: të kisha një të dashur. Ky ishte vetëm njëri nga gabimet e para që fillova të bëja. Fillova t'i nënshtrohesha trysnisë së bashkë-moshatarëve dhe të besoja se isha aq e rritur sa të mendoja vetë, gjë që do të thoshte të bëheshe një e re joaktive, që jetonte në errësi.

Jetova në errësi për një vit, çdo ditë që kalonte bëhej më e zymtë. Vendi-
met e mia të këqija çuan në grindje me

familjen dhe e kuptova se nuk mund të vazhdoja të jetoja më me ta. Por vetëm në kohën kur më vdiq një shok i ngushtë, shenjtor i ditëve të mëvonshme, e kuptova se po më mungonte diçka. Fatkeqësisht, fajësova Perëndinë dhe ungjillin. Ndalova së besuari se bekimet vijnë nga të qenit të bindur. E dija se po të mos vendosja që të filloja ta jetoja ungjillin, do të vazhdoja ta shpërfillja lidhjen time me Kishën dhe të vazhdoja të jetoja sipas mënyrës së botës.

Isha ulur në shtratin tim në një dhomë të errët, duke qarë dhe duke ndier keqardhje për veten kur e kuptova se kisha

frikë – frikë ngaqë isha atje vetëm pa dikë me të cilin të flisja, frikë se nuk do të isha në gjendje t'i rregulloja të gjitha gabimet që kisha bërë, frikë se askush nuk do të më falte, veçanërisht Perëndia.

Përfundimisht, u shpërngula në Mine-sota, SHBA, te gjyshërit e mi, të cilët nuk janë anëtarë të Kishës. Njerku im udhëtoi me mua dhe të dielën e parë atje shkuam në kishë, por vetëm për mbledhjen e sakramentit. Nga fundi i mbledhjes e kisha



MIQ që
më **DHANË**
nga **DRITA** e Tyre

vendosur tashmë që të mos shkoja më në Kishë, por për habinë time, pikërisht kur po shkonim te makina, pamë peshkopin të vraponte për të na arritur. Na bëri disa pyetje dhe na ftoi të vinim sërish të dielën e ardhshme – dhe ne shkuam.

Të dielën tjetër, sapo mbledhja e sakramentit po përfundonte, para se të çohesha, u rrethova nga të rejat e lagjes – të reja që do të më ndihmonin ta ndryshoja jetën.

Papritur hyra në një botë krejtësisht ndryshe: një botë me një peshkop dhe


një presidente të Të Rejave që u kujdesën për mua dhe, mbi të gjitha, të reja që u përpoqën ta jetonin ungjillin çdo ditë, që u përpoqën fort të jetonin standarde të larta dhe të qëndronin për të drejtën. Ata shkëlqyen aq shumë sa mund ta ndriçonin shtegun përpara meje.

Pikërisht në atë kohë e kuptova se çfarë duhej të bëja: “[Të lija] të shndri[ste] drita [ime] para njerëzve, që të shohin veprat [e mia] të mira dhe ta lëvdojnë Atin [tim] që është në qiej” (shih Mateu 5:16). Dhe kështu që fillova të shkoja në kishë dhe Aktivitetet e Përbashkëta çdo javë, ta lexoja Librin e Mormonit dhe të

lutesha çdo ditë, të vishesha me thjeshtësi, të përdorja një fialor më të mirë, të shkoja në tempull dhe të përgatitesha për të marrë bekimin tim patriarkal.

Kisha ndryshuar plotësisht, por nuk e kuptova këtë deri në kohën e kampit të Të Rejave kur e ndjeva Frymën e Shenjtë dhe zbulova se kisha një dëshmi – një dëshmi që do të më kujtonte se Perëndia më do, se Ai ka një plan për mua dhe se Ai nuk do që të jem vetëm. Një dëshmi aq e shndritshme dhe e fortë sa më ndryshoi. Një dëshmi për t’u treguar dhe që ndriçon jo vetëm shtegun tim por edhe atë të të tjerëve. Një dëshmi që nuk druhet të shkëlqejë në errësirë. ■

Autorja jeton në Baha Kalifornia, Meksikë.



Po ndihesha e frikësuar dhe vetmuar. Pastaj u shpërngula në një vend tjetër dhe shkova në Kishë për herë të parë pas një kohe të gjatë.

PADRO



JË

PËR TA THËNË TË VËRTETËN

I armatosur me një dëshmi për ungjillin dhe bekimet e tij, Fabiani nuk ka lejuar që mosha e tij e re ta pengojë që të bëhet një anëtar misionar i fuqishëm dhe i patrembur.

Nga Majkëll R. Morrisi
Revistat e Kishës



Dielli po perëndon në Las Tomas, një lagje e ndërtuar mbi shpate ranore që ngrihen mbi Antofagastën. Poshtë dritat po fillojnë të shkëlqejnë ndërsa dita mbyllet në këtë qytet-port detar në Kilin verior.

Është mbrëmje, ditë e shtunë dhe Fabian H.-ja, 13-vjeçar, mund të ishte duke dalë me shokët e tij. Por Fabiani, një anëtar i ri i Kishës, përkundrazi zgjedh që ta kalojë mbrëmjen me misionarët kohëplotë. Është koha që “të ndihmo[jmë] që Izraeli të mblidhet”¹.

Nga të gjithë anëtarët misionarë të përkushtuar me të cilët Kellen VanNateri dhe Xhordan Sheltoni kanë punuar gjatë misioneve të tyre kohëplota në Kili, Fabiani qëndron mbi të tjerët.

“Nëse kishte kohë të lirë, ai ishte jashtë me ne duke bërë punë misionare”, thotë Kelleni. “Kur mbaruan pushimet e verës, ai ishte i trishtuar jo vetëm se do të kthehej në shkollë, por edhe se nuk kishte aq shumë kohë për të dalë me ne.”

Xhordani, i cili kaloi disa muaj si shoku misionar i Kellenit, shton: “Fabiani ndoshta doli me ne katër ose pesë herë në javë – çdo javë – ndërsa

shërbyem së bashku në Antofagasta. Ai ishte anëtar i misionar më i mirë me të cilin kemi punuar ndonjëherë.”

Çfarë e bën një të ri kaq të gatshëm për të bërë punë misionare pavarësisht nga përbuzja nga shokët e klasës dhe shpërfillja nga të huajt? Për Fabianin, përgjigjja gjendet te bekimet që ai dhe familja e tij kanë marrë që nga koha kur e pranuan ungjillin – bekime që ai dëshiron t’ua tregojë të tjerëve.

“Gëzim i Pashpjegueshëm”

Fabiani filloi t’i merrte mësimet me misionarët pak kohë pasi misionarët kohëplotë erdhën e trokitën. Ai ende e kujton mbledhjen e tij të parë të sakramentit.

“Nuk njihja asnjë njeri kur hyra në godinën kishtarë, kështu që isha pak në siklet”, thotë ai. “Por ndjeva diçka të mrekullueshme. Ndjeva se kisha qenë në Kishë për muaj ose vite.”

Gjatë pagëzimit të tij disa javë më vonë, [ai thotë]: “Unë ndjeva një gëzim të pashpjegueshëm kur u zhyta në ujë dhe dola sërish nga uji. U ndjeva si



“Ai është përherë duke treguar *vetë* përvojat e tij vetjake - si [për shembull] mënyrën se si u ndje kur

një njeri tjetër, duke e ditur se do të ndiqja Jezu Krishtin dhe do të bëja më të mirën time për t'i zbatuar urdhërimet e Tij.”

Kur prindërit e pamartuar të Fabianit, Leonardoja dhe Anxhela, u bashkuan me djalin e tyre gjatë mësimeve me misionarët, ata mësuan për martesën në tempull dhe familjet e përjetshme. “Një javë më vonë, babai im caktoi ditën e martesës”, thotë Fabiani. “Mami ishte shumë e lumtur.”

Katër muaj pasi Fabiani u bashkua me Kishën, Anxhela vijoi pas tij në ujërat e pagëzimit. “Ky ishte një bekim i mrekullueshëm”, thotë ai.

Bekime të tjera pasuan menjëherë. Leonardoja, i cili ishte pagëzuar kur ishte i ri, u kthye në aktivitet në Kishë. Studimi i ungjillit u bë një element kryesor në shtëpinë e tyre. Pjesëtarët e familjes u afruan më shumë. Leonardoja gjeti punë të qëndrueshme. Dhe Fabiani mori Priftërinë Aarone.

“Më pëlqen shumë të mbaj priftërinë në mënyrë që të mund t’ua shpërndaj sakramentin anëtarëve të lagjes dhe t’i ndihmoj ata t’i përtërijnë besëlidhjet e tyre”, thotë Fabiani. “Jam sidomos i

lumtur kur duhet t’ia shpërndaj familjes sime dhe pleqve që më dhanë mësimet. Shikimi krenar që më hedh babai ndërsa më sheh të shpërndaj sakramentin, më bën shumë të lumtur.”

“Kjo do të ishte e Mrekullueshme”

Fabiani filloi të bënte punë misionare si anëtar madje përpara se të pagëzohej.

“U thashë tre prej shokëve të mi se do të pagëzohesha. Dy prej tyre erdhën”, thotë ai. “Më pëlqen ta shpërndaj ungjillin në mënyrë që shokët e mi të kuptojnë se çfarë besojmë ne dhe çfarë bëjmë në Kishë kështu që ata të mund të mësojnë për ungjillin, të pagëzohen dhe të kenë jetë të lumtur. Do të isha shumë i lumtur nëse ndonjëri prej tyre pagëzohet dhe bëhet një nga anëtarët e kuorumit tim. Kjo do të ishte e mrekullueshme.”

Fabiani mban një Libër Mormoni me vete në shkollë dhe ai mban broshura të misionarëve për t’ua dhënë shokëve dhe shoqeve. Ai është i lumtur t’u përgjigjet pyetjeve rreth Kishës dhe i fton shokët dhe shoqet në mbledhjet e së dielës dhe në mbrëmjet me aktivitete për të rinjtë

dhe të rejtat. Dhe nuk druhet që t’u qaset njerëzve në rrugë dhe, siç e kanë mësuar misionarët, i fton ata të mësojnë për Kishën dhe të përgatiten për pagëzimin.

“Fabianit nuk i intereson nëse dikush mendon se ai është i çuditshëm që e shpreh dëshminë e tij”, thotë Kelleni. “Ai e di se po bën gjënë e duhur. Ai e di se gjërat shpirtërore janë më të rëndësishme se çdo gjë tjetër.”

Kur Fabiani e shpreh dëshminë e vet, Xhordani thotë se ai merr fuqi nga kthimi i tij në besim, dashuria e tij për ungjillin dhe bekimet e tij.

“Ai i pa bekimet që i erdhën familjes së tij, dhe kjo është ajo që e frymëzon atë që të jetë kaq i guximshëm dhe i hapur për ta shpërndarë ungjillin te shokët e tij”, thotë Xhordani. “Një herë ai po i dëshmonte një kërkuesi rreth asaj se çfarë bekimi i madh ishte për prindërit e tij që të martoheshin, por sa e vështirë ishte për të që të priste katër muaj pas pagëzimit të tij që mamaja të pagëzohej. Emocionet e tij e mposhtën dhe ai shpërtheu në lot. Ai më pas dëshmoi se, nëse i zbatojmë urdhërimet, Perëndia do të kujdeset për ne.”



Nuk është çudi që njëri nga synimet më të mëdha të Fabianit është të bëhet vetë një misionar kohëplotë pasi të diplomohet nga shkolla e mesme.

“Dua t’ua tregoj të vërtetën atyre që nuk e dinë atë”, thotë ai. “Dua t’i ftoj ata të pastrohen nga mëkatet e tyre. Dua t’u mësoj atyre se si të mund të jenë një familje e përgjeshme. Dua t’i ftoj ata të jenë

të lumtur tani dhe të jetojnë në një gjendje lumturie të pafundme pas kësaj jete.” ■

SHËNIM

1. Shih Rasëll M. Nelson, “Shpresa e Izraelit” (takim shpirtëror mbarëbotëror për rininë, 3 qershor 2018), HopeofIsrael.ChurchofJesusChrist.org.

shkoi në kishë për herë të parë dhe se si ndihet kur lexon Librin e Mormonit.”

“Dëshmia e Fabianit e bën atë një anëtar misionar të fuqishëm”, shton Kelleni.

“Ai nuk thotë gjëra të tilla si: ‘O, dëgjo-va dikë në kishë të thotë këtë’. Përkundrazi, ai është përherë duke treguar vetë përvojat e tij vetjake – si [për shembull] mënyrën se si u ndje kur shkoi në kishë për herë të parë dhe se si ndihet kur lexon Librin e Mormonit. E gjitha është shumë e vërtetë dhe reale.”

“Përherë Ndhem më Mirë”

Për Fabianin, shpërndarja e ungjillit sjell një tjetër bekim.

“Ndonjëherë më ndodhin gjëra të këqija në shkollë, por pastaj misionarët vijnë e trokasin në derën time dhe më pyetin a do të isha i gatshëm t’i ndihmoja për të dhënë mësim”, thotë ai. “Pasi dal me ta, ndihem sikur nuk kam asnjë problem. Përherë ndihem më mirë kur dal me ta, kur i lexoj shkrimet e shenjta me ta dhe i ndihmoj ta shpërndajnë ungjillin. Shpërndarja e ungjillit dhe historia e kthimit tim në besim e forcojnë dëshminë time. Dhe dhënia mësim e ungjillit më jep mundësinë të jem një shembull për të tjerët, përfshirë motrën time të vogël.”



Fabiani përgatitet për një mbrëmje predikimi me Pleqtë Kellen VanNatter (sipër, në qendër) dhe Xhordan Shelton (sipër, në të djathtë).



ASNJË MË E RËNDËSISHME

“Rinia ime e dashur dhe e jashtëzakonshme, ju u dërguat në tokë pikërisht në këtë kohë, në kohën më vendimtare në historinë e botës, që të ndihmoni që Izraeli të mblihdet. Nuk ka *asgjë* tjetër që po ndodh në tokë tani që është më e rëndësishme se ajo. Nuk ka *asgjë* me pasoja më të mëdha se ajo. Absolutisht *asgjë*.”

Kjo mbledhje duhet të jetë *gjithçka* për ju. Ky është misioni për të cilin u dërguat në tokë.”

Presidenti Rasëll M. Nelson, “Shpresa e Izraelit” (takimi shpirtëror mbarëbotëror për rininë), 3 qershor 2018, HopeofIsrael.ChurchofJesusChrist.org.

“Si të gjej miq me standarde të mira?”



“Dhembshuria e miqve si Krishti e prek thellë dhe e ndryshon jetën tonë. Ne duhet ta mbajmë mend mirë se Zoti shpesh dërgon ‘nga lart . . . bekime prej fjalëve, veprave t’njër’zve.’”

Plaku Jozef B. Uirthlin (1917–2008), i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, konferenca e përgjithshme e tetorit 1997.



Mirësia është Çelësi

Tregojuni atyre dashuri dhe jini të sjellshëm.

Tregojuni atyre që kujdeseni për ta dhe ju inte-

reson lumturia e tyre. Nëse ata nuk ju tregojnë se duan t’ia dinë për ju dhe nuk janë të sjellshëm, me gjasë nuk dëshironi që ta vazhdoni atë shoqëri.

Madi B., 15 vjeçe, Arizonë, SHBA



Shpërndajeni Ungjillin

Ju mund të gjeni shok ose shoqe të reja me standarde të mira duke shkuar

me misionarët për të dhënë mësim. Ata njohin mjaft njerëz të rinj në moshë që kanë nevojë për një shok në Kishë.

Plaku Kuintanila, 20 vjeç, Misioni i Barbados, Brixhtau

Lutuni për Miqtë Tuaj

Lutem shumë për të kuptuar a janë shokët e mi shokët e duhur që mund të më ndihmojnë t’i ngre standartet e mia dhe dëshminë time për Jezun Krishtin.

Imanol M., 18 vjeç, Çiuaua, Meksikë



Perëndia do t'ju Ndhimojë

Kam zbuluar se nëse bëj një përpjekje të veçantë për të kërkuar njerëz që e tregojnë dritën e Krishtit, kjo e sjell gjithë ndryshimin. Ati Qiellor i di dëshirat tuaja dhe, nëse ju bëni pjesën tuaj, atëherë Ai do t'u përgjigjet atyre lutjeve.

Olivia T., 18 vjeçe, Jutë, SHBA

Jetojini Standardet Tuaja

Jini një shembull që i jetoni standardet tuaja. Dhe nëse keni shokë dhe shoqe që nuk kanë të njëjtat standarde, tregojuni atyre se janë të veçantë në sytë e Perëndisë. Jezusi e donte këdo dhe u mësoi atyre t'i ndjekin udhët e Tij.

Bernard B., 19 vjeçe, Palauan, Filipine

Përgjigjet synojnë të japin ndihmë dhe këndvështrim, nuk jepen si deklarime zyrtare të doktrinës së Kishës.

Çfarë Mendon Ti?

"Si t'i mposht ndjenjat e vetmisë?"

Dërgojeni përgjigjen tuaj dhe, nëse dëshironi, një fotografi me rezolucion të lartë deri më 15 nëntor 2019 te liahona.ChurchofJesusChrist.org (klikoni te "Submit an Article or Feedback" ["Dërgoni një Artikull ose Lini një Përshtypje"]).

Përgjigjet mund të redaktohen lidhur me gjatësinë apo qartësinë.



Cila është pikëpamja e Kishës për mjedisin?

Një fialë kyç për ta kuptuar pikëpamjen tonë për mjedisin është fiala *kujdestari*. Ajo nuk do të thotë që njerëzit janë zotër të tokës dhe mund ta përdorin ata si të duan por përkundrazi që ne jemi përgjegjës për mënyrën se si i përdorim burimet e saj (shih Doktrina e Besëlidhje 104:13–15). Ndonëse "ka mjaft edhe për të kursyer" (Doktrina e Besëlidhje 104:17), Perëndia dëshiron që ne t'i përdorim burimet e tokës me urtësi (shih Doktrina e Besëlidhje 59:20).

Perëndia krijoi tokën dhe shpalli se krijimet e Tij janë "shumë [të] mir[a]" (shih Zanafilla 1:1, 31). Kjo tokë u krijua që të banojnë fëmijët e Perëndisë si pjesë e planit të Tij të shpëtimit. Vetë toka do të shenjtërohet dhe do të marrë një lavdi çelësiale (shih Doktrina e Besëlidhje 88:18–19).

Perëndia e bëri tokën jo vetëm të dobishme por edhe të bukur. Gjërat e tokës "bëhen për të mirën dhe për përdorimin e njeriut, si për të kënaqur syrin, edhe për të gëzuar zemrën" si dhe "për të gjallëruar shpirtin" (Doktrina e Besëlidhje 59:18–19).

Ne duhet ta nderojmë Perëndinë duke i vlerësuar krijimet e Tij, duke shprehur mirënjohje për to dhe duke u përpjekur fort që t'i mbajmë të bukura. Ne duhet t'i ruajmë burimet, ta mbrojmë natyrën dhe ta shmangim ndotjen dhe dëmtimin.

Guri Kryesor i Qoshes i Besimit Tonë

Nga Presidenti Gordon B. Hinkli (1910–2008)

Presidenti i 15-të i Kishës

Në çdo tempull të ri kemi një ceremoni për vendosjen e gurit të qoshes në harmoni me një traditë që daton në kohët e lashta. Para përdorimit të betonit në përgjithësi, muret e themelit të ndërtesës ndërtoheshin me gurë të mëdhenj. Hapej një hendek dhe gurët vendoseheshin si themele. Duke u nisur nga një pikë e fillimit, muri i themelit ndërtohej duke mbajtur të njëjtin drejtim deri te një gur i qoshes; më pas formohej një qoshe prej nga ndërtohej muri deri në drejtim të qoshes tjetër, ku vendosej një tjetër gur, nga i cili, muri do të ndërtohej në drejtim të një qosheje tjetër dhe prej andej në pikën e fillimit. . . . Guri i fundit quhej guri kryesor i qoshes dhe vendosja e tij bëhej shkas për festime të mëdha. Pas vendosjes së këtij guri qosheje, themelet ishin gati për ndërtimin e pjesës së sipërme. Prej këtej vjen edhe analogjia që përdori Pali për të përshkruar Kishën e vërtetë:

“Ju, pra, nuk jeni më të huaj, as bujtës, por bashkëqytetarë të shenjtorëve dhe pjes[ë]tarë të familjes së Perëndisë,

të ndërtuar mbi themelin e apostujve dhe të profetëve, duke qenë Jezu Krishti vetë guri i qoshes,

mbi të cilin gjithë ndërtesa, e lidhur mirë, rritet për të qenë një tempull i shenjtë në Zotin” (Efesianëve 2:19–21).

Ne kemi gurë bazë të qoshes mbi të cilat kjo Kishë e madhe e ditëve të mëvonshme është vendosur nga Zoti dhe është ndërtuar duke qenë “e lidhur mirë”. Ata kanë një rëndësi themelore në këtë punë, [janë] vetë themeli, spirancat mbi të cilat ajo qëndron. . . . [Por] unë po flas për gurin kryesor të qoshes, të cilin ne e njohim dhe e nderojmë si Zotin Jezu Krisht. . . .

Ai është guri kryesor i qoshes i Kishës që mban emrin e Tij, Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Nuk ka asnjë emër tjetër që u është dhënë njerëzve dhe me anë të të cilit mund të shpëtohem (shih Veprat e Apostujve 4:12). Ai është vepronjësi i shpëtimit tonë, Ai që jep jetë të përjetshme (shih Hebrenjve 5:9). Nuk ka asnjë të barabartë me Të. Kurrë nuk ka ekzistuar. Kurrë nuk do të ekzistojë. Falë i qofshim Perëndisë për dhuratën e Birit të Tij të Dashur, që dha jetën e Tij që ne të mund të jetojmë dhe që është guri kryesor e i palëvizshëm i qoshes i besimit tonë dhe i Kishës së Tij! ■

Nga një fjalim në konferencën e përgjithshme të tetorit 1984.

Katër Gurët e Qoshes të Kishës

Presidenti Gordon B. Hinkli dëshmoi se Jezu Krishti është guri kryesor i qoshes i besimit tonë. Ai gjithashtu na mësoi

se ka gurë të tjerë bazë të qoshes mbi të cilën është ndërtuar Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme.



Zoti Jezu Krisht

Zoti dhe Shpëtimtari ynë. Guri kryesor i qoshes mbi të cilin ndërtohet besimi ynë dhe Kisha.



Vegimi i Parë

Hapi punën e mrekullueshme të rivendosjes.




Libri i Mormonit

Flet si një zë nga pluhuri me fjalët e profetëve që dëshmojnë për Shpëtimtarin e njerëzimit.



Priftëria

Nëpërmjet fuqisë dhe autoritetit të saj, burrat veprojnë në emrin e Perëndisë për administrimin e punëve të mbretërisë së Tij.



TË RINJTË NË MOSHË MADHORE

**A KA BASHKËSHORTI/JA
JUAJ I/E MUNDSHËM/ME
NJË PROBLEM ME
PORNOGRAFINË?**

*Ka shpresë dhe ndihmë.
Këtu është mënyra se si të ecni
përpara me besim.*

42



RINIA

**NDIKIMI I
MIQVE TË MIRË**

52-57,
62

EJA, MË NDIQ

**EFESIANËVE 2:
CILËT JANË GURËT E
QOSHEVE TË KISHËS?**

64

KISHA E
JEZU KRISHTIT
E SHENJTORËVE TË
DITËVE TË MËVONSHME



Miku



Përshëndetje nga
**R. D. e
Kongos!**

Shih faqet M4–M7



**Nga Presidenti
Dallin H. Oaks,**
Këshilltar i Parë në
Presidencën e Parë

T'i Duash të Tjerët Sikurse i Do Jezusi



Jezusi u dha dishepujve të Tij një urdhërim të rëndësishëm: “Doni njëri-tjetrin, ashtu si unë ju kam dashur juve” (Gjoni 15:12). Si pasues të Krishtit, ne duhet të jetojmë në paqe me të tjerët. Kjo përfshin njerëz që nuk besojnë të njëjtat gjëra që besojmë ne.

Ja tek janë disa mënyra se si ne mund t'i duam të tjerët siç na do Shpëtimtari:

- Ji i mirë me njerëzit që janë ndryshe.
- Trego respekt për bindjet e tyre.
- Kurrë mos keqtrajto ose fyej ndokënd.
- Ji një dëgjues i mirë.

- Ji i sjellshëm. Mos debato me zemërim.
- Mbroje atë që është e vërtetë.
- Tregoju të tjerëve për ungjillin në një mënyrë të përlulur. “Th[uaje] të vërtetën me dashuri” (Efesianëve 4:15).


Urdhërimi i Shpëtimtarit tonë për ta dashur njëri-tjetrin ashtu si Ai na do ne, është ndoshta sfida jonë më e madhe. Unë lutem që ne të mund të përpiqemi të tregojmë dashuri në gjithçka që bëjmë. ●

*Përshtatur nga “Dashuria për të Tjerët dhe të Jetuarit me Ndryshimet”,
Liahona, nëntor 2014, f. 25–28.*

Profetët dhe Apostujt

Shkrimet e shenjta thonë se Kisha është “ndërtuar mbi themelin e apostujve dhe të profetëve, duke q[ë]në Jezu Krishti vetë guri i qoshes” (Efesianëve 2:20). Kjo do të thotë se Jezu Krishti e udhëheq Kishën nëpërmjet profetëve dhe apostujve sot.

Ngjyrosi figurat e njerëzve që flasin në konferencën e përgjithshme. Ose ngjyrosi ato pas konferencës ndërsa flet me familjen tënde për bisedat e tua të parapëlqyera. Ngjyros një zemër sa herë që dëgjon dikë ta përmendë Jezusin. Ai të do!



Kjo faqe lidhet me faqen 155 të materialit “Eja, Më Ndiq – Për Individët dhe Familjet”.

Thjesht një Lutje Larg

*Prodi kishte
frikë të binte sërish
në gjumë. Po sikur
të kishte një makth
tjetër?*



Nga Lusi Stivensoni

Revistat e Kishës

“Pray, He is there” [“Lutu, Ai Është këtu”] (Children’s Songbook, f. 12).

Prodi u ngrit ndenjtur në shtrat me shpejtësi. Zemra po i rrihte fort.

Shiu trokiste në çati ndërsa ai qëndronte në errësirë. Ai mund ta dëgjonte ujin të binte pikë–pikë nga pema afrikane e fikut jashtë dritares së vet dhe ajrin që ndihej i lagësht dhe i ngrohtë. Prodi mori frymë thellë dhe u përpoq të qetësohej. Ishte thjesht një ëndërr.

Doli ngadalë nga shtrati dhe pa vjedhurazi nga dhoma e prindërve. Mami dhe babi po flinin të qetë. Motra e tij e vogël, Selia, ishte rehatuar gjithashtu në shtratin e saj. Çdo gjë ishte në rregull. Familja e tij ishte e sigurt.

Prodi u ngjiti përsëri në shtrat dhe u përpoq të binte në gjumë. Ai përpëlitej dhe ndërronte krahun, pastaj përpëlitej dhe ndërronte krahun përsëri. Ai e dinte se ëndrra e tij nuk ishte e vërtetë, por kishte qenë shumë e frikshme! Edhe pse ishte i lodhur, kishte frikë të binte sërish në gjumë. Po sikur të kishte një makth tjetër?

Prodi u shtri në shpinë dhe pa tavanin. U përpoq të kishte mendime të lumtura. “O Atë Qiellor, a je Ti atje? A i përgjigjesh lutjes së çdo fëmije?” Një valë ngrohtësie erdhi mbi Prodin ndërsa mendoi për fjalët e këngës së tij të parapëlqyer të Fillores. Motra Kioska u kishte mësuar atyre se Ati Qiellor përherë kujdesej për ta. Ata mund t’i luteshin Atij çdo herë, kudo.

Prodi e dinte se çfarë duhej të bënte. U ngrit nga



shtrati dhe u gjuhëzua për t’u lutur.

“I dashur Atë Qiellor”, u lut ai, “jam vërtet i frikësuar. Të lutem, mbroje familjen time. Dhe, të lutem, më ndihmo të bie në gjumë dhe të mos shoh më ëndrra të këqija.”

Prodi e përfundoi lutjen dhe u ngjiti sërish në shtrat. Trupi iu qetësua dhe mendja i ra në qetësi. Shpejt e zuri gjumi.

Kur erdhi mëngjesi, Prodi u zgjua nga dielli i ngrohtë që shkëlqente përmes dritares. Ai mund t’i dëgjonte enët që kërcisnin në kuzhinë, dhe u ngrit për të gjetur mamin. Selia ishte në tavolinë duke ngrënë cassava-në e mbetur. Mamaja po ngrohte pak për të që edhe ai të hante.

“*Bonzhur*”, tha mami. “Si fjete?”


“Pata një makth vërtet të frikshëm”, tha Prodi. “Por pastaj bëra një lutje. Ati Qiellor më ndihmoi të ndihem i sigurt.”

“Më vjen keq që pe një ëndërr të keqe”, tha mami. Ajo e përqafoi Prodin fort dhe nuk e lëshoi për një kohë të gjatë. “Por jam shumë e lumtur që bëre një lutje. Duket sikur Ati Qiellor me të vërtetë të ndihmoi.”

“Po, më ndihmoi”, tha Prodi. “Munda të flija përsëri dhe nuk pata më ëndrra të këqija.” Prodi e përqafoi mamin fort. Ai ishte i lumtur që e dinte se pavarësisht se sa i frikësuar ndihej, Ati Qiellor ishte thjesht një lutje larg. ●

Ktheje faqen për ta njohur djalin nga kjo histori!

Përshëndetje nga Republika Demokratike e Kongos!



R. D. e Kongos
ndodhet në Afrikën
qendrore. Rreth
80 milionë njerëz
jetojnë atje.



Një pjesë e madhe e R. D. të Kongos mbulohet nga pyje ku bie shumë shi. Në të strehohen gjithë ato lloj kafshësh interesante, si elefantët, gorillat dhe rinoqerontët. Kjo kafshë quhet okapi [lloj girafe].

**Ç'kemi, ne
jemi Margo
dhe Paolo!**



**Ne po vizitojmë
Republikën Demokratike
të Kongos ose R. D. e
Kongos.**

R. D. e Kongos njihet për artin e saj të bukur tradicional, përfshirë statujat prej druri, shportat me endje dhe maskat.





Misionarët nga Kisha jonë filluan t'u jepnin mësim njerëzve në R. D. e Kongos në vitin 1986. Tani thuhet se 60 000 njerëz atje i përkasin Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme.

Në R. D. të Kongos pjesa më e madhe e njerëzve në Kishë flasin frëngjisht. Ajo është gjuha zyrtare e vendit. Por ka thuhet se 250 gjuhë të tjera që fliten në R. D. të Kongos.



Këtë vit, R. D. e Kongos pati tempullin e saj të parë! Anëtarët e Kishës atje janë të emocionuar që kanë një tempull në vendin e tyre.

Njihuni me disa nga miqtë tanë nga R. D. e Kongos!



"Një të diel, kishte ushtarë kudo, dhe prindërit e mi thanë se do të ishte e vështirë të shkonim në kishë. U thashë prindërve se duhej të merrnim pjesë të paktën në mbledhjen e sakramentit. Së bashku treguam besim dhe shkua në kishë për ta nderuar ditën e Zotit."

Prodi K., 7 vjeç, Kinshasa, Republika Demokratike e Kongos



"Më pëlqen shumë të ndihmoj të tjerët. Një ditë në klasën time, një fëmijë ishte i trishtuar gjatë pushimit sepse nuk kishte asgjë për të ngrënë. Shkova tek ai dhe e ndava me të atë që kisha marrë për të ngrënë."


Selia Tshidibi K., 5 vjeçe, Kinshasa, Republika Demokratike e Kongos

A je nga R. D. e Kongos? Na shkruaj! Do të na pëlqente shumë të dëgjoni prej teje! Shih faqen M24.

Faleminderit që e eksploruat R. D. të Kongos me ne. Shihemi herën tjetër!



Nuk Dua të Jem Ndryshe!



Nga Eliza Brodbenti

(Bazuar në një ngjarje të vërtetë)

*“Vlera e shpirtave është e madhe në sytë e Perëndisë”
(Doktrina e Besëlidhje 18:10).*

Mika përherë mezi e priste kursin e kërcimit. Asaj i pëlqente shumë të dëgjonte muzikë. Asaj i pëlqente shumë të ushtrohej për kërcimin si flutur dhe ta bënte siç duhej. Dhe e pëlqente shumë atë sidomos kur e gjithë klasa e bënte së bashku. Kur e bënëin atë, ishte sikur kërcimtare të ishin të gjitha njëjloj. Dukej sikur ajo nuk ishte e vetmja me sindromën Daun.

Sot po mësonin një hap të ri kërcimi. Mika e pa mësuesen e saj të hidhej në ajër. Ajo pa vajzat e tjera që e provonin. Disa e kapën menjëherë. Disa bënë disa përpjekje. Mika u përpoq vazhdimisht por nuk mundi ta bënte siç duhej.

“A do të më ndihmosh, mësuese?” pyeti Mika.

Vajza në krah të saj i hodhi sytë nga Mika. Pastaj u përkul nga shoqja e saj. “Përse flet ashtu ajo?” pëshpëriti ajo. Të dyja vajzat u kthyen dhe e vështruan Mikën.



Gjatë rrugës për në shtëpi, Mika ishte e heshtur gjatë gjithë rrugës.

Kur arritën në shtëpi, mamaja po zinte brumë në kuzhinë. Ajo kishte miell në faqe. Ndonjëherë kjo gjë e bënte Mikën të qeshte. Por sot ajo thjesht e lëshoi çantën në dysheme dhe u zhyt në një karrige te tavolina.

“Si shkoi kërcimi?” pyeti mami.

“Tmerr”, tha Mika. “Kërkova ndihmë dhe një vajzë tha se flas në mënyrë qesharake. Pastaj më nguli sytë.” Mika uli sytë. “Nuk dua të shkoj më në kërcim.”

“O, Mika!” tha mami. “Më vjen shumë keq. Mua dhe babin na pëlqen shumë të shohim kur kërcen. Jemi tepër krenarë që punon aq shumë!”

Mika ndjeu se po i fillonin lotët. “S’më pëlqen që kam sindromën Daun. Nuk më pëlqen që fytyra ime është ndryshe. Do të doja që të mos e kisha kaq të vështirë për të mësuar gjëra të reja. Madje më duhet të ushtrohem edhe me të folurit!”

Babi u ul pranë Mikës dhe i hodhi dorën në qafë. “Mika, ne të duam *kaq shumë*. Ne nuk do të ndryshonim asnjë gjë tek ty.”

Por Mika thjesht tundi kokën dhe e mbuloi fytyrën me duar. “Nuk dua të jem ndryshe. Dua që të mos e kem më sindromën Daun!”

Mami dhe babi nuk folën për pak çaste.

“Kam një ide”, tha mami. Mika pa vjedhurazi përmes gishtave. “Përse nuk lutesh dhe nuk e pyet Atin Qiellor se çfarë ndien *Ai* për ty?”

Mika u mendua për këtë. Asaj i pëlqente të bënte lutje. Ngadalë, tundi kokën. “A mund ta shkruash pyetjen në mënyrë që ta mbaj mend se çfarë të kërktoj?”

Mamaja e shkroi pyetjen. Pastaj Mika e mori letrën dhe shkoi në dhomën e saj për t’u lutur.

Kur erdhi në kuzhinë pak minuta më vonë, Mikës i ndriçonte fytyra si dritë. “Ati Qiellor u përgjigj!” tha ajo. “Çfarë tha *Ai*?” pyeti mami.

“Ai tha: ‘Mika, të dua kështu siç je’”, tha ajo. “Dhe e tha me një zë të LARTË!”

Javën tjetër në kursin e kërcimit, Mika nuk u shqetësua për atë që vajzat e tjera mendonin për sindromën e saj Daun. Përkundrazi, ajo pa një vajzë tjetër, Sarën, që dukej e trishtuar. Sara gjithashtu e kishte të vështirë të mësonte disa nga lëvizjet e reja.

Kur Mika u kthye në shtëpi, ajo vendosi t’i shkruante një pusullë Sarës. Ajo vizatoi shumë zemra. Mamaja e ndihmoi atë për drejtshkrimin.

“E dashur Sara”, shkroi Mika. “Ti je një kërcimtare e shkëlqyer. Dua të jem shoqja jote. Jam e lumtur që je në kursin tim të kërcimit.”

Mika mezi priste t’ia jepte Sarës pusullën. Ajo donte që edhe Sara të ndihej e lumtur dhe ta ndiente që e donin. ●

Autorja jeton në Jutë, SHBA.



Plaku Stivenson Viziton Kilin

Apostujt udhëtojnë nëpër botë për t'u dhënë shërbesë njerëzve dhe për t'u dhënë mësim për Jezu Krishtin.



Plaku Geri E. Stivenson dhe Motra Liza Stivenson udhëtuan me Presidentin Rasëll M. Nelson dhe Motrën Uendi Nelson për në Kili për një ngjarje shumë të rëndësishme. Një tempull i ri po përkushtohet në qytetin e Konsepsionit!

Ky tempull i ri, i bukur është tempulli i dytë që po ndërtohet në Kili dhe tempulli i 18-të në Amerikën e Jugut.



Fëmijët erdhën me prindërit e tyre për ta dëgjuar Presidentin Nelson teksa bënte një lutje të veçantë për përkushtimin e tempullit.



Laura dhe Alisia O. ndihmuan për ta vënë gurin e fundit jashtë tempullit. Ky quhet guri i qoshes i tempullit. Atëherë tempulli ishte gati për t'u përkushtuar.

Shumë tërmete ndodhin në Kili. Tempulli i Konsepsionit në Kili ka një themel të veçantë që të mos ta lejojë atë të dëmtohet nëse bie një tërmet.




“Dita sot thjesht dukej absolutisht hyjnore”.

Tani, anëtarët e denjë të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, janë në gjendje të futen brenda për t'u vulosur me familjet e tyre dhe për të shërbyer duke bërë pagëzime në tempull.

Plaku Renland Viziton Fëmijët

Plaku Dejjl G. Renland viziton shumë vende bashkë me bashkëshorten e tij, Motrën Ruth L. Renland, për t'i ndihmuar njerëzit që të mësojnë për Jezun Krishtin. Ai bën biseda dhe flet me misionarët. Por kudo që shkon, gjëja e tij e parapëlqyer është t'i takojë dhe t'u japë dorën fëmijëve. Ndonjëherë ai madje i viziton ata në Fillore!



"A doni të dini një sekret? *Miku* është revista ime e parapëlqyer e Kishës. Gjithmonë e lexoj atë të parën!"




Plaku Renland do që fëmijët kudo ta dinë se Ati Qiellor i njeh dhe i do ata.

Një Kësulë e Bardhë për Florencën

Nga Xhordan Monson Rajti
(Bazuar në një ngjarje të vërtetë)

Trembëdhjetëvjeçarja Florenca Onijekue mbërriti në vendin e saj të zakonshëm, në tregun e hapur të mbushur me njerëz në Onitsha, Nigeri. Rruga ishte e mbushur me shitës që thërrisnin blerësit e ngarkuar. Gratë mbanin ekuilibrin me dengjet mbi kokë ndërsa ecnin. Shkolla sapo kishte mbaruar prej pushimeve dhe Florenca e dinte se miqtë e saj po e shijonin shkëputjen nga orët mësimore. Por Florenca i kaloi pushimet duke shitur barishte këtu në treg. Ishte mundësia e saj e vetme për të fituar para për tarifën e shkollës.

Megjithatë, Florenca nuk u ankua. Në fund të fundit, nëna e saj kalonte orë të shumta në treg çdo ditë duke shitur patate të ëmbla për të blerë ushqime për familjen. Nëna punonte shumë. Të dy prindërit e saj



punonin shumë. Por ngaqë nuk kishin shumë arsimim, vetëm kaq mund të bënin. Florenca ishte thujse duke e mbaruar shkollën 9 vjeçare. Ndoshta po të mund ta vazhdonte shkollën, ajo mund të gjente një punë me pagë të mirë dhe ta ndihmonte familjen e saj.

Kur u kthye në shtëpi, Florenca gjeti [ku ishin] prindërit dhe i pyeti: “A mendoni se mund të shkoj në shkollë të mesme? Dhe ndoshta në universitet?”

Mamaja pa nga Nnami (babai) dhe tundi kokën. “Universiteti kushton shumë më tepër nga sa kemi”, tha Nnami. Florenca uli sytë te këpucët. Ajo nuk donte që mamaja dhe Nnami ta shihnin se sa e zhgënjyer ishte.

Disa ditë më vonë, Florenca ndaloi në spital për të marrë disa ilaçe. Spitali ishte thujse aq i ngarkuar sa tregu, ndonëse jo me aq zhurmë. Florenca ia nguli sytë infermiereve me kapele të vogla, të bardha. Ajo e për-fytyroi veten me një uniformë të tillë, duke ndihmuar të sëmurët dhe duke u kujdesur për foshnjat në një spital të madh. Ndoshta ajo mund të bëhej infermiere.

Florenca e dinte se prindërit e saj kishin të drejtë – arsimimi i saj do të ishte e vështirë. Por Florenca dinte se si të punonte fort. Ajo vendosi të përpiqej.

Pavarësisht se sa shumë e zënë me punë ishte gjatë ditës, Florenca gjeti kohë për të studiuar.

Ajo i kaloi provimet [e pranimit] për shkollën e mesme dhe Nnami mori borxh aq para sa duheshin që ajo të shkonte në shkollë. Më vonë ajo zbuloi se qeveria do të ndihmonte për të paguar shkollën e infermierisë. Ëndrra e saj ishte e mundur!

Por kur erdhi koha që të fillonte shkollën e infermierisë, Florenca ndjeu pak dyshim. Po sikur të ishte shumë e vështirë? Po sikur të ishte e vetme? Florenca përkuli kokën dhe u lut: “I dashur Perëndi, të lutem, më jep forcën për të shkuar në shkollën e infermierisë dhe për të punuar fort”.

Në shkollën e infermierisë, Florenca mësoi se si të jepte ilaçe dhe t'i mbante mjetet të pastra nga mikrobet. Ndonjëherë pacientët e saj përmirësoheshin por ndonjëherë nuk ndodhte. Florenca u lut shpesh për të marrë zemër. Pas tre vitesh të gjata, Florenca u diplomua me çmimin “Studentja e dalluar e klasës”. Ëndrra e saj ishte bërë realitet! Ajo arriti të vinte kësulën e bardhë të infermieres dhe ishte në gjendje të fitonte para të mjaftueshme për të ndihmuar familjen.

Shumë vite më vonë, Florenca vizitoi një degë të vogël në Misionin e Ganës, Akra. Bashkëshorti i saj, Kristofer Çukuarah, ishte president misioni atje. Florenca



takoi disa fëmijë në degë që nuk mund të shkonin gjithmonë në shkollë. Ata nuk ishin të sigurt se çfarë të bënin në të ardhmen. Ata i kujtuan Florencës veten kur ishte fëmijë. “Çfarë mund të them për t'i ndihmuar?” Florenca u lut në heshtje.

Pastaj ajo ndjeu një nxitje të qartë: “Tregoju për jetën tënde”.

Florenca mendoi për jetën e vet. Ajo kishte punuar në spitalet në Nigeri dhe Shtetet e Bashkuara. Ajo ishte martuar me një njeri të mirë dhe së bashku kishin gjetur Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Ajo ishte bërë nënë. Tani ajo po i ndihmonte misionarët/et që të qëndronin të shëndetshëm/me dhe të punonin fort. Ati Qiellor e kishte ndihmuar atë të bëhej infermiere. Ai e kishte ndihmuar atë më shumë nga sa e kishte përfytyruar. Ai mund të bënte të njëjtën gjë për këta fëmijë.

Florenca pa fëmijët dhe buzëqeshi. “A i keni parasysh kësulat e bardha që mbajnë infermieret? Pashë një kësulë si ajo dhe vendosa të bëhem infermiere. . . .” ●

Autorja jeton në Miçigan, SHBA.



Kjo fotografi tregon Florencën në kohën kur ajo më në fund kishte një kësulë të bardhë vetë!





Nga Bruklin P., 9 vjeçe, Jutë, SHBA

Vitin e kaluar mora një libër në bibliotekë për një vajzë që nisi një ditari në internet [blog]. Mendova se do të ishte libër argëtues sepse personazhi kryesor kishte të njëjtën moshë me mua dhe mamaja ime është një mbajtëse ditari në internet. Ndaj mendova se do të ishte një libër ku mund të gjeja veten.

Kisha lexuar vetëm pak faqe nga libri kur [arrita te pjesa ku] vajza e përdori kot emrin e Zotit. Nuk u ndjeva shumë mirë përbrenda pasi e lexova atë pjesë. Por vazhdova të lexoja duke shpresuar se ishte një gjë që ndodhte vetëm një herë. Lexova edhe disa faqe dhe ajo e tha përsëri.

Shkova dhe i tregova mamit për atë që gjeta. Nuk e dija a duhej të vazhdoja të lexoja ose jo. Mami më tha se ishte zgjedhja ime. Por ajo ra dakord se ndoshta nuk

ishte gjë e mirë të vazhdoja të lexoja nëse ajo vajzë po thoshte gjëra që ne e dinim se ishin të gabuara. Mami më tha se nuk ishte gjë e mirë sidomos nëse ajo po e përdorte kot emrin e Zotit.

Mendova ta shihja një herë a do të ndodhte kjo më tej, ndaj e shfletova librin shpejt e shpejt. Zbulova se kjo vajzë e përdorte kot emrin e Zotit rregullisht. Vendosa ta ktheja librin në bibliotekë pa e lexuar më tej.

U ndjeva keq që autorja e librit e përdorte emrin e Zotit kot. Por pasi e ktheva librin në bibliotekë u ndjeva e lumtur që bëra zgjedhjen e duhur. E dija se po ndiqja “Standardet e Mia të Ungjillit” nga libri *Besim në Perëndi* [për vajzat] që thotë: “Unë do të lexoj dhe do të shikoj vetëm gjëra që janë të pëlqyeshme për Atin Qiellor”. E di se supozohet që ne ta përdorim emrin e Atit Qiellor dhe të Jezusit vetëm me nderim dhe me respekt. ●

A Duhet të Vazhdoj të Lexoj?



Unë mund të bëj gjithçka me anë të Krishtit që më forcon

(shih Filipianëve 4:13).





**Nga Motra
Xhoi D. Xhons,**
Presidente e
Përgjithshme e
Filllores

Sfida e Tempullit



*“Zemrat e fëmijëve do të kthehen tek etërit e tyre”
(Doktrina e Besëlidhje 2:2).*

Një të diel, unë dhe këshilltaret e mia vizitua një mbledhje në Kishë. Dhamë biseda për tempullin dhe gjërat e veçanta që ndodhin atje. Pas mbledhjes, një djalë 12-vjeçar i quajtur Kolbi erdhi tek unë dhe më dha dorën. Ne biseduam për tempullin. Pastaj e sfidova atë që të gjente një emër të familjes për ta çuar në tempull.

Pas një kohe të shkurtër, mora një letër nga Kolbi. Ja se çfarë më tha Kolbi:

“Shkova në shtëpi dhe gjeta një emër të ri. Doli që gjeta katragjyshin tim!

Pak kohë më vonë shkova në tempull dhe u pagëzova

për të. Ishte vërtet e veçantë sepse im vëlla më pagëzoi dhe babai im më konfirmoi në emrin e tij.

Pata një ndjenjë të ngrohtë përbrenda që solli paqe. Ndjeva se ajo që bëra për katragjyshin tim ishte vërtet gjë e mirë sepse tani ai mund të shkojë në mbretërinë çelestiale për të jetuar me familjen e tij. Pjesën tjetër të ditës u ndjeva vërtet mirë përbrenda.

Gjithashtu zbulova se askush nuk e di se kush ishin prindërit e katragjyshit tim, ndaj unë mund t'i gjej emrat e tyre dhe t'i çoj edhe ata në tempull!”

Çfarë shembulli i jashtëzakonshëm është Kolbi! Pavarësisht se sa vjeç je, ti mund të jesh një shembull për familjen dhe miqtë e tu. Ti mund ta shpërndash ungjillin me këdo që njeh – madje paraardhësit e tu! ●

Trego dhe Thuaj

Konferenca e përgjithshme është këtë muaj. Ja se çfarë u pëlqen disa fëmijëve nga konferenca.



Më pëlqen të dëgjoj historitë dhe korin që këndon. Gjithashtu më pëlqen të dëgjoj shëmbëlltyrat që ata japin.
Juri H., 8 vjeç, Taojuan, Taivan



Më pëlqen ta dëgjoj profetin sepse Zoti flet nëpërmjet tij.
Andres C., 12 vjeç, Vale del Kauka, Kolumbi




Më pëlqen ta shoh konferencën sepse më pëlqen të mësoj nga profetët dhe më pëlqej ta kaloj atë kohë me familjen time.
David J., 9 vjeç, Solola, Guatemalë



Abeli C. dhe Tina S., 10 vjeç dhe 9 vjeçe, Bong Kounti, Liberi, janë vëlla e motër. Abelit i pëlqen konferenca “sepse ajo është koha kur ne e mbështetim profetin tonë si Presidentin e Kishës çdo vit”. Tinës “i pëlqen kur profeti flet për tempujt”.



Ana B., 10 vjeçe, Maharashtra, Indi, e shoh konferencën me mamën e vet. Ajo merr me vete ditarin dhe stilolapsat çdo konferencë për të shkruar dëshmitë dhe mesazhet që dëgjon.



David dhe Xhuliana M., 4 vjeç dhe 6 vjeçe, Holanda e Jugut, Holandë, mbushin 15 tasa me vakte të lehta dhe vendosin nga një fotografi të një Apostulli ose anëtarit të Presidencës së Parë te secila prej tyre. Kur njëri nga Vëllezërit flet, ata hanë atë që është në atë tas.





T'i Shërbesh Zotit në Spanjisht

Nga Xhenifer Medi

(Bazuar në një ngjarje të vërtetë)

Përfytyro sikur një shok ose shoqe të jep librin më të mirë që ai ose ajo ka lexuar ndonjëherë. Ti e hap kapakun . . . dhe zbulon se nuk mund ta lexosh atë. Është në një gjuhë tjetër! Çfarë do të bëje?

Në vitet e hershme të Kishës, Libri i Mormonit u shtyp vetëm në anglisht. Presidenti Brigam Jang thirri dy misionarë për ta predikuar ungjillin në Meksikë dhe për ta përkthyer Librin e Mormonit në spanjisht. Por ata kishin nevojë për më tepër ndihmë për ta bërë atë. Por ata nuk e dinin se përtej oqeanit, Perëndia kishte përgatitur një burrë që mund t'u jepte atyre pikërisht ndihmën për të cilën kishin nevojë.

Meliton Gonzales Treho vinte nga një familje e pasur në Spanjë. Ai studioi shumë në shkollë dhe u bë oficer në ushtrinë spanjolle. Ai ishte përherë i interesuar për fenë por asnjë nga ato që gjeti nuk i dukej plotësisht e duhura. Një ditë, ai dëgjoi një oficer tjetër të fliste rreth një grupi njerëzish që e quanin veten “shenjtorë”. Ata i përkisnin Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve

të Ditëve të Mëvonshme dhe një profet i Perëndisë i kishte drejtuar ata për në Malet Shkëmbore në Shtetet e Bashkuara. Melitoni ndjeu një dëshirë të fortë për t'i takuar. Ai u bashkua me një ekspeditë ushtarake për në Filipine, duke shpresuar se kjo do ta ndihmonte që më vonë të shkonte në Shtetet e Bashkuara. Por Melitoni u ngarkua kaq shumë me punë sa që vizita te shenjtorët filloi t'i dukej më pak e rëndësishme.

Pastaj Melitoni u sëmur rëndë. Ai u kujtua se përse kishte ardhur në Filipine dhe iu lut Perëndisë rreth asaj që duhej të bënte. Ata natë, Melitoni pa një ëndërr të veçantë. Ai e dinte se do t'i duhej të largohej për në Malet Shkëmbore.

Sapo e mori veten nga sëmundja, Melitoni e vazhdoi udhëtimin e tij për në Shtetet e Bashkuara. Ai mbërriti në Kaliforni më 4 korrik 1874 dhe u drejtua për në Solt-Lejk-Siti.

Kur Melitoni mbërriti në Solt-Lejk, atij i doli një problem: ai mund të lexonte anglisht por nuk e kishte folur



asnjëherë. Ai nuk mund të komunikonte me asnjë! Por ai vendosi që, duke qenë se nuk mund të fliste me njerëzit, ai mund t'ua tërhiqte vëmendjen në një mënyrë tjetër. Melitoni veshi uniformën e ushtrisë spanjolle dhe marshoi lart e poshtë rrugëve të qytetit. Ashtu siç shpresoi, shumë njerëz e vunë re! Më në fund atë e dalloj një anëtar i Kishës i quajtur vëllai Blanshard, një profesor universiteti që fliste spanjisht. Vëllai Blanshard e ndihmoi Melitonin të stabilizohej në Solt-Lejk dhe ia mësoi atij ungjillin. Shpejt Melitoni u pagëzua.

Vëllai Blanshard gjithashtu e njohu Melitonin me Presidentin Brigam Jang. Melitoni i tha Presidentit Jang se më shumë se çdo gjë tjetër ai donte që të përkthente Librin e Mormonit në spanjisht.

Presidenti Jang i kërkoi Melitonit t'i ndihmonte misionarët që po shkonin në Meksikë, për të përkthyer pjesë të Librit të Mormonit në spanjisht. Melitoni kaloi shumë javë duke i përkthyer fjalët anglisht në spanjisht. Çdo natë ai e rishikonte përkthimin e tij me misionarët. Ata flisnin pak spanjisht por ndien se për këtë përkthim të rëndësishëm duhej dikush që spanjishten e kishte gjuhë amtare. Ata e dinin se Melitoni ishte përgjigja e lutjeve të tyre. Në vitin 1875, përkthimi u botua. Ai u

quajt *Trozos Selectos del Libro de Mormon* (Fragmente të Përzgjedhura nga Libri i Mormonit).

Misionarët tani ishin gati për të shkuar në Meksikë. Ata ngarkuan 1 500 kopje të përkthyer të shkrimit të shenjtë mbi kalë dhe filluan udhëtimin e tyre. Për herë të parë, spanjishtfolësit ishin në gjendje ta lexonin Librin e Mormonit në vetë gjuhën e tyre. Edhe pse Melitoni kishte jetuar në Spanjë, mijëra kilometra larg, Ati Qiellor e drejtoi atë saktësisht atje ku ai duhej të ishte. Për shkak të guximit dhe besimit të Melitonit, ai ndihmoi për ta sjellë fjalën e Perëndisë te njerëz të panumërt. ●

Autorja jeton në Jutë, SHBA.



Meliton Gonzalez Treho (1844–1917) shërbeu në disa misione në Meksikë dhe pagëzoi disa nga anëtarët e parë të Kishës atje. Në vitin 1886 Melitoni ndihmoi për ta përfunduar përkthimin e të gjithë Librit të Mormonit në spanjisht.

Udhëtimet Misionare të Palit

Nga Marisa Uidisën
Revistat e Kishës



Pasi Jezusi u ringjall, Apostulli Pal udhëtoi në vende të ndryshme për t'u dhënë mësim njerëzve për Jezusin. Në atë kohë nuk kishte makina ose aeroplanë ndaj ai eci shumë. Ndonjëherë udhëtoi me anije.




Pali u dha mësim njerëzve në kisha dhe shtëpi. Ai u dha mësim njerëzve mbi kodrat shkëmbore dhe rrugëve të qytetit.



Shumë njerëzve nuk iu pëlqeu ajo që u mësoi Pali. Ndonjëherë Palin e futnin në burg. Ndonjëherë Pali sëmurej.




Por gjatë gjithë këtyre gjërave të vështira, Pali kishte besim. Ai tha: “Unë mund të bëj gjithçka me anë të Krishtit që më forcon”. Ai e dinte se Jezusi do ta ndihmonte atë që të ishte i fortë.



Jeju Krishti mund të më ndihmojë edhe mua që të jem i/e fortë.
Ai më do dhe unë e dua Atë! ●

Jezusi Mund të më Ndhimojë të Bëj Gjëra të Vështira



Të Dashur Prindër,

Një nga mesazhet kryesore të Dhiatës së Re është që ne mund të gjejmë paqe dhe gëzim te Krishti, pavarësisht se si është jeta jonë. Revista e këtij muaji jep një dëshmi të ngjashme.

- Në faqen M4, një djalë ngushëllohet kur sheh ëndrra të këqija.
- Në faqen M8, një vajze me sindromën Daun i kujtohet që Ati Qiellor e do atë.
- Në faqen M15, një afishe të mëson se të gjitha gjërat janë të mundura me ndihmën e Jezu Krishtit.
- Në faqen M20–23, Pali jep një shembull besimi.


Teksa e lexoni këtë revistë së bashku, kërkojini mënyrat se si Jezusi dhe Ati Qiellor i ndihmuan njerëzit në çdo histori. Ju mund t'i nënvizoni fjalët që përshkruajnë sfidat me të cilat ata u përballën. Pastaj qarkojini fjalët që përshkruajnë se çfarë ndihme morën ata. Si familje, flisni për mënyrën se si ndonjëherë sprovat largohen dhe herë të tjera ne bëhemi më të fortë për t'i kaluar sprovat tona. Cilado qoftë mënyra, Jezusi dhe Ati Qiellor na duan dhe na gjenden pranë!

Urojmë që të keni një muaj të gëzueshëm,

Miku

Si t'i Dërgoni Veprat e Artit ose Përvojën e Fëmijës Suaj te *Liahona*

Shkoni te Liahona.ChurchofJesusChrist.org dhe klikoni te "Submit an Article or Feedback" ("Dërgoni një Artikull ose Lini një Përshtypje"). Ose dërgojeni me postë elektronike te Liahona@ChurchofJesusChrist.org së bashku me emrin, moshën, vendbanimin e fëmijës suaj dhe këtë deklaratë për leje: "Unë, [vendos emrin tënd], i jap leje Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme ta përdorë materialin e dorëzuar nga fëmija im në revistat e Kishës, ose faqet e internetit të Kishës dhe platformat e mjeteve shoqërore të informimit". Mezi presim të dëgjojmë prej jush!



Gjejeni Liahonën e fshehur brenda revistës!

NË KAPAKUN E REVISTËS MIKU
Ilustrimi nga Macky Pamintuan

PËRMBAJTJA

- M2** T'i Duash të Tjerët Sikurse i Do Jezusi
- M4** Thjesht një Lutje Larg
- M6** Përshëndetje nga Republika Demokratike e Kongos!
- M8** Nuk Dua të Jem Ndryshe!
- M10** Apostujt nëpër Botë: Plaku Stivenson Viziton Kilin
- M11** Apostujt nëpër Botë: Plaku Renland Viziton Fëmijët
- M12** Një Kësulë e Bardhë për Florencën
- M14** A Duhet të Vazhdoj të Lexoj?
- M15** Ide e Shkëlqyer: Unë Mund të Bëj Gjithçka me anë të Krishtit
- M16** Sfida e Tempullit
- M17** Trego dhe Thuaj
- M18** Shembuj të Guximshëm: T'i Shërbesh Zotit në Spanjisht
- M20** Histori nga Shkrimet e Shenjta: Udhëtimet Misionare të Palit
- M23** Faqe për Ngjyrosje: Jezusi Mund të më Ndihmojë të Bëj Gjëra të Vështira